

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

UNIVERSITETI DHE SHOQËRIA BASHKËKOHORE

PRISHTINË, 2003

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

UNIVERSITETI DHE SHOQËRIA BASHKËKOHORE

Redaksia

Prof. Dr. Isak Shema

Prof. Dr. Arsim Bajrami

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

BALLINA:

KONFERENCA SHKENCORE

PRISHTINË, 16-17 NËNTOR 2002

**UNIVERSITETI
DHE
SHOQËRIA BASHKËKOHORE**

**SPONSOR
FONDACIONI FRIEDRICH EBERT STIFTUNG**

SCIENTIFIC CONFERENCE

PRISHTINA, 16-17 NOVEMBER 2002

**UNIVERSITY
AND
CONTEMPORARY SOCIETY**

**SPONSOR
FRIEDRICH EBERT STIFTUNG**

ILUSTRIMI

UNIVERSITETI DHE SHOQËRIA BASHKËKOHORE

Fjala e Rektorit të Universitetit të Prishtinës, Prof.Dr.Zejnel Kelmendit, në Konferencën shkencore: "Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore".

I nderuari zoti Ministër,

Të nderuar përfaqësues të Institutit "Friedrich Ebert Stiftung"

Zonja dhe zotërinj,

I vetëdijshëm se Universiteti i Prishtinës është pjesë e shoqërisë sonë dhe gjithmonë në kërkim të pozitës së tij sa më të mirë në këtë shoqëri, por edhe në dhënien e kontributit të tij për avancimin e tërësishëm të saj, më lejoni të shpallë të hapur Konferencën shkencore: "Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore".

Jam i nderuar që ju takoj sot dhe ju përshëndes në emër të Universitetit të Prishtinës Ju, njerëzve të arsimit, shkencës dhe të ndikimit në shoqërinë tonë dhe ata ndërkombëtarë, përfaqësues të këtyre mekanizmave bartëse të zhvillimeve demokratike e reformuese të shoqërisë sonë, por edhe përgjegjësive që dalin nga ato në synim për shoqëri bashkëkohore.

Që në fillim dua t'i falënderoj organizatorët për këtë Konferencë, si ata vendorë dhe ata ndërkombëtarë, në veçanti Institutin "Friedrich Ebert Stiftung". Po ashtu parapraakisht dua t'i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, referuesit dhe diskutuesit në këtë konferencë, të cilët jam i bindur do të japin pasqyrë dhe ide për një pozitë më të mirë të Universiteti në shoqëri dhe të shoqërisë në tërësi në kohën e pasluftës dhe paskomunizmit.

Zonja dhe zotërinj,

Që nga koha e themelimit, universitetet kanë qëndruar në mes të dëshirës për kërkimin e të vërtetës dhe dëshirës sensitive për mësim praktik, për pregatitje për jetë dhe punë. Universitetet gjithmonë, edhe sot kanë provuar ta marrin të ardhmen në duart e veta dhe për këtë kanë aktivizuar ndryshimet në përputhje me kohën dhe realitetet e reja.

Universiteti dhe njerëzit e tij shprehin mendimin mbi jetën, kombin e njerëzimin, mbi thellësitë e shkencës, për të krijuar një mendim të mirëfilltë për atë çka na rrethon dhe intereson, mbi të gjitha ta lehtësojmë jetën si njerëz dhe si komb. Përgjegjësia e Universitetit tradicionalisht ishte e madhe dhe komplekse, varësisht nga zhvillimi i shoqërisë. Zhvillimi i Universitetit determinon zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë. Gjithsesi edhe tradita jonë universitare meriton të çmohet dhe integrohet në realitetin e sotëm bashkëkohor.

Zonja dhe zotërinj,

Zhvillimet e shoqërisë Universiteti i konsideron si pjesë të rezultatit të vet dhe ato i pranon edhe si domosdoshmëri për zhvillim të mëtejshëm dhe në këtë drejtim ai merr hapat e nevojshëm, që të jetë sa më origjinal, produktiv dhe pozitiv për veten dhe shoqërinë. Universiteti gjithmonë është i kujdesshëm në rrugëtimin e tij, ai ndërmerr hapa që krijojnë respektin për dinjitetin e secilit të Universitetit dhe të shoqërisë sonë në tërësi.

Universiteti përballë shoqërisë tenton ta forcojë identitetin e tij, por edhe të gërshetojë atë me të arriturat bashkëkohore. Më duhet të them se ndonjëherë kapaciteti ynë, tradita jonë, kërkojnë që ne të mos nxitojmë në ballë të shoqërisë, por gjithësesi të mos mbesim jashtë rrjedhave të saj.

Zonja dhe zotërinj,

Ne kemi synuar një skemë të përshtatshme akademike, një mënyrë interaktive të ligjëritimit, të afërt për studentët, një vlerësim real të mundit të studiuesve, avancim të kushteve të punës, të studimit dhe gjendjes ekonomike të të punësuarëve, një lidhje me ekonominë, një administratë të thjeshtë dhe transparente. E gjithë kjo synohet të jetë në përputhje me nevojat e shoqërisë sonë, në radhë të parë, por edhe të trendeve bashkëkohore njëkohësisht. Reformimi legal është i domosdoshëm, është pjesë e reformës sonë. Mbrojtja legjislative e reformës siguron adaptimin e saj dhe aftësitë konkurruese. E gjithë kjo bëhet për rritjen dhe avancimin e punës sonë dhe përgatitjen e njerëve për shoqërinë, respektivisht nevojat e saja.

Reformimi dhe puna e Universitetit tonë nuk bart shenja apo attribute personale, politike apo të diktatit. Kjo nuk do të thotë se në reformimin e Universiteti të Prishtinës e shohim si të ndarë nga shoqëria, sidomos nga sistemi arsimor.

Në punën tonë universitare, por edhe gjatë reformave, do të trajtojmë me kujdes autonominë universitare. Edhe në “Magna Charta Universitatum”, të nënshkruar në Bolonjë, ku theksohet se autonomia e Universiteteve siguron që arsimi i lartë dhe sistemi i kërkimeve permanente i adapton nevojat e ndryshimeve, kërkesave të shoqërisë dhe avancon njohuritë shkencore.

Universiteti ka për obligim të demonstrojë kapacitetin e tij dhe dëshirën për të planifikuar të ardhmen e tij, të sqarojë përmbajtjen e veprimeve të veta, të përdorë fuqinë e autonomisë së tij, pra të tregojë përgjegjësi para vetes dhe shoqërisë.

Zonja dhe zotërinj,

Jemi të vetëdijshëm se nevojave të kohës për reformism nuk është lehtë t’u përgjigjemi, posaçërisht kur kemi parasysh organizimin e Universitetit dhe disiplinat shkencore që u japin të drejtë studiuesve tanë të marrin diploma, të cilat do t’i shfryëzojnë në jetën tonë të përditshme, që të influencojnë në ndryshimet evolutive në shoqëri dhe aplikimin e shkencës dhe dijes në ekonomi, kulturë dhe në aspekte të tjera të shoqërisë sonë.

Kanë mbetur edhe shumë synime që presin realizimin si implementimi i plotë i reformave, përmirësimi i kushteve për punë studimore, ngritja e cilësisë së jetës për studentë, përmirësimi i kushteve materiale të të punësuarëve, nxitja e aftësive konkurruese në Universitet, inspirimi për punë shkencore, bashkëpunim me të madhe me studiuesit ndërkombëtarë, nxitja e veprimtarisë botuese, një lidhje të fortë dhe një pozitë me rëndësi në shoqërinë tonë. Besoj se edhe takimi në këtë konferencë është në funksion të këtyre synimeve dhe e kuptojmë si vazhdimësi të kooperimit tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Në fund, duke shprehur dëshirën për një takim të ngrohtë, për ngritjen e problemeve dhe mundësive për një bashkëpunim serioz të të gjithëve në këtë kohë të ndryshimeve të mëdha në Universitet dhe në shoqëri, shpreh gatishmërinë e Universitetit që të marrë përgjegjësinë që i takon në shoqërinë tonë dhe jashtë saj. Uroj që puna mësimore dhe shkencore e Universiteti tonë të gjejë hapësirë në shoqërinë tonë dhe bashkërisht me te të jemi pjesë e shoqërive të botës bashkëkohore.
Ju faleminderit.

Zonja dhe zotërinj,

Në fund, duke shprehur dëshirën për një takim të ngrohtë, më lejoni të ritheksoj qëndrimin se procesi i reformave është në rrugëtim, që i duhet kohë dhe kushte, vullnet dhe gatishmëri, por edhe respekt të identitetit tonë të gërshetuar atë me universitetet e përparuara. Puna që po e bëjmë ne të gjithë në reformimin e Universitetit të Prishtinës përmban përgjegjësi, ndieshmëri dhe kërkon kujdes. Ne jemi të vendosur që të vazhdojmë këtë rrugë të gjatë dhe të vështirë me vullnet, dije dhe guxim intelektual.
Ju faleminderit.

Prof. Dr. Isak SHEMA

UNIVERSITETI DHE SHOQËRIA BASHKËKOHORE

HYRJE

Universiteti i Prishtinës në fazën e tanishme të zhvillimit të gjithanshëm dhe të reformimit, me përkushtim edhe më të madh synon të realizojë objektivat e institucionit publik të arsimit të lartë në Kosovë. Në procesin e zhvillimit të vet dhe të shoqërisë në tërësi, Universiteti synon të arrijë përparimin e duhur në lëmin e diturive, të ideve dhe të shkollimit, të realizojë edhe programet e reja mësimore dhe shkencore, arsimim dhe strukturë akademike bashkëkohore, të përparojë metodologjinë e mësimdhënies, të studimeve universitare dhe metodat e vlerësimit të studentëve sipas standardeve të pranuara ndërkombëtare. Po ashtu synon të krijojë administratë bashkëkohore dhe të realizojë financimin adekuat si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të pozitës materiale të Universitetit në tërësi (investimet për ndërtim dhe renovim të objekteve, për teknologjinë e re, furnizimin e bibliotekave universitare, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës së mësimdhënësve, të bashkëpunëtorëve, të studentëve dhe të punonjësve të tjerë.)

Universiteti bashkëkohor ndikon fuqishëm në zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, social, ekonomik dhe të demokracisë në Kosovë dhe krijon mundësi të barabarta të studimeve universitare dhe pasuniversitare për të gjithë njerëzit e aftë, pa kurrëfarë dallimi dhe diskriminimi në bazë të përkatësisë kombëtare, etnike, gjuhësore, fetare etj.

Duke pasur parasysh problemet aktuale të zhvillimit të Universitetit, me qëllim të studimit të çështjeve komplekse dhe të rëndësishme të veprimtarisë së Universitetit të Prishtinës dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme, janë organizuar disa tribuna dhe seminare në të cilat, së bashku me ekspertë të njohur edhe të qendrave të jashtme universitare, janë trajtuar tema të ndryshme me interes të posaçëm për të gjitha institucionet universitare. Janë organizuar edhe vizita studiu me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, të realizimit të reformës universitare dhe të shkëmbimit të përvojës. Është me interes të thellohet bashkëpunimi me institucionet e jashtme universitare, me shoqatat joqeveritare, me asociacionet e tjera universitare dhe me fondacionet e caktuara për realizimin praktik të projekteve. Kontributi i institucioneve dhe i ekspertëve ndërkombëtarë për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë është vlerësuar shumë i dobishëm.

Me qëllim të studimit shkencor të temave të veçanta, por shumë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të Universiteti dhe të shoqërisë në tërësi, organizojmë Konferencën shkencore “Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore”. Tri temat e këtij aktiviteti shkencor: “Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore”, “Universiteti dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës” dhe “Aspekte të reformës së Universitetit të Prishtinës”, përfshijnë disa ligjërata dhe kumtesa të këtij sesioni. Diskutimi lidhur me këto tema dhe për çështjet aktuale të kësaj problematike shkencore do të jetë në funksion të realizimit të qëllimit të këtij tubimi shkencor.

KARAKTERI MËSIMOR DHE SHKENCOR I UNIVERSITETIT

Universiteti i Prishtinës është institucion publik i arsimit të lartë. Si i tillë përfshin 15 fakultet dhe 8 shkolla të larta. Arsimi i lartë ka synime të qarta për transformim të gjithanshëm arsimor, kulturor dhe shkencor të shoqërisë. Universiteti, së bashku me të gjitha institucionet që e përbëjnë këtë institucion të lartë, si edhe me subjektet e tjera, realizon planet dhe programet e veprimtarisë arsimore dhe të kërkimore shkencore dhe në këtë mënyrë arrin të krijojë kuadrin profesional dhe shkencor aq të kërkuar për funksionimin e shoqërisë bashkëkohore.

Universiteti është “institucion mësimor dhe shkencor, që jep diploma dhe tituj duke përfshirë nivelin e doktoratës me synimet e tij duke përfshirë përparimin në fushën e njohurive, ideve dhe diturisë në Kosovë, zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, social dhe ekonomik të Kosovës, nxitjen e qytetarisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies e të mësimi”.

Universiteti bashkëkohor ka objektiva të rëndësishëm për përparimin e gjithanshëm arsimor dhe shkencor, të përcaktuar edhe në Ligjin “Mbi Arsimin e Lartë në Kosovë” (2002), siç janë: “ Të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore; dhe (b) të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës të aftë për të përfutur nga ky arsim gjatë gjithë jetës së tyre”.

“LIGJI MBI ARSIMIN E LARTË” DHE VEPRIMTARIA E UNIVERSITETIT

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (UNMIK) në bazë të Rregullores së Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi “Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme” dhe mbështetur në rregulloret e tjera të veçanta që kanë të bëjnë me arsimin dhe shkencën, kanë hartuar dhe propozuar për diskutim dhe për miratim në Parlamentin e Kosovës Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë” (Ligji është miratuar në Parlamentin e Kosovës më 2003 dhe me shumë vonesë është nënshkruar nga përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Kosovën, Mihael Shtajner).

Teksti ligjor bazohet në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në protokollet dhe rekomandimet e njohura evropiane për Arsimin e Lartë dhe në Deklaratat e Ministrave Evropianë të Arsimit të Lartë në Bolonjë (1999) dhe Pragë (2001).

Në këtë ligj parashihen mundësitë për studime në Arsimin e Lartë të Kosovës: “Arsimi i lartë i cili kryhet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të jetë i mundshëm për të gjithë personat në territorin e Kosovës, ose nëpërmjet mësimi në distancë, brenda ose jashtë territorit të Kosovës në çfardo vendi, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë ose indirekt për ndonjë arsye reale apo të supozuar që ka lidhje me gjininë, racën, orientimin seksual, dëmtime fizike ose të një lloji tjetër, gjendjen civile, ngjyrën, fenë, opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo ndonjë status tjetër. Nuk do të ketë kufizim moshe për t’u regjistruar apo për të marrë kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë”.

Në kapitullin e parë Ligji përmban kompetencat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Agjencisë së Akreditimit. Ajo “është përgjegjëse për: (a) planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë në konsultim me bartësit e akredituar të arsimit të lartë; (b) drejtimin e bartësve publikë të arsimit të lartë dhe miratimin e statuteve të tyre të cilat statute ratifikohen në Kuvend; (c) për caktimin e fondeve në kuadër të dispozitave të përgjithshme sipas Ligjit të zbatueshëm për financimin e shërbimeve publike në Kosovë për bartësit publikë për mësimdhënie dhe për hulumtime me interes të përgjithshëm” dhe për shumë çështje të tjera të parapara me Ligjin. Në vijim (Kapitulli II) jipet veprimtaria e bartësve publikë të arsimit të lartë, siç janë universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë, autonomia e bartësve të arsimit të lartë etj. Universitet janë institucione mësimore dhe shkencore. Universiteti i Prishtinës konsiderohet i licencuar deri më 31 gusht të vitit 2004.

Titujt dhe diplomat universitare (dhe ato të arsimit të lartë në tërësi) jipen në bazë të ligjit nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë.

Qeverisja dhe administrimi i universiteteve përcaktohet me statut. Ligji i përkohshëm i Universitetit të Prishtinës, i miratuar më 1.10.2001, zëvendësohet kur të miratohet statuti i ri i Universitetit të Prishtinës, i bazuar në Ligjin mbi Arsimin e Lartë, 2003. Organet e reja qeverisëse të universitetit janë: Këshilli Drejtues, Senati dhe Rektori. Funksionojnë edhe këshilla e komisione të tjera, në të cilat marrin pjesë përfaqësues të personelit arsimor, të studentëve dhe të punonjësve të tjerë, ashtu siç përcaktohet me akte normative të universitetit dhe të institucioneve të tjera.

Një document i rëndësishëm për arsimin e lartë në Evropë është “Magna Charta”, “Përmbledhje Parimesh”, të nënshkruar dhe të pranuar nga shumë universitete evropiane. Pritet që edhe Universiteti i Prishtinës ta pranojë dhe ta nënshkruajë atë dhe në bazë të këtij dokumenti të hartojë dhe të miratojë Statutin dhe aktet e tjera normative. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij materiali, dedikuar universiteteve evropiane, si bazë edhe për reformimin e universiteteve, tekstin po sjellim të plotë në gjuhën angleze, dhe në gjuhën shqipe.

THE MAGNA CHARTA

PREAMBLE

The undersigned Rectors of European Universities, gathered in Bologna for the ninth centenary of the oldest University in Europe, four years before the definitive abolition of boundaries between the countries of the European Community; looking forward to far-reaching co-operation between all European nations and believing that peoples and States should become more than ever aware of the part that universities will be called upon to play in a changing and increasingly international society, Consider:

1) that at the approaching end of this millenium the future of mankind depends, largely on cultural, scientific and technical development; and that this is built up in centres of culture, knowledge and research as represented by true universities;

2) that the universities' task of spreading knowledge among the younger generations implies that, in today's world, they must also serve society as a whole; and that the

cultural, social and economic future of society requires, in particular, a considerable investment in continuing education;

3) that universities must give future generations education and training that will teach them, and through them others, to respect the great harmonies of their natural environment and of life itself.

The undersigned Rectors of European universities proclaim to all States and to the conscience of all nations the fundamental principles which must, now and always, support the vocation of universities.

FUNDAMENTAL PRINCIPLES

1. The university is an autonomous institution at the heart of societies differently organized because of geography and historical heritage; it produces, examines, appraises and hands down culture by research and teaching.

To meet the needs of the world around it, its research and teaching must be morally and intellectually independent of all political authority and intellectually independent of all political authority and economic power.

2. Teaching and research in universities must be inseparable if their tuition is not to lag behind changing needs, the demands of society, and advances in scientific knowledge.

3. Freedom in research and training is the fundamental principle of university life, and governments and universities, each as far as in them lies, must ensure respect for this fundamental requirement.

Rejecting intolerance and always open to dialogue, the university is an ideal meeting-ground for teachers capable of imparting their knowledge and well equipped to develop it by research and innovation and students entitled, able and willing to enrich their minds with that knowledge.

4. A university is the trustee of the European humanist tradition; its constant care is to attain universal knowledge; to fulfil its vocation it transcends geographical and political frontiers, and affirms the vital need for different cultures to know and influence each other.

THE MEANS

To attain these goals by following such principles calls for effective means, suitable to present conditions.

1. To preserve freedom in research and teaching, the instruments appropriate to realize that freedom must be made available to all members of the university community.

2. Recruitment of teachers, and regulation of their status, must obey the principle that research is inseparable from teaching.

3. Each university must - with due allowance for particular circumstances - ensure that its students' freedoms are safeguarded and that they enjoy conditions in which they can acquire the culture and training which it is their purpose to possess.

4. Universities - particularly in Europe - regard the mutual exchange of information and documentation, and frequent joint projects for the advancement of learning, as essential to the steady progress of knowledge.

Therefore, as in the earliest years of their history, they encourage mobility among teachers and students; furthermore, they consider a general policy of equivalent status, titles, examinations (without prejudice to national diplomas) and award of scholarships essential to the fulfilment of their mission in the conditions prevailing today.

The undersigned Rectors, on behalf of their Universities, undertake to do everything in their power to encourage each State, as well as the supranational organizations concerned, to mould their policy sedulously on this Magna Charta, which expresses the universities' unanimous desire freely determined and declared.

MAGNA CHARTA UNIVERSITATUM (PËRMBLEDHJE PARIMESH)

HYRJE

Rektorët e universiteteve evropiane, nënshkrues, që u mbledhën në Bolonjë me rastin e nëntëqind vjetorit të Universitetit më të vjetër në Evropë, katër vjet para heqjes së kufinjve ndërmjet shteteve të Komunitetit Evropian; duke parashikuar bashkëpunim gjithpërfshirës në mes kombeve evropiane dhe duke besuar se njerëzit dhe shtetet duhet të jenë të vetëdijshëm gjithnjë e më shumë se nga universitetet do të kërkohet të luajnë rol në shoqërinë përherë më të ndryshueshme dhe të ndërkombëtarizuar mendojnë se:

- 1) Duke iu afruar fundit të këtij shekulli ardhmëria e njerëzimit më së shumti varet nga zhvillimi kulturor, shkencor dhe teknik: dhe se kjo ndërtohet në qendra të kulturës, dijes dhe hulumtimit të përfaqësuar nga Universitetet e vërteta.
- 2) Se detyra e universitetit për të shpërndarë dijen të gjeneratave të reja nënkupton në ditët e sotme se ata duhet t'i shërbejnë shoqërisë si një tërësi, dhe se ardhmëria kulturore, sociale dhe ekonomike e një shoqërie kërkon në veçanti një investim të konsiderueshëm në arsimim të vazhdueshëm;
- 3) Se universitetet duhet t'u japin gjeneratave të ardhshme arsimim dhe aftësim që do t'i mësojë ata dhe nëpërmjet atyre të tjerët të respektojnë harmoninë në mes mjedisit të tyre natyror dhe jetës në përgjithësi.

Rektorët e universiteteve evropiane shpallin para të gjitha shteteve dhe ndërgjegjes së të gjitha kombeve parimet themelore të cilat tash dhe çdo herë duhet të mbështesin qëllimin e universiteteve.

PARIMET THEMELORE

1. Universiteti është institucion autonom në zemër të shoqërive të organizuara ndryshe për shkak të shtrirjes gjeografike dhe trashëgimisë kulturore. Prodhon , ngrit dhe përkrah kulturën nëpërmjet hulumtimit dhe mësimdhënies. Për t'i plotësuar nevojat e botës rreth tij, hulumtimi dhe mësimdhënia duhet të jenë moralisht dhe intelektualisht të pavaruara nga autoriteti politik dhe fuqia ekonomike.
2. Mësimdhënia dhe hulumtimi në Univiersitet duhet të jenë të pandara në mënyrë që të mos ngelin mbrapa nevojave të ndryshueshme, kërkesave të shoqërisë dhe avancimit të njohurive shkencore.
3. Liria për hulumtim dhe aftësim është parimi themelor i jetës universitare, dhe qeveritë dhe univeristetet, aq sa varet prej tyre, duhet të sigurojnë respektimin e kësaj kërkesë themelore.

Universiteti, duke refuzuar jotolerancën dhe duke qenë gjithmonë i hapur për dialog, është një vendtakim ideal për profesorët e aftë dhe të pajisur mirë për ta shpërndarë dhe ta zhvillojnë dijen e tyre me hulumtim dhe inovacion te studentët të aftë dhe të etshëm të pasurojnë mendjet e tyre me atë njohuri.

4. Universiteti është bartës i traditës humaniste evropiane; ai përkujdeset në mënyrë të vazhdueshme që të arrihet dija universale; për të përmbushur qëllimin e tij kalon kufinj të gjeografikë dhe politikë dhe afirmon nevojën vitale për njohjen dhe ndikimin reciprok të kulturave të ndryshme.

MJETET

Për t'i arritur këto qëllime dhe për t'i përcjellë këto parime kërkon mjete efektive , të përshtatshme për kushtet e tanishme.

1. Të ruhet liria për hulumtim dhe mësimdhënie, mjetet për realizimin e kësaj lirie duhet t'u bëhen të mundshme të gjithë anëtarëve të komunitetit të universitetit..
2. Punësimi i mësimdhënësve dhe rregullimi i statusit të tyre duhet t'i përmbahet parimit që hulumtimi është i pandashëm nga mësimdhënia.
3. Secili universitet duhet të sigurojë që liria e studentëve është e siguruar dhe që ata i gëzojnë kushtet në të cilat mund të fitojnë kulturën dhe mësimin të cilin ata kanë për qëllim ta arrijnë, me përjashtim të disa rrethanave të veçanta.
4. Universitetet, veçanërisht në Evropë, vlerësojnë shkëmbimin reciprok të informative dhe të dokumentacionit, dhe projekte e përbashkëta e të shpeshta për avancimin e studimit , si gjë esenciale për progres të qëndrueshëm të dijes. Prandaj, si në vitet e hershme të historisë së tyre, ata inkurajojnë lëvizjen e

studentëve dhe të mësimdhënësve; dhe konsiderojnë një politikë të përgjithshme të statusit, të titujve, të provimeve ekuivalente (pa paragjykim të diplomave kombëtare) si dhe dhënien e bursave si çështje qenësore për të përmbushur misionin e tyre në kushtet që mbizotrojnë sot.

Rektorët të cilët nënshkruajnë në emër të universitetit të tyre, ndërmarrin gjithçka që është brenda mundësive të tyre që të inkurajojnë secilin shtet, si edhe organizatat mbinationale relevante që të sajojnë më vendosmëri politikat e tyre në pajtim me këtë Përmbledhje parimesh (Magna Kartë), e cila shpreh dëshirën unanime të universiteteve të vendosura dhe të deklaruara lirisht.

Bolonjë, 18 shtator 1988

(Përkthimi në gjuhën shqipe: Bardha Qirezi)

LIRIA AKADEMIKE

Autonomia e bartësve të arsimit të lartë është e garantuar. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë që kanë licencën e punës “do të gëzojnë të drejtën e mësimdhënies dhe në rastin e universiteteve, në punën kërkimore shkencore në kuadër të licencave të tyre, pa ndërhyrje të autoriteteve publike në veprimtarinë e tyre, përveç rasteve që parashihen në dispozitat e këtij Ligji”. Në statutet e institucioneve të arsimit universitar përfshihen “dispozitat që garantojnë liritë akademike të personelit mësimdhënës dhe të studentëve: për të zgjedhur autoritetet drejtuese e administruese dhe për të përcaktuar mandatet e tyre; për të organizuar strukturat dhe aktivitetet e tyre përmes rregullave të tyre, të cilat duhet të jenë në përputhje me rregulloren e tanishme dhe dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të saj, dhe me ligjin e zbatueshëm; për të zgjedhur trupin pedagogjik dhe personelin tjetër, për të përcaktuar kushtet lidhur me pranimin e studentëve, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve; për të zhvilluar dhe zbatuar në mënyrë të pavarur planprogramet mësimore dhe projektet kërkimore shkencore; për të zgjedhur lëndët që duhen mësuar; dhe për të dhënë tituj për profesorët dhe personelin tjetër” etj

Bashkëpunimi i Universitetit dhe i institucioneve ligjdhënëse, i organeve qeverisëse të Kosovës, pastaj i atyre të qeverisjes lokale, i subjekteve shoqërore dhe ekonomike, i subjekteve qeveritare dhe joqeveritare me bartësit publik të arsimit të lartë, avancojnë marrëdhëniet e ndërsjella të institucioneve universitare dhe të shoqërisë bashkëkohore në tërësi.

Financimi i rregullt, i relatuuar në bazë të parimeve të qëndrueshme, ndikon në stabilizimin e rrejdhave të zhvillimit të veprimtarisë arsimore dhe shkencore të të gjitha institucioneve universitare. Burimet e financimi janë: fondet e dedikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë “për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm, të ardhurat nga “tarifat e shkollimit me pagesa të tjera që bëjnë studentët, pagesat “për shërbime komerciale dhe shërbime të tjera” dhe kontributet e tjera nga donacionet dhe dhuratat. Veprimtaria fitimprurëse gjithashtu ndikon në përmirësimin e pozitës materiale dhe të standardit më të mirë të punës arsimore dhe shkencore.

INSTITUCIONET E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

FAKULTETET

FAKULTETI FILOZOFIK

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

FAKULTETI I FILOLOGJISË

FAKULTETI JURIDIK

FAKULTETI EKONOMIK

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I ELEKTROTEKNIKËS

FAKULTETI I MAKINERISË

FAKULTETI I MJEKËSISË

FAKULTETI I ARTEVE

FAKULTETI I BUJQËSISË

FAKULTETI I XEHETARISË DHE METALURGJISË

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

FAKULTETI I MËSUESISË

FAKULTETI I EDUKIMIT

Struktura e këtyre institucioneve është mjaft komplekse. Si e tillë, që të jetë edhe më funksionale, në rrethana aktuale bëhet reformimi dhe modernizimi. Gjendja e tanishme paraqitet në tekstin vijues me të gjitha degët, departamentet, drejtimet dhe katedrat ekzistuese. Në të gjitha fakultetet funksionojnë shumë degë, seksione ose departamente dhe në kuadër të tyre edhe shumë drejtime të studimeve universitare, siç janë:

FAKULTETI FILOZOFIK- PRISHTINË

Departamenti i Pedagogjisë

Drejtimi Teoria e edukimit

Drejtimi Edukimi shkollor

Drejtimi Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Dega e Filozofisë

Dega e Etnologjisë

Dega e Historisë

Drejtimi i përgjithshëm

Departamenti i Shkencave Sociale

Drejtimi i Shkencave Politike dhe Administrim Publik

Drejtimi i Psikologjisë

Drejtimi i Sociologjisë

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE - PRISHTINË

Departamenti i Biologjisë

Drejtimi arsimor

Drejtimi aplikativ

Drejtimi Ekologji-mbrojtje e ambientit

Departamenti i Fizikës

Drejtimi arsimor
Drejtimi inxhinierik
Departamenti i Gjeografisë
Drejtimi Gjeografi e përgjithshme
Drejtimi Gjeologji – Gjeografi

Departamenti i Kimisë
Drejtimi arsimor
Drejtimi inxhinierik
Departamenti i Matematikës
Drejtimi teorik
Drejtimi -Matematikë-Informatikë
Drejtimi i shkencave kompjuterike
Drejtimi arsimor

FAKULTETI I FILOLOGJISË- PRISHTINË

Dega e Gjuhës Shqipe
Dega e Letërsisë Shqipe
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Frengje
Dega e Gjuhës Turke
Dega e Orientalistikës
Dega e Letërsisë së Përgjithshme dhe Krahhasimtare

FAKULTETI JURIDIK – PRISHTINË

Departamenti Juridik- Civil
Departamenti Juridik- Ndërkombëtar
Departamenti Juridik-Penal
Departamenti Juridik Kushtetues-Administrativ
Departamenti Historik dhe Sociologjik
Departamenti I Financave dhe i Ekonomisë

FAKULTETI EKONOMIK – PRISHTINË

Departamenti i Ekonomisë
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabiliteti
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë
Departamenti i Marketingut

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS – PRISHTINË

Departamenti i Ndërtimtarisë
Drejtimi i Konstrukcioneve

Drejtimi i Hidroteknikës
Drejtimi Ndërtim i Ulët (Rrugët dhe Hekurudhat)
Drejtimi Organizimi i ndërtimit
Seksioni i Arkitekturës

FAKULTETI I ELEKTROTEKNIKËS- PRISHTINË

Departamenti i Kompjuterikës
Departamenti i Telekomunikacionit
Departamenti i Elektronikës
Departamenti i Automatikës
Departamenti i Sistemeve Elektroenergjetike
Departamenti i Elektroenergjetikës Industriale

FAKULTETI I MAKINERISË – PRISHTINË

Departamenti i Prodhimtarisë dhe Automatizimit
Drejtimi Teknologjia e prodhimtarisë
Drejtimi Automatizimi i proceseve prodhuese
Departamenti i Termoenergjetikës dhe Termoteknikës
Drejtimi Teknika e ngrohjes dhe termoenergjetikës
Drejtimi Pajisjet procesore
Departamenti i Konstruktimit dhe Dizajnit
Drejtimi Konstruksionet Makinerike
Drejtimi Automjetet
Drejtimi Dizajni dhe Robotika
Departamenti i Komunikacionit
Drejtimi Komunikacioni rrugor

FAKULTETI I MJEKËSISË – PRISHTINË

Dega e Mjekësisë së Përgjithshme
Dega e Stomatologjisë
Dega e Farmacisë
Dega e Fizioterapisë

FAKULTETI I ARTEVE – PRISHTINË

Dega e Artit Figurativ

Drejtimi i pikturës
Drejtimi i skulpturës
Drejtimi i grafikës
Drejtimi i dizajnit grafik

Dega e Artit Muzikor

- Drejtimi i komponimit
- Drejtimi i dirigjimit
- Drejtimi i solo- këndimit
- Drejtimi i pianos
- Drejtimi i instrumenteve me harqe
- Drejtimi i instrumenteve me të fryer
- Drejtimi i pedagogjisë së përgjithshme muzikore
- Drejtimi i etnomuzikologjisë
- Drejtimi i muzikologjisë

Dega e Artit Dramatik

- Drejtimi i aktrimit
- Drejtimi i dramaturgisë
- Drejtimi i regjisë filmike
- Drejtimi i regjisë teatrore

FAKULTETI I BUJQËSISË – PRISHTINË

Departamenti Prodhimtari bimore

- Drejtimi Lavërtari
- Drejtimi Pemëtar- Vreshtari

Departamenti Prodhimtari blegtorale

- Departamenti Agroekonomi
- Departamenti Mbrojtja e bimëve
- Departamenti i Veterinarisë

FAKULTETI I XEHETARISË DHE METALURGJISË – MITROVICË

Departamenti i Xehetarisë

- Drejtimi Gjeoteknika
- Drejtimi Xehetaria

Departamenti i Gjeologjisë

- Drejtimi i Vendburimeve kimike dhe procesore
- Drejtimi i Hidrogjeologjisë dhe Gjeologjisë inxhinierike
- Drejtimi Gjeofizika
- Drejtimi Gjeoekologjia

Departamenti i Teknologjisë

- Drejtimi i Inxhinierisë kimike procesore
- Drejtimi i Inxhinierisë së përgatitjes së lëndëve të para
- Drejtimi i Inxhinierisë së mbrojtjes së mjedisit
- Drejtimi Teknologjia e artikujve organikë

Departamenti për Materiale dhe Metalurgji

- Drejtimi Metalurgji
- Drejtimi Materiale

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE – PRISHTINË

Departamenti i Edukacionit
Departamenti i Sportit

FAKULTETI I MËSUESISË

FAKULTETI I EDUKIMIT- PRISHTINË

Programi parashkollor
Programi fillor

Qendra në Prishtinë
Programi parashkollor
Programi fillor

Qendra në Gjiilan
Programi parashkollor
Programi fillor

Qendra në Prizren
Programi fillor

Qendra në Gjakovë
Programi fillor

II. SHKOLLAT E LARTA

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE, PRISHTINË
SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE “XHEVDET DODA”, PRIZREN
SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE “BAJRAM CURRI”, GJAKOVË
SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE “SKËNDERBEU”, GJILAN
SHKOLLA E LARTË TEKNIKE, MITROVICË
SHKOLLA E LARTË EKONOMIKE, PEJË
SHKOLLA E LARTË TEKNIKE, FERIZAJ
SHKOLLA E BIZNESIT, PEJË
Mësimi zhvillohet në shumë degë, departamente dhe drejtime:

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE – PRISHTINË

Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Dega Mësimi klasor
Dega Matematikë
Dega Fizikë-Kimi
Dega Edukatë e punës me Informatikë

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE “XHEVDET DODA”-PRIZREN

Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Dega Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Dega Matematikë
Dega Kimi- Fizikë
Dega Mësimi klasor

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE “BAJRAM CURRI” – GJAKOVË

Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Dega Matematikë me Informatikë
Dega Histori-Gjeografi
Dega Biologji-Kimi
Dega Mësimi klasor

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE “SKËNDERBEU” – GJILAN

Dega Mësimi klasor
Dega Edukatore për ente parashkollore

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE – MITROVICË

Departamenti i Informatikës
Departamenti Elektroenergjetika në prodhimtari
Departamenti i Makinerisë industriale
Departamenti i Mirëmbajtjes së sistemeve teknike
SHKOLLA E LARTË EKONOMIKE, PEJË

SHKOLLA E BIZNESIT – PEJË

Departamenti: Administrim biznesi(Mësimi zhvillohet edhe në gjuhën boshnjake)
Departamenti: Informatika e aplikuar në biznes
Departamenti: Menaxhmenti në turizëm dhe hotelieri

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE – FERIZAJ

Drejtimi i industrisë së drurit-profil i përpunimit të drurit
Drejtimi Teknikë e përpunimit të materialeve artificiale- plastmasave

Vërejtje: Pasqyra e planeve dhe e kuadrit mësimor të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 1999-2000 është përfshirë në botimin jubilar të 30-vjetorit të Universitetit, Prishtinë, 2000

Për vitin akademik 2003/2004 është shpallë KONKURSI (Shih “Zëri”, 18 qershor 2003) për regjistrimin e studentëve të rinj (në vitin e parë në fakultete do të regjistrohen 5011

studentë dhe në shkollat e larta 505 studentë, pra gjithsej 5516 studentë) në këto institucione të arsimit të lartë të Kosovës:

FAKULTETI FILOZOFIK- PRISHTINË

Departamenti i Sociologjisë

Departamenti i Pedagogjisë

Drejtimi Teoria e edukimit

Drejtimi Edukimi shkollor

Drejtimi Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Departamenti i Filozofisë

Departamenti i Historisë

Departamenti i Pedagogjisë

Departamenti i Shkencave Politike dhe Administratë Publike

Departamenti i Psikologjisë

Departamenti i Etnologjisë

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE - PRISHTINË

Departamenti i Biologjisë

Drejtimi arsimor

Drejtimi aplikativ

Drejtimi Ekologji-mbrojtje e ambientit

Departamenti i Fizikës

Drejtimi arsimor

Drejtimi inxhinierik

Departamenti i Gjeografisë

Drejtimi Gjeografi e përgjithshme

Drejtimi Gjeologji – Gjeografi

Departamenti i Kimisë

Drejtimi arsimor

Drejtimi inxhinierik

Departamenti i Matematikës

Drejtimi Informatikë

Drejtimi i Shkencave kompjuterike

Drejtimi arsimor

FAKULTETI I FILOLOGJISË- PRISHTINË

Dega e Gjuhës Shqipe

Dega e Letërsisë Shqipe

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Frengje

Dega e Gjuhës Turke

Dega e Orientalistikës

Dega e Letërsisë së Përgjithshme dhe Krahaskimtare

FAKULTETI JURIDIK – PRISHTINË

FAKULTETI EKONOMIK – PRISHTINË

Departamenti Ekonomik
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë
Departamenti i Marketingut

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS – PRISHTINË

Seksioni i Ndërtimtarisë
Drejtimi i Konstrukcioneve
Drejtimi i Hidroteknikës
Seksioni i Arkitekturës

FAKULTETI ELEKTOTEKNIK- PRISHTINË

Departamenti i Kompjuterikës
Departamenti i Telekomunikacionit
Departamenti i Elektronikës
Departamenti i Automatikës
Departamenti i Sistemeve Elektroenergjetike
Departamenti i Elektroenergjetikës Industriale

FAKULTETI I MAKINERISË - PRISHTINË

Departamenti i Prodhimtarisë dhe Automatizimit
Drejtimi Teknologjia e prodhimtarisë
Drejtimi Automatizimi i proceseve prodhuese
Departamenti i Termoenergjetikës dhe Termoteknikës
Drejtimi Teknika e ngrohjes dhe termoenergjetikës
Drejtimi Pajisjet procesore
Departamenti i Konstruktimit dhe Dizajnit
Drejtimi Konstruksionet Makinerike
Drejtimi Automjetet
Drejtimi Dizajni dhe Robotika
Departamenti i Komunikacionit
Drejtimi Komunikacioni rrugor

FAKULTETI I MJEKËSISË – PRISHTINË

Dega e Mjekësisë së Përgjithshme
Dega e Stomatologjisë
Dega e Farmacisë

Dega e Fizioterapisë

FAKULTETI I ARTEVE – PRISHTINË

Dega e Artit Figurativ

Drejtimi i pikturës

Drejtimi i skulpturës

Drejtimi i grafikës

Drejtimi i dizajnit grafik

Drejtimi i skenografisë

Dega e Artit Muzikor

Drejtimi i komponimit

Drejtimi i dirigjimit

Drejtimi i solo- këndimit

Drejtimi i pianos

Drejtimi i instrumenteve harkore

Drejtimi i instrumenteve me të fryrë

Drejtimi i pedagogjisë së përgjithshme muzikore

Dega e Artit Dramatik

Drejtimi i aktrimit

Drejtimi i dramaturgisë

Drejtimi i regjisë filmike

Drejtimi i regjisë teatrore

FAKULTETI I BUJQËSISË – PRISHTINË

Departamenti Prodhimtari bimore

Drejtimi Lavërtari

Drejtimi Pemëtar- Vreshtari

Departamenti Prodhimtari blegtorale

Departamenti Agroekonomi

Departamenti Mbrojtja e bimëve

FAKULTETI I XEHETARISË DHE METALURGJISË – MITROVICË

Departamenti i Xehetarisë

Drejtimi Gjeoteknika

Drejtimi Xehetaria

Departamenti i Gjeologjisë

Drejtimi i Vendburimeve kimike dhe procesore

Drejtimi i Hidrogjeologjisë dhe Gjeologjisë inxhinierike

Drejtimi Gjeofizika

Drejtimi Gjeoeekologjia

Departamenti i Teknologjisë

Drejtimi i Inxhinierisë kimike procesore

Drejtimi i Inxhinierisë së përgatitjes së lëndëve të para

Drejtimi i Inxhinierisë së mbrojtjes së mjedisit
Drejtimi Teknologjia e artikujve organikë
Departamenti Materiale dhe Metalurgji
Drejtimi Metalurgji
Drejtimi Materiale

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE – PRISHTINË

Departamenti i Edukacionit
Departamenti i Sportit

FAKULTETI I EDUKIMIT- PRISHTINË

Qendra në Prishtinë

Programi parashkollor
Programi fillor
Programi për shkollën e mesme të ulët
Drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Drejtimi Matematikë-Informatikë
Drejtimi Informatikë –Teknologji
Drejtimi Fizikë-Kimi
Drejtimi Gjuhë Angleze

Qendra në Gjilan

Programi parashkollor
Programi fillor
Programi për shkollën e mesme të ultë
Histori- Edukatë Qytetare
Gjeografi- Edukatë Qytetare

Qendra në Prizren

Programi fillor
Programi për shkollën e mesme të ulët
Drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Drejtimi Matematikë- Informatikë
Drejtimi Fizikë- Kimi
Drejtimi Gjuhë Angleze

Qendra në Gjakovë

Programi fillor
Programi për shkollën e mesme të ulët
Drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Drejtimi Matematikë-Informatikë

Drejtimi Fizikë-Kimi

Histori- Edukatë Qytetare

Gjeografi- Edukatë Qytetare

Në të gjitha fakultetet funksionojnë shumë degë, seksione ose departamente dhe në kuadër të tyre edhe shumë drejtime të studimeve universitare

II. SHKOLLAT E LARTA

Dega Mësimi klasor

Dega Edukatore për ente parashkollore

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE – MITROVICË

Departamenti i Informatikës

Departamenti Elektroenergjetika në prodhimtari

Departamenti i Makinerisë industriale

Departamenti i Mirëmbajtjes së sistemeve teknike

SHKOLLA E BIZNESIT – PEJË

Departamenti: Administrim biznesi(Mësimi zhvillohet edhe në gjuhën boshnjake)

Departamenti: Informatika e aplikuar në biznes

Departamenti: Menaxhmenti në turizëm dhe hotelieri

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE – FERIZAJ

Departamenti i industrisë së drurit-profil i përpunimit të drurit

Departamenti i Makinerisë

Drejtimi i përpunimit të materialeve artificiale- plastmasave

Vërejtje: Pasqyra e planeve dhe e kuadrit mësimor të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 1999-2000 është përfshirë në botimin jubilar të 30-vjetorit të Universitetit, Prishtinë, 2000

STUDIMET E MAGJISTRATURËS

Fakulteti Filozofik

Dega e Historisë

Dega e Pedagogjisë

Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore

Dega e Kimisë

Drejtimi i Kimisë Analitike, Inorganike, Organike, Fizike dhe e Mjedisit

Dega e Matematikës

Drejtimi i Matematikës Analitike

Drejtimi i Algjebrës me Gjeometri

Fakulteti i Filologjisë

Drejtimi i Gjuhësisë
Drejtimi i Letërsisë

Fakulteti Juridik

Drejtimi Juridik-Penal, Civil, Administrativ- Kushtetues dhe Juridik
Ndërkombëtar

Fakulteti Ekonomik

Drejtimi i Menaxhmentit
Drejtimi i Financave

Fakulteti i Arteve

Drejtimi i Grafikës
Drejtimi Dizajni Grafik
Drejtimi i Pikturës
Drejtimi i Skulpturës
Drejtimi i Solo këndimit
Drejtimi i Pedagogjisë Muzikore

Fakulteti i Mjekësisë

Drejtimi i lëndëve kirurgjike, internistike, të mjekësisë eksperimentale dhe të
Mjekësisë

Fakulteti Elektroteknik

Fakulteti i Makinerisë

Departamenti Makineri prodhuese
Makineri Termoenergjetike dhe Termoteknike, Komunikacionit
Drejtimi Konstrukcione Makinerike

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës

Drejtimi i Hidroteknikës

Studimet e magistraturës në menaxhment shëndetësor (Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti
i Mjekësisë)

Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Mitrovicë

Drejtimi Materialet, bazat dhe përdorimi
Inxhiera e mbrojtjes së ambientit

Fakulteti i Edukatës Fizike, Prishtinë

SHËNIME STATISTIKORE

PERSONELI I RREGULLT MËSIMOR GJATË VITIT AKADEMIK 2001/2002

FAKULTETET	936
SHKOLLAT E LARTA	88
GJITHSEJ	1 024
PERSONELI MËSIMOR I ANGAZHUAR ME PUNË PLOTËSUESE 2001/2002	
FAKULTETET DHE SHKOLLAT E LARTA	249
PERSONELI I RREGULLT MËSIMOR GJATË VITIT AKADEMIK 2002/ 2003	
FAKULTETET DHE SHKOLLAT E LARTA	944
PERSONELI ADMINISTRATIV TEKNIK	
	410
NUMRI I PËRGJITHSHËM I STUDENTËVE NË VITIN AKADEMIK 2001/2002	
FAKULTETET	16 298
SHKOLLAT E LARTA	4 900
GJITHSEJ	21 198
NUMRI I STUDENTËVE TË DIPLOMUAR NË PERIU DHËN /01 TETOR 2001 - 30 SHTATOR 2002/	
FAKULTETET	1 617
SHKOLLAT E LARTA	758
GJITHSEJ	2 375
PLANI I REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE SIPAS KONKURSIT 2002/2003	
FAKULTETET	4 817
SHKOLLAT E LARTA	1 020
GJITHSEJ	5 837

Nomenklatura e profesioneve është shumë e gjerë. Me hapjen e degëve dhe të fakulteteve të reja ajo zgjerohet edhe më shumë. Në planin strategjik të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës parashihet dinamika e zhvillimit të arsimit të lartë gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme. Në organet e Universitetit dhe sidomos në Senat janë dhënë propozime për

themelimin e universiteteve të tjera në Kosovë. Duke pasur pasur parasysh gjendjen e tanishme dhe problemet aktuale të finacimit, nuk janë miratuar propozimet e paraqitura. Me këtë rast, duke pasur si orientim perspektiven e zhvillimit të ardhshëm të arsimit të lartë, shpreh bindjen time të thellë se është e arsyeshme të themelohet Universiteti i Arteve në Prishtinë dhe Universiteti tjetër me seli në Prizren. Disa fakultete, si njësi përbërëse mund të themelohen edhe në qendrat më të mëdha të Kosovës, siç janë: Mitrovica, Peja, Gjakova, Gjilani, Ferizaj etj.

VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE INSTITUTET UNIVERSITARE

Në shumë universitete evropiane, përveç veprimtarisë arsimore dhe shkencore, zhvillohet edhe veprimtaria kërkimore- shkencore në institutet universite. Kjo e pasuron dukshëm veprimtarinë e përgjithshme të arsimit të lartë. Institutet ekzistuese të Universitetit të Prishtinës, pa u përfshirë në kuadër të programeve të zhvillimit të Kosovës, nuk arrijnë të konsolidohen dhe të realizojnë programin e veprimtarisë së tyre.

BIBLIOTEKAT:

BIBLIOTEKA KOMBËTRARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

Bibliotekat e Fakultetit të Filologjisë:

- Biblioteka e Albanologjisë
- Biblioteka e Sllavistikës
- Biblioteka e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Angleze
- Biblioteka e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Frenge
- Biblioteka e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
- Biblioteka e Orientalistikës dhe Degës së Gjuhës Turke
- Biblioteka e Austrisë

Biblioteka e Fakultetit Filozofik

Biblioteka e Fakultetit Juridik

Biblioteka e Qendrës për të Drejtat e Njeriut

Biblioteka e Qendrës Juridike të Kosovës

Biblioteka e Fakultetit Ekonomik

Biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë

Biblioteka e Fakultetit Elektroteknik

Biblioteka e Fakultetit të Makinerisë

Biblioteka e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Biblioteka e Fakultetit të Arteve

Bibliotekat e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore

Biblioteka e Departamentit të Matematikës

Biblioteka e Departamentit të Fizikës

Biblioteka e Departamentit të Kimisë

Biblioteka e Departamentit të Biologjisë

Biblioteka e Departamentit të Gjeografisë

Biblioteka e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Mitrovicë

Biblioteka e Shkollës së Biznesit (Pejë)

Biblioteka e Fakultetit të Kulturës Fizike

Biblioteka e Fakultetit të Bujqësisë

Biblioteka e Fakultetit të Xehtarisë dhe të Metalurgjisë (Mitrovicë)
Biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike (Prishtinë)
Biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” (Gjakovë)
Biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” (Prizren)
Biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike “Skënderbeu” (Gjilan)
Biblioteka e Shkollës së Lartë Teknike (Mitrovicë)
Biblioteka e Shkollës së Lartë Teknike (Ferizaj)
(Në kuadër të Universitetit funksionojnë 32 biblioteka të fakulteteve, të shkollave të larta, të departamenteve, të degëve dhe të seksioneve ekzistuese.)

SEMINARET:

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN LETËRSINË DHE KULTURËN
SHQIPTARE – PRISHTINË
UNIVERSITETI VEROR NDËRKOMBËTAR I KOSOVËS – PRISHTINË

QENDRAT KULTURORE:

ESPACE CULTUREL FRANÇAIS (Fakulteti i Filologjisë)
(QENDRA KULTURORE FRANCEZE)
ART QENDRA (Fakulteti i Arteve)
QENDRA JURIDIKE E KOSOVËS
QENDRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

UNIVERSITETI DHE JETA KULTURORE

REVISTAT UNIVERSITARE:

FILOLOGJI (Fakulteti i Filologjisë), Prishtinë
SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN
SHQIPTARE (Fakulteti i Filologjisë), Prishtinë
E DREJTA (Fakulteti Juridik), Prishtinë
ECONOMIA (Fakulteti Ekonomik), Prishtinë
BULETIN i Fakultetit Filozofik (Fakulteti Filozofik), Prishtinë
BULETINI I FSHMN (Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore)
PERMBLEDHJE E PUNIMEVE (Shkolla e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda”- Prizren)
ARS POETICA (Fakulteti i Arteve), Prishtinë
BOTA E RE (Gazetë e studentëve të Universitetit të Prishtinës)
BULETINI (Shkolla e Lartë Pedagogjike ,Gjilan)
BULETIN (Shkolla e Lartë Pedagogjike, Gjakovë)

Në kuadër të temës bosht të kësaj Konferece shkencore “Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore”, por edhe të temave të veçanta, të përfshira në programin e tërësishëm, do të trajtohen edhe temat vijuese:

UNIVERSITETI DHE ROLI I TIJ NË ZHVILLIMIN E MARRËDHËNIEVE
DEMOKRATIKE NË SHOQËRI

AUTONOMIA E UNIVERSITETIT DHE E INSTITUCIONEVE UNIVERSITARE
FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË
HARTIMI I AKTEVE JURIDIKE DHE ZBATIMI I TYRE
REFORMA UNIVERSITARE – PROCES I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT
PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE
MODELET E STUDIMEVE DHE DIPLOMAT UNIVERSITARE
ZBATIMI I METODAVE BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES
VLERËSIMI DHE AKREDITIMI NË ARSIMIN E LARTË
PËRGATITJA DHE PËRDORIMI I TESTEVE OBJEKTIVE
ZBATIMI I SISTEMIT EVROPIAN PËR TRANSFER TË KREDIVE- ECTS
KËRKIMET SHKENCORE DHE INOVACIONET
REALIZIMI I PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN E UNIVERSITETIT
KUADRI ARSIMOR DHE SHKENCOR SOT DHE NË PERSPEKTIVË
BAZA MATERIALE E UNIVERSITETI
 BUXHETI VJETOR
 BURIME TË TJERA
 VEPRIMTARIA FITIMPRURËSE E UNIVERSITETIT
PAGAT E PERSONELIT MËSIMOR DHE TE PUNONJËSVE TË TJERË
OBJEKTET UNIVERSITARE DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL I TYRE
TEKNOLOGJIA BASHKËKOHORE, PAJISJET DHE LABORATORËT
STANDARDI I STUDENTËVE DHE KUSHTET E STUDIMIT
STRUKTURAT QEVERISËSE TË UNIVERSITETIT
QEVERISJA DHE FINANCIMI
TEKNOLOGJIA BASHKËKOHORE UNIVERSITARE

INFORMIMI

VLERËSIMI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM PËR VEPRIMTARINË E SOTME TË INSTITUCIONEVE UNIVERSITARE

PLANIFIKIMI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E UNIVERSITETIT

BASHKËPUNIMI I UNIVERSITETIT ME SUBJEKTE TË TJERA SHOQËRORE

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I UNIVERSITETIT

Universiteti i Prishtinës bashkëpunon me këto institucione të jashtme universitare, siç janë:

1. UNIVERSITETI I TIRANËS, SHQIPËRI-
2. UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, SHQIPËRI-
3. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, SHQIPËRI-
4. UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN, SHQIPËRI
5. UNIVERSITETI I SHKODRES, SHQIPËRI-
6. UNIVERSITETI I TETOVËS- IRJ E MAQEDONISË-
7. UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, IRJ E MAQEDONISË -
8. UNIVERSITY OF MARIBOR, SLOVENI-
9. UNIVERSITETI I SARAJEVËS, BOSNJA DHE HERCEGOVINA-
10. UNIVERSITETIN E ZAGREBIT, KROACI
11. UNIVERSITA DEGLI STUDI DI PADOVA, ITALI-
12. UNIVERSITETIN E FIRENCËS, ITALI-
13. UNIVERSITA DEGLI STUDI DI FIRENZE, ITALI-
14. UNIVERSITA DEGLI STUDI DI TRIESTE, ITALI-
15. POLITECNICO DI MILANO, ITALI
16. UNIVERSITA "LA SAPIENZA", ROME, ITALI-
17. FREIE UNIVERSITÄT BERLIN, GJERMANI-
18. UNIVERSITETI "FRIEDRICH SCHILLER", GJERMANI-
19. FRIEDRICH ALEXSANDER-UNIVERSITÄT ERLANDER, NURNBERG
20. KARL VON OSSIETZKY UNIVERSITÄT, OLDENBURG-GJERMANI
21. UNIVERSITETI I GRACIT, AUSTRI-
22. TECHNISCHE UNIVERSITÄT, AUSTRI
23. INSTITUTI I LARTE POLITEKNIK I JASHIT, RUMANI-
24. UNIVERSITETI "ETVASH LORAD", HUNGARI-
25. UNIVERSITE D'Auvergne- CLERMONT- FERRAND, FRANCË-
26. UNIVERSITE MONTESQUI - BORDEAUX
27. VÄXJÖ UNIVERSITY, SUEDI-
28. TECHNICAL UNIVERSITY OF CATALONIA, SPANJË-
29. UNIVERSITETI I "VALLADOLLE" SPANJE-
30. INSTITUTE JUAN LUSI VIVES BARCELONA SPANJË
31. UNIVERSITETI "MARMARA", TURQI-
32. UNIVERSITY OF GEORGIA, SHBA-

33. ILLINOIS INSTITUTE OF TECHNOLOGY, SHBA-
34. LA ROCHE COLLEGE -USA
35. PITTSBURG UNIVERSITY-USA
36. PENNSYLVANIA UNIVERSITY-USA
37. ARIZONA STATE UNIVERSITY -USA
38. WORLD UNIVERSITY SERVICES (WUS), AUSTRI-
39. CRE INSTITUTIONAL EVALUATION PROGRAMME
40. EUROPEAN DISTANCE EDUCATION NETWORK (EDEN)-
41. EUROPERAN UNIVERSITY ASSOCIATION
42. DANUB RECTORS' CONFERENCE
- CRE INSTITUTIONAL EVALUTION PROGRMME –
- UNIVERSITETI SHTETËROR I ARIZONËS- SHBA-

Disa tema të rëndësishme të kësaj problematike të gjerë dhe aktuale do të trajtohen në tri seance të kësaj Konference shkencore dhe në diskutimet e pjesëmarrësve. Pyetjet dhe përgjigjet janë gjithashtu në funksion të ndriçimit dhe të kristalizimit të çështjeve që lidhen me veprimtarinë dhe me zhvillimin e Universitetit dhe të arsimit të lartë në Kosovë dhe më gjerë. Për temat e tjera në të ardhmen do të planifikohet të organizohen debate dhe konferenca të posaçme, në të cilat do të zhvillohet dhe kompletohet edhe më tej mendimi kritik e analitik. Kontributi i dhënë në këto aktivitete shkencore është në funksion të zhvillimit të Universitetit dhe të shoqërisë bashkëkohore.

What does Kosovo Need its University to be?
Presentation at the Scientific Conference: University and Contemporary Society

Prishtina, 16-17 November 2002

Dr. Laurence Walker

**Kosovo Educator Development Project [KEDP]
University of Calgary, Alberta, Canada**

Introduction

My first thesis is that universities in Canada, and in other countries, are no longer thought of as “ivory towers,” deliberately separate and aloof from their communities. They are now actively engaged with many community partnerships. They have clearly defined and explicit social mandates, and they are externally accountable for the quality and relevance of their work for society. This major change came as a result of pressures from outside the universities, from tax payers who were no longer willing to pay for universities without some say in how they operate.

My second thesis is that the University of Prishtine is likely to face pressures to change in the near future. If you anticipate what these pressures will be, and plan strategically to cope with them, your university could be a better institution, not just surviving, but even thriving.

From ivory towers to social mandate

As “Ivory Towers,” Universities were often isolated from real life, offering education that was formal and academic, not connected with students’ experiences, and carrying out research that sometimes seemed to be disconnected from social issues in the real world. Protected by academic freedom and tenure, professors could choose to teach what they liked, conduct research if they liked and provide some service to the community if they liked. There was little real compulsion and little accountability. There was no explicit social mandate; most people took it for granted what universities were for and didn’t question how well they were doing it. Members of the public thought that university professors had very easy jobs and didn’t expect professors to be useful in the real world.

In 2002 the situation has changed drastically. In the 1990’s governments found they had to face up to growing debt. One way most governments set about reducing budget deficits

was to cut back on funding for universities which meant that universities had to find money elsewhere. Tuition costs went up much faster than inflation. At my Canadian university students pay nearly \$4,000 (2600 Euros) per year for tuition. Not only that, but governments frequently tell the university what the annual government grant should be spent on (more mathematics, science and technology; less history, philosophy, religious studies). Governments demand to know what has been achieved and what evidence there is that the work being done is being done well: accountability is part of every university's administrators' vocabulary. You have to have real data to prove that you are a successful institution.

So universities have had to adapt to a new world of accountability and restraint. Partly this has come about because society has abandoned the old commitment to the younger generation that because post-secondary education was a value to the society, society should provide it either for free or at a low cost to the student or the students' parents. This contract between the older generation providing, through high levels of taxation, cheap or free university education to the younger generation has been terminated. University education is seen as a personal benefit that should increasingly be funded from personal or family budgets.

The effects of change on universities?

1. In addition to increasing tuition fees, universities have had to increase their enrolment to boost even further their revenue from this source. Recruiting students has become a vital function. It is important not only to recruit enough students to pay the bills but to attract the best students in competition with other universities. Rectors know that research tells us that good students make a good university. Universities now have very sophisticated recruitment departments directed by an administrator at the level of a dean.
2. Recruitment has also become part of a larger effort to "sell" the university not only to students but to business, employers, politicians and the general public. Universities now have marketing departments, responsible for projecting the image of the university. In 1996 I was made responsible for developing the first marketing plan for my university. The plan included what our advertising should emphasize. Marketing research told us what students believed were our best features as a university: smaller classes ("You will know your professors and they will know you"); opportunities to work on research projects with professors even for undergraduate students; excellent teaching; opportunities to learn through the use of technology; an emphasis on students' academic and social needs ("We will help you to succeed").
3. Strategic planning (to prosper and adapt to changing needs) has become necessary in order to survive and thrive in a competitive environment of higher education. Think about the UP as I describe the kind of thinking that will be required as you plan strategically:
 - a) state clearly and with impact your unique social mandate as a university. Often this statement appears as a mission statement: what you exist to do

within your community (of Kosovo, for example). In crafting a mission statement, you pay attention to your traditions and your strengths: small classes, world-class research environment, quality teaching by professors who value teaching and research, flexible delivery methods (on-campus classes, off-campus classes, distance delivery; practical work experience combined with academic study; relevance of programs to employment; quality of libraries, national reputation for certain departments, etc.

- b) And you pay attention to the needs of your society. What kind of graduates does it need? The best evidence of the real needs of society lies in your employment records: what kinds of graduates get jobs? How well do your graduates do in the job market? Or how well do they do in post graduate work at other institutions?
- c) Of course you have to make sure you speak truthfully in your recruiting campaigns. It's no good and even harmful if students come to your university and fail to find the quality of experience that you promised. It does more damage to raise expectations and then fail to meet them than to present and meet mediocre expectations.
- d) You have to provide evidence about how well you are achieving your goals and objectives. What evidence do you have to show that teaching is of high quality? Most universities now routinely administer course evaluations by students: anonymous questionnaires with results made available to the instructor and to the Dean. Some universities require detailed annual reports by all professors in which they give a formal written account of their teaching and evidence of their successes as teachers. Career progress depends on these reports, which include research and service achievements. Faculty members have become much more accountable.
- e) Universities have become accountable too through the magazine and newspaper media. It has become fashionable for newspapers and magazines to collect enormous amounts of data on the quality of all universities in the country on a number of factors such as: library resources, research output, grade point averages of incoming first year students, number of senior professors teaching first year classes, number of international students, and extent of technological resources. The results are published in the form of rankings. To be top in your category (small, medium or large) is very significant because it gives you a big boost in recruitment. To come out near the bottom is little short of a disaster. Universities don't like these media reports but they cannot avoid them. They provide a forced incentive for improvement.
- f) Students who pay large tuition fees tend to be more demanding than those whose post-secondary education is free. Fee-payers expect their professors to be knowledgeable in their fields, to be punctual, to use varied and effective teaching skills, to care about their students' learning, to be available when they need help, and to be scrupulously fair.

Some thoughts about strategic planning at the UP

At the UP what might you think about if you were to start strategic planning? For a start, I believe you should look at one big issue; the fact the University of Prishtine is the only real post-secondary institution in Kosovo. That means it is the only choice for young people who want to study beyond high school, whether they have academic aptitudes, ability and motivation or not. So you have a large range of ability and ambition in the students you admit each year. Many seem to fail to complete their first year of study. A large part of the University's resources are spent teaching first year students many of whom go no further. What a waste of students' time, the University's time and what a waste of Kosovo's resources! How could you plan to solve that fundamental problem of being asked to do everything for everyone? Your current mission statement could be stated with some truth as "At the UP we try to do everything for everybody." The trouble is you're bound to fail. There's no way you could succeed. Kosovo, I believe, does not need you to be all things to all people.

In a very large strategic sense, would it be a good idea to think about some alternative post-secondary institutions for those students who wish to study past high school, but who really do not want an academic program? In most countries, alternatives to universities are found in the form of community colleges or technical and vocational colleges that offer practical training for occupations such as computer technicians, food services staff, carpenters, electricians, heavy equipment operators, horticulturalists, farmers, hospitality and tourism workers and so on and so on. Does Kosovo not need such people? Where do they get training now? I think Kosovo urgently needs many skilled craftsmen and fewer aspirants to an academic degree.

I believe that such colleges offering programs such as these would draw off many of the students who currently hang about the halls of the University now rather lost in a world of academia that offers them no future.

That would give you a chance to start thinking of academic quality in programs with higher standards. In the present situation you could not honestly make any claims in a mission statement to traditions of quality. Give your professors a chance to be good. Could you reduce your student enrolment, cut the number of professors and pay the others a decent salary!

Then with fewer students and faculty, could you put more money into labs and the library? Could you increase the spending on infrastructure: for example, give deans a travel budget so they can get out into the high schools of Kosovo to talk to students about their hopes and dreams. Don't think that the cell phone is the answer to all communication needs between a university and its community!

A second general question in strategic planning is: could examine the basic rationale for your programs: the preparation of so-called experts with undergraduate degrees. I don't understand why Kosovo needs graduates who have studied single subjects only. If most of the students you admit each year were to graduate, what would so many

experts in single subjects such as biology, chemistry, physics, language or literature music, drama, figurative art, physical education, philosophy, history. sociology do to earn a living, besides teach in the high schools?

I'm not saying you should change this, only that you would be wise to examine openly the rationale for this kind of academic education. Maybe you could show that Kosovo needs such graduates: I am only skeptical. But I have worked in environments that value breadth in study across the disciplines as well as depth in one. It's the liberal education approach. That's not part of your tradition.

I hope I have provoked you, not to anger but to thought about some of the questions you can ask about your university. Everything I have said comes from the sincere wish that the University of Prishtine can thrive and prosper as an institution that the people of Kosovo are proud of. I am pleased to have had this chance to join in your conversations about this very important question of the relationship between the university and the society it serves.

Prof. Dr. Riza SMAKA¹

SHOQËRIA BASHKËKOHORE NË TRANSICION DHE UNIVERSITETI I SAJ

SHOQËRIA BASHKËKOHORE NË TRANSICION

Në suazat e shoqërisë bashkëkohore evropiane, kryesisht, koekzistojnë dy tipe të shoqërive, njera si shoqëri kontemporane në një shkallë të lartë të zhvillimit dhe të përparimit shoqëror, ekonomik, teknik, teknologjik, kulturor e shkencor, në një anë dhe tjetra, që karakterizohet me shkallë më të ulët të zhvillimit dhe të përparimit të përgjithshëm, në anën, tjetër. Tipi i dytë i shoqërive politike aspiron që nëpërmjet masave, mjeteve dhe metodave të ndryshme të krijojnë kushte për integritet në të gjitha sferat e të parave. Në atë drejtim, disa shoqëri politike kanë bërë dhe kanë arritur më shumë, ndërsa, disa të tjera, nga shkaqe më se të ndryshme, më pak apo gjithnjë ndodhen në stadin fillestar të transformimeve dhe të progresit.

Kosova, faktikisht bën pjesë në radhën e dytë të shoqërive politike të cilat ndodhen në stadin e transformimeve shoqërore të përgjithshme.

UNIVERSITETI NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT DHE TË PËRPARIMIT SHOQËROR

Universiteti, në kuadrin e shoqërisë respektive, kurdoherë ka qenë, është dashur dhe duhet të jetë i establishtuar dhe i funksionalizuar në favor të saj, si themeluese dhe financuese e tij.

Universiteti, si institucion i arsimit të lartë, veçanërisht në shoqëritë politike në transicion, ka rol të veçantë dhe të pazëvendësueshëm në funksion të zhvillimit dhe të përparimit shoqëror të përgjithshëm, në një anë dhe, në favor të transformimeve kualitative shoqërore, politike, kulturore, arsimore e shkencore, në anën tjetër.

Shoqëria politike që ndodhet në fazën e transicionit të përgjithshëm, po që se aspiron që atë proces të gjatë dhe të mundimshëm, ta përballë me sukses, ndër të tjara duhet të bëjë shumë investime në universitet, në mënyrë që të bashkëkohësojë dhe, mëpastaj, të vejë në funksionin të objektivit të tij. Rrjedhimisht, universiteti do të duhet të vejë në funksion të zhvillimit dhe të përparimit të hovshëm të shoqërisë respektive. Ndërkaq, për të ushtruar rol relevant në shoqëri, universiteti duhet të ketë pozitë shoqërore meritore dhe status shoqëror adapt me rolin dhe funksionin e vet. Universiteti bashkëkohor, ndër të tjera, duhet të sigurojë aftësimin profesional, arsimor dhe shkencor të shoqërisë si dhe ngritjen dhe kultivimin kulturor të saj.

¹ Riza SMAKA, është profesor universitar i lëndës E DREJTA BIZNESORE & E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE, autor i 99 punimeve profesionale dhe shkencore të kumtuara dhe të publikuara, i tri teksteve universitare; aktualisht është kryetar i Shoqatës së Juristëve të Kosovës, antar i Komisionit të Përbashkët të UNMIK-ut për Cështjet Legjislative

SHOQËRIA KOSOVARE DHE UNIVERSITETI

Shoqëria kosovare, aktualisht, ndodhet në fazën e transformimeve rrënjësore në të gjitha sferat e jetës shoqërore; ajo aktualisht nuk ka status politik e juridik të definuar përfundimisht, pra ndodhet në një etapë të definimit të pozitës politike dhe juridike të përkohshme, nën administrimin civil dhe ushtarak ndërkombëtar të përkohshëm.²

Në realitetin kosovar, rendi juridik i tij, konsiston në tri burime juridike të veçanta, të krijuara në kohë dhe rrethana shoqërore më se të ndryshme. Një stratum i burimeve juridike daton nga YU II (1945- 1992), i dyti, nga legjislati i Kosovës gjatë periudhës 1945 – 1989 dhe, i treti, nga aktet juridike të përgjithshme të karakterit ligjor, të emërtuara rregullore dhe të adoptuara nga legjislativi ndërkombëtar për Kosovën (UNMIK-u); në kohë të fundit, akte ligjore kanë filluar të miratohen edhe nga Kuvendi i Kosovës.

Aktet juridike të tilla të rendit juridik të Kosovës, në raste të shpeshta, janë në kundërthënie të ndërsjellë , në një anë dhe, me to, një spektër i konsideruar i jetës shoqërore, nuk është i rregulluar, në anën tjetër.

ÇËSHTJE AKTUALE DHE AKUTE UNIVERSITARE NË SHOQËRINË KOSOVARE

Aktualisht, Kosova, ka vetëm një universitet, Universitetin e Prishtinës. Ky Universitet është i karakterit publik.

Konform me standardet e përgjithshme të vendeve të përparuara, në Kosovë ka bazë dhe nevojë për themelim dhe funksionalizime edhe të universiteteve tjera të karakterit publik dhe privat. Në atë mënyrë, ndër të tjera, do të favorizohej parimi i konkurrencës akademike afirmative, në një anë dhe, do të krijoheshin kushte më të favorshme për përfshirje shumë më të gjerë të rinjve dhe të rejave në studime universitare shumë më cilësore dhe përmbajtësore.

Universiteti i Prishtinës, aktualisht ka status juridik të vetëm, ashtu që, fakultetet që atë e përbejnë, nuk disponojnë subjektivitete juridike. Universiteti i Prishtinës, sipas zgjidhjeve juridike aktuale, si subjekt juridik, praktikisht i ushtron të gjitha funksionet relevante sipas prerogativave të centralizuara në disfavor të fakulteteve të veta, në radhë të parë, siç është pranimi i studentëve në vitin e parë, regjistrimi i studentëve kalimtarë, përcaktimi i planeve dhe i programeve mësimore, pranimi dhe promovimi i pedagogëve universitarë, caktimi i pagave të pedagogëve dhe të punëtorëve administrativë e teknik-ndihmës etj.

Universiteti i Prishtinës, konform me parimin e centralizimit administrativ, i mban të gjitha ingjerencat dhe kompetencat themelore universitare, në një anë , ndërsa, fakultetet e tij, janë të privuara edhe nga autorizimet elementare më së të nevojshme për organizimin dhe funksionimin efikas të tyre. U muar vesh se, Universiteti i Prishtinës, aktualisht, është i establuar konform me parimin e centralizimit të funksioneve universitare në disfavor të përbërësve të vet. Ky koncept, nga pika të caktuara, në kompleksin e rrethanave kohore dhe shoqërore në Kosovë, padyshim përmban prioritete të caktuara, në radhë të parë , në të mirë të vënies së rregullit të përgjithshëm dhe të përbashkët si dhe, të një discipline elementare më së të nevojshme. Me ato përparësira,

² Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nr. 1244 / 99

sikundër të implementoheshin, në masë të konsideruar, do të justifikoheshin koncepti i organizimit centralist të Universitetit të Prishtinës. Mirëpo, Universiteti i Prishtinës, aktualisht pa establishim të shërbimit administrativ, të përgjithshëm dhe teknik – ndihmës dhe pa bazë materiale, financiare, teknike adapte me autorizimet e koncentruara në favor të vet, as për së afërmi, deri më tash dhe si duket edhe për një periudhë të konsideruar, nuk mund t'i ushtrojë me efikasitet prerogativat, autorizimet dhe kompetencat e veta.

Universiteti i Prishtinës, përderisa nuk establishohet dhe organizohet konform me një rregullativë të bërë në procedurë të rregullt, të mbështetur në studime dhe analizime serioze paraprake të të gjitha segmenteve të arsimit sipëror, nuk mund të ushtrojë funksione administrative – të përgjithshme eficiente në menaxhimin e fakulteteve të veta. Në anën tjetër, fakultetet e Universitetit të Prishtinës, përderisa nga Universiteti janë privuar nga autorizimet themelore aq të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve të tyre, praktikisht, nuk janë në pozitë juridike për të bërë atë që duhet bërë në të mirë të arsimit sipëror apo thënë më butësisht, nuk mund të bëjnë më tepër se sa që bëjnë aktualisht. Dhe, pikërisht, aty konsiston edhe aspirata dhe bindja e bazuar se, Universiteti i Prishtinës, në sajë të një organizimi më të mirëfilltë, ai si dhe komponentet e tyre fakultetet, mund të bëjnë shumë më tepër dhe më mirë.

DISKURS PËRFUNDIMTAR

Universiteti i Prishtinës, sikundër edhe shoqëria politike kosovare, ndodhet në një fazë zhvillimore të karakterit transitor dhe, me atë, të transformimeve organizative, strukturale dhe funksionale . Në Universitetin e Prishtinës, tanimë, në vitin e tretë të studimeve, ndodhen në aplikim planet dhe programet e reformuara të fakulteteve. Planet dhe programet në fjalë, janë reformuar konform me konceptin e Kartës së Bolonjës dhe, me synim të përgjithshëm që, në masën e duhur të bëhet harmonizimi përmbajtësor i tyre në funksion të kalueshmërisë së studentëve në fakultetet e jashtme dhe anasjelltas. Gjithësesi, planet dhe programet e reformuara dhe në aplikim, në pjesë dhe segmente të caktuara, në këtë apo atë trajtë, janë manifestuar të diskutuara dhe, për aq, të përshtatshme për një rishikim analitik – kritik dhe për tejreformim cilësor të tyre. Reformimi i deritashëm i Universitetit të Prishtinës nuk bën të trajtohet si një akt i kryer , por si një proces i filluar dhe i papërfunduar, që duhet të vazhdohet. Gjatë reformimit të Universitetit të Prishtinës, të bërë kryesisht gjatë vitit akademik 2000 – 2001, në masë të konsideruar, ka pasë ngutësi, paqartësi, akte të pastudiuara sa dhe si duhet si dhe voluntarizëm subjektiv të caktuar. Rrjedhimisht, pasojat reflektohen konkretisht edhe aktualisht. Ndaj, imponohet nevoja imediate që të bëhet një rishikim analitik – kritik i statusit juridik dhe i organizimit strukturor dhe funksional, rolit, vendit dhe funksionit të Universitetit të Prishtinës. Më pastaj, në sajë të njohurive empirike dhe teorike, të mbështetura në zgjidhjet bashkëkohore dhe në eksperiencat afirmative, të bëhen zgjidhje statusore, organizative dhe funksionale universitare të reja dhe më të avancuara. Në radhë të parë, duhet të definohet qartë dhe plotësisht relacioni reciprok ndërmjet administratës publike me autorizime për arsimimin sipëror, Universitetit të Prishtinës dhe fakulteteve të tij; në sajë të zgjidhjeve teorike dhe praktike, në përgjithësi, mund të mbrohet pikëpamja se fakultetet e Universitetit të Prishtinës, duhet të kenë status juridik me një varg autorizimesh rrjedhëse, tërësisht në të mirë të ushtrimit eficient të aktiviteteve të veta; në anën tjetër, edhe Universiteti i Prishtinës, mund të ketë por edhe mund të mos ketë status

juridik me autorizime rrjedhëse; gjithësesi, ndërmjet pushtetit administrativ për arsimimin sipëror, Universitetit, fillimisht duhet të definohen autorizimet respektive me demarkim të qartë të prerogativave dhe autorizimeve të tyre dhe, rrjedhimisht edhe ndërmjet Universitetit dhe fakulteteve të tij; po ashtu, çështja e financimit të Universitetit dhe të fakulteteve, duhet të definohet qartë, duke i precizuar kriteret e objektivizuara për detyrimet financiare të studentëve dhe për pagat e pedagogëve universitarë.

Krahas Universitetit të Prishtinës, si universitet publik, duhet të krijohen baza juridike për themelimin dhe funksionalizimin edhe të universiteteve të tjera publike dhe private.

UNIVERSITETI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS

KUADROT NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT

a) Kuadrot në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror

Shikuar historikisht, si dhe duke u mbështetur në analizat empirike të deritashme, del konstatimi se faktori njeri, përkatësisht kuadrot profesionale, duke mos i lënë anash edhe faktorët e tjerë, përherë ishin dhe me siguri do të mbeten edhe në të ardhmen nxitës dhe bartësit kryesorë të zhvillimit dhe i të gjitha transformimeve ekonomiko-shoqërore. Ndryshimet ekonomike dhe shoqërore kanë karakter dinamik dhe ato rezultojnë nga interaksionet e zhvillimit të forcave prodhuese, ku përfshihet edhe faktori subjektiv, pra kuadrot. Vetë niveli i zhvillueshmërisë paraqet nevojën edhe për kuadro adekuate. Bazë për përgatitjen e kuadrove, siç dihet është arsimi. Andaj, arsimi si infrastrukturë shoqërore duhet të gëzojë përkujdesje dhe të zë vend meritë në kuadër të zhvillimit të lëmenjve shoqërorë.

Arsimi ka karakter interdisiplinar, dhe si i tillë shtron nevojën dhe rritjen e shkallës së ndërlidhshmërisë në të gjitha fushat jetësore. Kështu, arsimi paraqet proces shumë specifik nëpërmjet të cilit fisnikërohen kuadrot e të gjitha profileve, të cilat me aftësitë e tyre profesionale-shkencore, punës kreative dhe me inovacione kontribuojnë në zhvillimin më të suksesshëm ekonomiko-shoqëror. Nobelisti nga fusha ekonomike Theodore Schultz me të drejtë konstaton se faktori vendimtar në prodhimin e begatisë kombëtare nuk mbështetet në hapësirë, tokë, energji etj., por në faktorin njeri, pra në kuadrot, përkatësisht në të arriturat në dituri. Mungesa e resurseve natyrore nuk e pengoi Japoninë dhe disa vende të tjera që arritën nivel të lartë të zhvillimit të forcave prodhuese, të cilën ua mundësoi faktori njeri, d.m.th. kuadrot profesionale. Prandaj, revolucioni tekniko-teknologjik, inovimet teknologjike dhe proceset bashkëkohore prodhuese kërkojnë edhe kuadrin adekuat profesional, i cili di t'i drejtojë ato. Kështu, revolucioni i ri shkencor paraqet ngritjen e nivelit arsimor të popullsisë, që është në gjendje të zbatojë risitë dhe të arriturat më të reja shkencore. Në kontekst të kësaj mund të themi se zhvillimi dhe transformimi i diturisë në praktikë dhe shkathtësia intelektuale është bazë për një zhvillim ekonomiko-shoqëror. Andaj, arsimi si input i përgjithshëm për kah rëndësia, paraqet njërin ndër segmentet më me peshë kombëtare.

S'ka dyshim se procesi i arsimit varet në rend të parë nga niveli i zhvillueshmërisë dhe vetë sistemit ekonomiko-shoqëror. Si çdo infrastrukturë ashtu edhe arsimi absorbon mjete të mëdha materiale. Andaj, si çështje esenciale në ekonominë e arsimit paraqitet problemi financiar, përkatësisht përcaktimi optimal i shpenzimeve materiale. Siç dihet ngritja e kuadrit të arsimuar kërkon kohë të gjatë dhe vlera të mëdha të mjeteve investive. Për këtë arsye bartës dhe përkrahës i zhvillimit të arsimit zakonisht paraqitet shteti. Mirëpo, kjo në asnjë moment nuk do të thotë se ndaj arsimit duhet të kemi qasje të njëanshme, pra zhvillimin e tij ta vështrojmë vetëm nga shpenzimet materiale. Në

kontekst të kësaj duhet potencuar se investimet humane d.m.th. në arsim janë më efikase se në çdo lëmi tjetër, sepse ato kanë karakter shumë dimensional dhe interdisiplinor. Andaj, investimet në arsim paraqesin avancime materiale në faktorin njeri, përkatësisht në ngritjen e kuadrove, të cilat janë shumë efikase dhe paraqesin domosdoshmëri pa të cilat nuk mund të përcillen dhe zbatohen të arriturat bashkëkohore tekniko-teknologjike, pa të cilat nuk mund të shkohet në hap me kohën. Nga kjo del se kuadrot e arsimuara kanë efekte të shumfishta pozitive që i shprehin nëpërmjet aktiviteteve të veta në proceset ekonomiko-shoqërore.

Niveli i lartë i proceseve tekniko-teknologjike të prodhimit në vete kërkon edhe profil adekuat kuadrosh, që mund të sigurohen vetëm nëpërmjet arsimit të lartë e superior. Kështu, në kohën bashkëkohore ndryshimet strukturore të popullsisë në veçanti ngritja arsimore paraqet nevojë, domosdoshmëri dhe faktorin më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Andaj, proceset bashkëkohore në të gjitha fushat jetësore, vetvetiu kërkojnë edhe ndryshimet adekuate të popullsisë. Kuptohet, këto ndryshime janë të kushtëzuara me nivelin e zhvillueshmërisë, për ç'arsye ato janë të ndryshme nëpër etapa të zhvillimit si dhe nëpër vende.

Vlera më e madhe e një kombi është intelegjencia, përkatësisht truri i tij. Intenca e çdo kombi është që të ketë sa më shumë kuadro, të cilët më shumë se çdo faktor tjetër do të çojnë përpara zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit përkatës. Andaj, në kuadër të inputeve, kuadrot zënë vendin dominues, për çka edhe gëzojnë mbështetje të plotë nga strukturat institucionale dhe shfrytëzohen në të mirë të interesit kombëtar në vendet përparimtare. Në hapësirën shqiptare ngjethet diçka tjetër. Për arsye xhelozie, karrierizmi, interesi etj. truri shqiptar nuk shfrytëzohet në mënyrë adekuate dhe racionale, sepse zbatohet politikë kadrovike e cila avancon njerëzit që janë poltronë dhe puthadorës, e jo kuadrin e mirëfilltë. Pra, zbatohet një politikë jo adekuate kadrovike, duke u forcuar njerëzit që vrapojnë pas karrigës, e jo njerëzit që i kërkon karriga. Kjo ndodhë për arsye se për politikën kadrovike vendosin ata që nuk ia dinë vlerën kuadrove të mirëfillta dhe që kanë pretendime të mëdha karrieriste. Prandaj, një politikë e tillë përbuzë dhe lufton trurin kombëtar, sepse ashtu kërkon interesi i individëve, grupeve, partisë etj. Kjo për fat të keq është bërë dukuri në momentin aktual, sepse lihet pas dore ajka e intelegjencës shqiptare. Ashtu si veprohet tani me politikën kadrovike, mendoj se veprohet mbrapshtë (zbatohet inverzi nga pozitivja), si shihet është koha e antivlerave, sepse nëpër institucione vërshojnë të pa aftit dhe të ndëgjueshmit.

Pas luftës Kosova gjendet në periudhën e tranzicionit dhe udhëheqet nga administrata ndërkombëtare, që karakterizohet me probleme të ndryshme dhe si e tillë është mjaft komplekse. Që nga dita e parë e kësaj periudhe e deri më sot, politikën zhvillimore e udhëheq UNMIK-u, përkatësisht Shtylla IV, e cila ekonominë në pronë shoqërore nuk e përfilli dhe kështu ajo iu la stihisë. Mos aktivizimi i kapaciteteve ekzistuese ekonomike kishte pasoja të shumfishta, ndër të cilat ishte edhe braktisja e kuadrove të të gjitha profileve: të ekonomistëve, juristëve, inxhinierëve, teknologëve etj.. Me këtë potez të Shtyllës IV, të gjitha këto kuadro që deri dje ishin bartëse të zhvillimit dhe të transformimeve ekonomiko-shoqërore mbetën jashtë proceseve zhvillimore. Kjo ndikoi që truri shqiptar, në vend që të shfrytëzohet, ai brendë rrugëve, apo e ka lëshuar Kosovën, efektet e të cilëve tani i vjelin të tjerët. Ky kuadër i duhet Kosovës, ndoshta më shumë se kurdoherë më parë, sepse ai do të jetë shtylla kryesore në momentin aktual që

do të shpie dhe çojë përpara zhvillimin ekonomiko-shoqëror të kësaj treve. Tani shtrohet pyetja pse ndodhë kjo? Kjo çështje heshtet dhe dihet pse heshtet.

b) Arsimi në funksion të përgatitjes së kuadrove

Shikuar historikisht Kosova, si edhe në fushat e tjera, edhe në arsim gjendet në nivel të ulët të zhvillimit. Deri në Luftën e Dytë Botërore as që mund të bëhet fjalë për arsimin në gjuhën amëtare të shqiptarëve në Kosovë dhe në trojet e tjera të banuara me shqiptarë, që gjindeshin në kuadër të mbretërisë SKS. Ndërkaq, në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore zë fill arsimi në gjuhën shqipe në këto troje, në fillim në ciklin e ulët dhe të mesëm e më vonë edhe në atë të lartë e superior. Arsimi superior filloi shumë vonë dhe kaloi nëpër etapa të vështira zhvillimore, sepse pengohej nga elementet shoviniste sllavo-ortodokse në ish-Jugosllavi. Siç dihet sistemi arsimor në Kosovë zhvillohej në kuadër të sistemit të përgjithshëm arsimor të ish-Jugosllavisë, ku elementet antishqiptare në forma të ndryshme bënë presion që të pengohet zhvillimi i arsimit superior. Duke mos i përmendur vrasjet, burgosjet dhe format e tjera të gjenocidit, që pushteti i atëhershëm i ish-Jugosllavisë bënte ndaj të gjithë shqiptarëve arsimdashës, me këtë rast po i prezentoj vetëm investimet në arsim, që më së miri shprehin faktorin ndikues të zhvillimit të kësaj lëmie shumë të rëndësishme shoqërore. Kështu, në periudhën e viteve 1952-80, nga kumulativi i investimeve të përgjithshme në Kosovë, që edhe ashtu ishin të vogla, arsimit, shkencës dhe kulturës i takuan vetëm 7,6%, që paraqet një vlerë shumë të vogël për të mundësuar të bëheshin transformime të nevojshme në këtë fushë.

Pas vitit 1981, për shkak të situatës së krijuar në Kosovë, avancimet investive si të përgjithshme dhe veçmas ato në arsim, shkencë dhe kulturë reduktohen dukshëm. Kështu, në periudhën e viteve 1981-89, nga kumulativi i avancimeve të përgjithshme investive në Kosovë, e cila kishte rënie permanente, pjesëmarrja relative e arsimit, shkencës dhe kulturës ishte vetëm 1,9%. Kjo gjendje në vitet e më vonshme u ashpërsua edhe më, dhe siç dihet pas vitit 1989 i tërë arsimi shqip u nxorr jashtë sistemit financiar të ish-Jugosllavisë dhe u mbështet në vetëfinancim, që e bëri populli shqiptar brenda Kosovës dhe nga diaspora.

Pas luftës në Kosovë filloi një etapë e re në të gjitha fushat jetësore, madje edhe në arsim. Edhe pse ekzistonte një kontinuitet, procesi i arsimit filloi me vështirësi në të gjitha ciklet, sepse një numër i konsiderueshëm i objekteve shkollore u gjetën të shkatërruara, kurse një pjesë e madhe e pajisjeve dhe e inventarit ishin të grabitura dhe të demoluara nga ana e pushtuesit serb. Mirëpo, për rreth kësaj, falë entuziazmit dhe vetëdijes së lartë të punëtorëve të arsimit u tejkaluan shumë bariera dhe me vetmohim u rimëkëmb dhe filloi procesi normal në të gjitha ciklet arsimore.

Në vazhden e ndryshimeve ekonomiko-shoqërore në periudhën e pasluftës erdhi edhe deri të disa ndryshime në sistemin arsimor në Kosovë, ku u bë dhe reforma universitare. Është e kuptueshme se Universiteti i Prishtinës e ka vendin në kuadër të Universiteteve Evropiane, për çka është e nevojshme të bëhen edhe reforma, të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me aktualitetin kohor. Prandaj, me qëllim të përfshirjes në sistemet bashkëkohore të arsimit evropian e më gjerë, filloi edhe procesi i reformave në UP. S'ka dyshim se reforma universitare kishte qëllim të mirë. Andaj, që në fillim pedagogët universitarë parimisht u pajtuan me këtë reformë, sepse në parim ajo kuptohej si proces që sjellë risi dhe avancime në plan-programet dhe procesin mësimor në përgjithësi. Mirëpo, siç dihet çdo reforme duhet t'i paraprijë një elaborat paraprak, ku do të analizoheshin të gjitha efektet pozitive dhe negative të saj. Për fat të keq, reforma

universitare në Kosovë u bë pa një analizë të tillë, ishte ad hoc, prapa së cilës fshihej prestigji dhe interesi personal i dikujt, apo i grupit të njerzëve, e jo për të intensifikuar procesin mësimor dhe përfshirjen e tij në rrjedhat e sistemeve të arsimit modern evropian e më gjërë. Për fat të keq reforma universitare tek ne u bë në sajë të propozimit vetëm të një personi ndërkombëtar, pa ndonjë analizë paraprake. Çka është edhe më e keqja se ky propozim erdhi nga personi që më së shumti i bëri fyerje UP që prej themelimit të tij e deri më sot, e ky ishte z. Daxner, cili pat deklaruar se para ardhjes në krye të UP, universiteti ishte 100,% i korruptuar, e pas ardhjes së tij ai ra në 50,0%. Një fyerje e tillë nuk është pritur nga një person i cili emrohet në krye të UP nga administrata ndërkombëtare, sepse nuk përkon me institucionin i cili e kishte emruar për të udhëhequr me administratën universitare. Ndonëse, ka indikacione të korrupsionit, por përgjithësimi është i pa pranueshëm dhe paraqet fyerjen më të madhe që ka mundur dikush t'u bëjë pedagogëve të UP, të cilët kanë thirrje akademike, ku shumica prej tyre janë të marrura në qendra të njohura universitare ish-Jugosllave, Evropiane e më gjerë. Me këtë z. Daxner përdhosi dinjitetin e universitetit tonë dhe të pedagogëve. Edhe pas kësaj z. Daxner iu lejua që të udhëheqë reformat në UP.

Z. Daxner bazë për reformën universitare mori Deklaratën e Bolonjës, të cilën në mënyrë deklarative e kanë pranuar, por ende (sipas njohurive të mia) nuk e zbatojnë në praktikë vendet Evropiane. Kështu, modeli 3+2+3 nxirret nga Deklarata e Bolonjës dhe si i tillë fillon të zbatohet në shumë fakultete të UP, që nga viti i kaluar akademik. Ky paraqet një pilot program të këtij modeli, dhe sipas njohurive tona si i tillë zbatohet vetëm në UP, pra i vetmi që i ndejti besnik kësaj Deklarate. Ky model si i tillë, për mos me ia prishur qefin z. Daxner, me nguti dhe pa kurrëfarë analize, u pranua nga udhëheqësia aktuale e universitetit dhe të shumë udhëheqësive të fakulteteve. Në mënyrë shumë të ashpër, por me argumente këtij modeli që nga fillimi iu kundërvu vetëm Fakulteti Juridik, por për fat të keq ai mbeti i vetëm. Mendoj, se ky model, po të ishte vërtetuar si i suksesshëm, me siguri se ne shqiptarëve nuk do të na kishte ra hise ta shijojmë të parët.

Reforma universitare në vete nënkupton ndryshimin e plan-programeve, të formave në procesin mësimor etj., duke ia përshtatur ato kërkesave të kohës. Kjo është plotësisht e pranueshme dhe nga kjo nuk duhet të firkësohet asnjë pedagog, të cilat në UP deri më tani janë bërë disa herë. Në kontekst të kësaj unë do të thoja se reforma universitare nuk nënkupton vetëm ndryshimin e plan-programeve, ajo është më e gjerë dhe shumë më komplekse, sepse në vete duhet të përfshijë edhe shumë elemente të tjera që janë prezente në procesin mësimor, siç janë:

- ngritja e standardit të studentëve, duke filluar që nga vendosja e deri te baza materiale e tyre,
- krijimin e kushteve moderne për zhvillimin e procesit mësimor, pra modernizimi i procesit mësimor siç është: formimi i grupeve të vogla pune, përgatitja e literaturës përkatëse, furnizimi me pasjisje adekuate teknike, laboratoriume etj.,
- ngritja e standardit jetësor të pedagogëve. Nuk mund të pritet që pedagogu të implementojë proces modern mësimor me elementet evropiane e me kushte afrikane, pra me një pagë prej 250 euro etj.

Nga gjithë ajo që u tha më sipër për reformën universitare, vetvetiu shtrohet pyetja.: A thua kjo reformë është e qëlluar dhe efikase dhe me këtë model a realizohet qëllimi kuptimplotë që duhet të ketë një reformë universitare? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet bërë një analizë detaje dhe komplekse nga grupi i ekspertëve. Mirëpo, marrë globalisht mund të themi se kjo reformë më tepër ka elemente negative dhe mendoj se duhet të shtrohet në rend dite rishqyrtimi i saj dhe zbatimi i mëtutjeshëm. Lidhur me efektet e reformës universitare unë do t'i jap disa nga elementet jo efikase që janë paraqitur pas reformës universitare në Fakultetin Ekonomik, e që janë:

- Reforma universitare filloi të zbatohet për një herë, pa ndonjë interval kohe, që është i nevojshëm për përgatitje të literaturës dhe kushteve tjera të procesit mësimor. Prandaj, si problem në vete tani në fakultetin tonë paraqitet literatura, si njëri ndër elementet kryesore në procesin mësimor.
- Reforma nuk solli ndonjë risi në ndryshimin e plan-programeve, heq një apo dy lëndë të reja. Pas reformës në fakultetin tonë edhe më tutje mbetën të gjitha lëndët që ishin edhe më parë, me të vetmin ndryshim emërtimi tjetër i tyre. P.sh. në vend të Ekonomisë politike, tani thuhet Makroekonomia I, në vend të Ekonomisë së ndërmarrjeve, tani thuhet Mikroekonomia I, në vend të Politikës ekonomike, tani thuhet Makroekonomia e aplikuar etj.,
- Forma e të pyetur tani bëhet me shkrim. Studentët duke u nisur nga fakti se në provim mund të përdorin edhe metoda të palejueshme (kopjimi) më pak po vinë të përgatitur dhe seksesi dukshëm ka ra.
- Kohë zgjatja e studimeve u bë prej 4 në 3 vjet, përkatësisht u rrit prej 4 në 5 vjet. Me rastin e kryerjes së studimeve të rregullta studenti nuk merr diplomën e ekonomistit të diplomuar, por një diplomë që dikur e quanim shkalla e parë. Për këtë arsye ai duhet t'i vazhdojë studimet edhe dy vite, për të marrë titullin magjistër. Ju lutem të gjithë studentët nuk janë të interesuar të bëhen magjistra dhe doktorë të shkencave ekonomike. Ekonomia e Kosovës ka nevojë për ekonomistë të diplomuar, prandaj profili i ekonomistit duhet të përgatitet për nevoja të ekonomisë sonë, e jo të Evropës, i cili bëhet nëpërmjet plan-programeve
- Koncentrimi i menaxhimit në nivel të Universitetit, Fakultetit ia ka humbur subjektivitetin e personit juridik. Ai me këtë reformë është

shndërruar në një servis të rektoratit. Nuk funksionojnë organet e Fakultetit, për ç'arsye vlerat në fakultetin tonë kanë ra thua se në dysHEME, qoftë kur është fjalë e studimeve të rregullta, studimeve pasuniversitare apo të pranimit të personelit mësimor. Nuk ka motive për punë, sepse ka humbur si stimulsi moral ashtu edhe material. Koncentrimi i mjeteve materiale në nivel të universitetit, nuk ka kurrfarë baze juridike e aq më pak ekonomike. Si është e mundur që me të ardhurat që i fiton kolektivi i Fakultetit Ekonomik me punën e vet, të disponojë Universiteti dhe ai të bëjë shpërndarjen e tyre. Nuk ka të drejtë askush, e aq më pakë në ekonominë e tregut, që nga të ardhurat e fituara të kolektivit, të disponojë personi i tretë. Me disponimin dhe shpërndarjen e të ardhurave ka të drejtë vetëm kolektivi që i fiton ato. Kjo ndodhë vetëm tek ne, dhe kjo paraqet një super burokratizëm, që si i tillë paraqet pakënaqësi dhe është i pa pranueshëm.

Duke u nisur nga ajo që u tha më sipër, mund të thuhet se reforma universitare ashtu si realizohet nuk e ka arritur qëllimin e vet, sepse me te nuk është bërë ndonjë përmirësim dhe avancim kualitativ në procesin mësimor dhe në strukturat tjera të afarizmit në Universitetin e Prishtinës. Reforma universitare dukshëm e ka ndërlikuar procesin mësimor në të gjitha fazat, menaxhimin si dhe çështjen financiare të fakulteteve të UP. Me formën centraliste të orgnaizimit të UP, fakultetet që e përbëjnë këtë universitet, janë vetëm objekt veprimi dhe në tërësi janë të xhveshura nga subjektiviteti juridik i tyre. Universiteti i Prishtinës, sipas prerogativave centraliste administrative, në vete i mban të gjitha kompetencat të procedurimit në një anë, kurse fakultetet janë të privuara edhe nga ingerencat më elementare, që janë të nevojshme edhe për organizimin dhe funksionimin minimal të tyre, në anën tjetër.

Duke përfunduar këtë qasje timen personale dhe duke pasur parasysh avancimin e zhvillimit të Universitetit dhe të fakulteteve, kam lirinë që të propozoj më sa vijon:

1. Me qëllim që fakultetet të kryejnë funksionin dhe të organizojnë aktivitetin e tyre primar në mënyrë efikase, d.m.th. të zhvillojnë në mënyrë të pavarur procesin mësimor në të gjitha fazat dhe të udhëheqin në mënyrë të pavarur nëpërmjet organeve të tyre përkatëse, duhet që sa më parë t'iu kthehet subjektiviteti i tyre juridik dhe
2. Nga një grup profesional të shqyrtohet në mënyrë analitike dhe komplekse modeli në të cilin është mbështetur reforma aktuale universitare, se si e tillë a e shpie Universitetin në rrugë adekuatë të

perfeksionimit të metodave bashkëkohore të sistemit superior shkollor dhe implimentimin e tij në sistemin shkollor evropian dhe më gjerë, apo duhet ndryshuar dhe gjetur forma më efikase, me të cilat reformimit universitar do t'i sjellin efikasitet më të madh

MBI ZHVILLIMET E NGADALSHME TË EDUKACIONIT
NË FUNKSION TË EFIKASITETIT EKONOMIK

EDUKACIONI DHE EFEKTIVI EKONOMIK

Nocioni dhe zbërthimi

Gjithnjë njerëzit u ndanë në të epur për predikimin kushtuar edukacionit dhe ata që duke mos u bezdisur për nocionin, thelloheshin në dituritë për krijimin e suazës së re për të lehtësuar komunikimin ndërnjerëzor dhe rritur shkallën e mirëqenies. Gjithsesi, këtu ndërvehojë prirja e mbushur me guximin për të shpejtësuar etapat e zhvillimit njerëzor, sidomos duke kërkuar risitë ndër to në shtegtimin e krijimit të të bukurës së re. Në kundërvënien e fisnikes si etike dhe të egres si kundërshtare e së vërtetës, patjetërsisht u hapën shtigjet nga edukacioni i çiltër. Si ilustrim do të vlen të respektojmë trajtimin e M. Scott Peck-ut, i cili bën vështrim kritik ndaj mendimeve të paraardhësve meritore rreth këtij nocioni siç janë Frojdi, Jungu, Fromi e t.j. Ndër të tjera parashtrojnë qasjen personale të nocionit *edukacion*. “Ta marrim fjalën ‘të njohësh’. Kur do ta lexojmë librin dhe në të ndeshim idenë ose teorinë që na pëlqen, ajo na ‘përkujton’ se ne e ‘njohim’ si të vërtetë. Fjala ‘serish të mësosh’, do të thotë se këtë njëherë e kemi ditë, harruar dhe prapë e kemi përkujtuar sikurse mikun e vjetër. Sikurse tërë dituria dhe tërë urtia njëherë kanë qenë në intelektin tonë, dhe kur do të mësojmë ‘diç të re’ ne vetëm se do të zbulojmë në veten atë që aty ka ekzistuar. Ky koncept vërehet në fjalën formim (mendohet në arsimimin vr.Z.B.) që ka kuptimin *education*, dhe ka rrjedhë nga fjala latine *educare* me domethënien e vendosjes ‘të zbulosh’ ose të ‘prijësh përpara’. Pra kur do të formojmë (edukojmë vr. Z.B.) njerëzit, ne nuk do t’i ngarkojmë me dituritë e reja. Ne do të qesim në shikimin e ditës diç nga vetë ata...”

Vetëvetiu sqarohet se tërësia e diturive mbështet në kahet e kërkuara që do të bëhen shteg “ushqimi” për brezat me përkujdesjen prej familjes deri në shkollën përkatëse. Në këtë drejtim John Locke (Xhon Loku), mbështetë konceptin e natyrës pozitive të njeriut: “...Njeriu i virtyeteve është më i vlershëm se shkencëtari më i madh. Ndërkaq, shkolla si institucion publik edukon vetëm një masë impersonale dhe nuk kujdeset për cilësinë e çdo individi...” Pra ballafaqimi mes dy kaheve nënkupton edukimin personal dhe institucional.

Shoqëritë e zhvilluara, duke ngritur përherë pasurinë materiale dhe kulturën, i ndanë sferat e mësimave fundamentale dhe pragmatike. Ndodhi ballafaqimi me rrymat e reja të teorive që tashti u “plakën” si jo frytëdhënëse dhe u bë një rrëmuje rreth vlerës dhe vlerësimit të drejtë për edukacionin si kërkesë imanente e ngritjes së njeriut si individ e personalitet dhe barazimit klasor në kundërshtinë qenësore edukative për mirëqenie, sipas aftësive dhe pabarazisë ndërnjerëzore mbi: përkushtimin, zellin, talentin në drejtimin e vetëzbulimit për veprimet frytëdhënëse. Shumë mjedise, pas vuajtjes së gjatë, u liruan nga teoritë iracionale duke i hudhur në mbeturinat e historisë; bashkë me to edhe botëkuptimet, duke iu qasur anës racionale të hapjes së tregut të vlerës me mësimet e reja. Disa mbetën peng të tradicionales së kushtëzuar me hamendjen e rrotullimit rreth

njëmendësisë, për të unifikuar raportet dhe ngrirë ardhmërinë, duke ruajtur tregun e mbyllur të garave me edukacionin e trashëguar, me ndryshime formale e përmbajtje të gurta, pa shtegdalje.

Spastrimi "mendor" dhe i resurseve frytdhënëse njerëzore, pa tjetër u bënë kundërthënia dhe arma më e ashpër në shkatërrimin e sistemeve totalitare, të cilat me varfërinë si aksiomë u munduan të krijojnë "paskanik dhe shoqëri pa klasa". Marksistët e interesit dhe dogmës, kishin anatemuar shumë mendimtarë, përkatësisht filozofë, sikurse Hjumin, Hobsin dhe Lokun (që të tre filozofë anglezë). S'donin të pajtoheshin me vlerën e diferencuar njerëzore, me aksiomën se njerëzit nuk janë të barabartë, andaj edhe dallojnë për nga virtyti, ndërgjegjja, koshienca, zelli dhe talenti. Në realitet, raporti ndërklasor u zbut atje ku drejtoheshin kritikrat - në përfundim dhe u ashpërsua atje nga bëheshin kritikrat - në lindje dhe vendet e tjera të socializmit të dirigjuar. Dikund u shuan tërësisht e dikund u shua vetëm forma duke vegjetuar përmbajtja e trashëguar.

Teoritë trasaparente ende qitnin në dritë njohuritë e herëshme rreth dallimit të njerëzve me kërkesën për garat e ashpra në tregun e vlerave. Sipas Douglas Mek Gregorit, aftësimi duhet të mbështes metodat e njohura, të prirura nga parapërcaktimi i njerëzve në X, dhe Y; nga ndërtoi dy teoritë e emëtuara X (përtac, të pandërgjegjshëm etj.) dhe Y (të virtytshëm, të zellshëm e t.j.).

Në ekonominë amerikane, në tridhjetë vjetët e fundit, janë bërë përpjekje të mëdha që përmes aftësimit dhe mënyrave tjera, të ndërrohet qëndrimi i mësimdhënësve për transformimin e metodave të edukacionit, përkatësisht të njerëzve X në Y. Komunikimi dhe ushtrimi i pandërprerë, gradualisht duhet të rikthejnë bindjet dhe sjelljet, duke fisnikëruar grupet dhe individët. "Rikthimi" i virtytit si tipar për shumë efekte pozitive, andaj edhe për përkushtim ndaj punës, edhe pse në shikim të parë është veprim i vështirë dhe i ndërlikuar, sipas autorit të kësaj ideje, është i arritshëm. Kësisoj, gradualisht numri në grupin X, do të shterët, ndërsa në Y do të rritët. Ushtrimi dhe aftësimi për veprime të efektshme, ndërlidhet me shumë faktorë. Në natyrën e njeriut gjenden sadopak ndjenja për veprime të vyeshme. Duhet të zbulohet efekti për motivim. Me njohuri nga shkencat e ndryshme e veçanërisht nga psikologjia e sociologjia, shumë gjera mund të bien në vend të vetin. Motivët janë të ndryshme.

I gjerë është spektri i teorive dhe qasjeve pragmatike në edukacionin bashkëkohor. Disa shikime, në vazhdim do t'i shtroj shkurtimisht, por që të gjitha ndërlidhen me efektivin ekonomik. Për pasqyrimin më të sqaruar, trajtimin në këtë elaborim do ta ndajë në disa tema: **Krahasimet dhe proporcionaliteti, Aspekte indikative të profilizimit, Motivimi, Tradicionalja dhe spontanja, Profesionalizmi dhe autoriteti profesionist, Epilogu si efektiv dhe rezimea.**

Sipas krahasimeve nga ecuritë dhe dukuritë në vlerësimin empirik, krahas shkallës së zhvillimit të përgjithshëm, edukacioni është pjesëmarës dhe shtytës në nivelin përkatës të mjedisit. Vendet në shkallën më lartë zhvillimore, në epiqendrën e të cilave raportet ekonomike me dinamikën e shpjëtësuar të përparimit, herë në mënyrën evolutive herë duke bërë rikthime dhe kapërcime të shpejta, nga rritja ekonomike arrijnë të zgjërojnë dhe avancojnë bazën edukative. Cytjet janë të ndërsjella me ndëvarëshmërinë e pandalshme. Mirëqenia gjeneron dhe gjenerohet, sipas aftësimeve në rend të parë profesioniste e në rend të dytë shkencore. Kësaj renditjeje shumë nga vednet përfundimtare që moti i janë adaptuar. Lëvizjet janë të shkallëzuara sipas masës së kërkesës. Përparësinë

e mban aftësimi sa më i hershëm për punësim përkatës, me synim pavarësimin nga familja dhe mjedisi. Është premisë edukative e ngërthyer nga mentaliteti e shoqërisë së rendit njerëzor, duke marrë përmasën tradicionale.

Mjediset deri vonë me ndarje artificiale të të ardhurës nacionale e mandej edhe asaj individuale, këtë njësime mentaliteti pak e kanë arritur se nuk ishin gjithaq të ushtruar e të shtytur të bëhen zot të vetvetes. Derisa shteti rregullonte sjelljen edukative, participimi i individit ishte i mangët. Iniciativat e mbykëqyrura dhe jo aq të përfillura, drejtonin nga masiviteti skolastik, pavarësisht nga cilësia. Kësisoj krijohesh korniza e rregullimit shoqëror, ku propulsiviteti formal i shkollimit, deri në nivelet më të larta ishte i përmasës së gjerë. Edhe midis tyre kishte dallime regjionale. Aty ku prapambeturia kishte dominua gjatë, mundësia e shkollimit hapte shtegun e arsimimit sa më të dendur, herë duke ruajtur e herë duke e humbur edhe cilësinë. Ardhmëria shikohej në prizmin e kalimit të fazave të kushtëzuara evolutive. Fenomeni i tillë më së shumti përfshiu mjediset me kulturë rurale dhe apologjetizëm ndaj arritjeve të mëdha me bazën e kufizuar materiale.

Duke qenë teknogjia pak e përhapur edhe më pak ajo e avancuar me zhvillimet e përqendruara në ekonominë e sektorit primar dhe deridiku sekondar, zhvillimi nuk përputhej me ndonjë rishtrukturim adekuat. Profesione të specializuara kishin pak të zhvilluara, për veprimtari të ndryshme, kushtëzuan bazën e kufizuar në edukacionin të përqendruar në fare pak specializime deri të nivelit të shkollës së mesme. Me kalimin e kohës, vendet e sistemeve komuniste e socialiste së shpejti u transformuan në atë të drejtuar nga tregu, duke iu adaptuar kërkesave të reja. Me pak dhembje, krijuan nismat e tejkalimit të defekteve strukturale. Disa edhe kjo kohë i gjeti të përgatitura dhe lehtë e shpejtë kompensuan aq sa u mungonte në aftësimet për punësime në rininë pas shkollimit të mesëm, ose edhe më pak duke aftësuar brezat për punët përkatëse. Disa të tjera nuk lëvizën nga vendi. Shembull tipik janë vendet e papambeturisë së gjatë. Ndër to, në Evropë dallohej Ballkani e në të Kosova. Punësimi i kufizuar, u bë shkaktari kryesor, por edhe mangësia e rishtrukturimeve adekuate që moti të anashkaluara edhe pse jo të ndaluara pavarësisht nga sistemi shoqëror e ekonomik. Përkundrazi gjithnjë bëheshin të kërkuara.

Për të ilustruar disa nga lëvizjet e edukacionit, paksa në mënyrë globale, por adekuate për krahasime të niveleve të ndryshme, duket se do të shërbenin shembujt më të gjerë. Për shembull lëvizjet në SHBA, Slloveni dhe Kosovë. Arsytimi për krahasimin e tillë, pra të Kosovës, gjendet në kërkesën e zbërthimit të fenomenit të këtij vendi deri me tashti ende pa identitet shtetëror. Ndoshta edhe se apologjetizmi reformist, këtu ka krijuar follenë e hershme duke ndryshuar formën e përçmuar përmbajtjen për lëvdatën e pushtetarve, tashti mikst vendas e të ardhur për administrimin protetktorat. Shprehur figurativisht, duke u kënaqur me mësimin e vitrinës pa shikuar brendinë e kinkalerisë.

Që herët është i njohur konstruktivi amerikan i pavarësisë individuale, që ka sjellë qëndrueshmërinë shtetërore me kontinuitetin evolutiv të zhvillimit dhe rritjes së fuqisë materiale e mendore. Mundësia e punësimit, herët ndër të rinj, mundëson përfytyrimin e ardhmërisë në profesionin përkatës, por edhe me edukacionin shumëkahësh të mësimave të shpejta efikase e frytdhënëse. Relacioni mes aspiratës ndaj shkollimit të lartë dhe atij të gradacionit më të ulët që më herët krijon pavarësimin personal, është përherë i favorshëm. Përcaktimi dominant, gati gjithnjë në përmasën absolute, është i drejtuar nga përgatitja punësore.

Sllovenia me numër më të vogël banorësh se Kosova, drejtimin e shkollimit të shkallës akademike, pra të lartë, ndër të rinj e ka më të ulët se Kosova: në përmasën proporcionale me numrin e banorëve (Sllovenia me rreth 1.6 milion, Kosova 2 milion) dikund nga gjysma e Kosovës. Indikatori krahasues mbështet sipas arritjes së diplomave e jo aftësisë profesioniste.

Ecuritë kosovare, prej se u krijuan kushtet për shkollim të lirë edhe në gjuhën amtare, kanë tejkaluar suazën e arritjes së diturive me vlerë zbatuese. Periudha e favorizimit sa më të gjerë për shkollime të të gjitha niveleve, sidomos për atë akademik, ka shkaktuar diskrapancën e edukacionit efikas me përmasë më të ulët frytdhënie. Kjo traditë është mbajtur si kult, por edhe fshehtë e mangësisë së punësimit. Dy shtigje janë vënë para shkollarit që ka kryer shkollën e mesme me kualifikim pak a shumë universal, pra jo të specializuar: vijimi i studimeve në shkollën më të lartë ose shtegtimi në vendet e jashtme, duke gjetur ndonjë punë me përkatësi etike ose duke kërkuar azil, për shkaqe të ndryshme, veçmas në peridhën e krizës dhe të rreziqeve të parashikuara.

Aspekte indikative të profilizimit

Edukacioni bën frymëzimin për aftësimin i cili duhet të shprehet në punësim. Por, vështirë është të arrihen harmonizime të plota. Në të vërtetë, nga zbrazësirat e tilla nuk është i kursyer asnjë vend. Të zhvilluarit, përherë orvatën të krijojnë drejtpeshim të ngritur. Të pazhvilluarit këtë qëllim nuk e arrijnë gjithaq. Mirëpo, edhe këta ndërtojnë bazën gjithnjë më të ngritur të edukacionit, fatkeqësisht për të tjerët, do të thotë për ata të cilët me imigracion të dëndur, përfitojnë krijues të vlerave edhe më të avancuara, duke mos investuar në formimin e tyre. Kjo përbën "fatkeqësinë e fatit" të të varfërve. Në realitet, ecuria e tillë është "gjysmëfati" në krahasim me hapësirat ku të aftësuarit, marrin për zotim punët nën nivelin e përgatitjes profesioniste në vendin e vet ose dhe ku emigronjë. Nivel edhe më i "pafat" është ku krijohet potencial i gjerë i resursit të aftë njerëzor, i cili nuk ka mundësi as të punësohet në mjedisin e vet e as të emigrojë për t'u punësuar në vendet e tjera.

Në tërë rruzullin tokësor në dy deceniet e fundit, punësimi është më i ngadalësuar sesa në periudhat e mëparshme. Kjo ecuri ishte e shprehur edhe në vendet e zhvilluara, por kishte edhe përjashtime - Japonia, Kanadaja, Belgjika e tjera. Është veçori e dalluar se punësimi i kategorive të personave të diplomuar për veprime të profileve të ndryshme të profesionizmit të lartë, është më i ngadalshëm se sa i kategorive tjera...

Bikas Sanyal shprehet: "Veçanërisht befason fakti se shkalla e rritjes së papunësisë në kategoritë e profesionistëve të nivelit të lartë, pastaj të tipit udhëheqës dhe administrativ, por edhe të tipit profesionist - teknik e të ngjashëm me këta, në të njëjtën periudhë ishte më e lartë se shkalla e papunësisë së përgjithshme." Marrë nga "Arsimimi i lartë dhe punësimi në Evropë, - disa aspekte", revista "Higher Education in Europe", UNESCO - Copes. Vol. - XIII,

Afrimi dhe adaptimi i edukacionit sferës së punësimit, në vitet e fundit po merr përmasa të gjera praktike dhe eksperimentale. Në të gjitha planet e arsimit të shumicës së vendeve, po bëhen ndryshime të gjithanshme. Në vendet e Evropës dhe Amerikës Veriore, po zvogëlohet numri i universiteteve të mësimave teorike dhe fundamentale, po thjeshtësohet dhe rristruktuohet mënyra e mësimave në

universitetet tjera, krahas rritjes së numrit të kolegjeve për dituri praktike. Mësimi po bëhet më frymëzues dhe më frytdhënës. Veçmas janë duke u krijuar përvojat e programeve kooperative - shkollimi paralel me punën praktike - të universiteteve dhe kolegjeve, ndër të cilat vendin parësor po e zënë programet e edukacionit për biznes. Kooperativiteti po zgjerohet, duke krijuar hapsirën e punës praktike nëpër kompani private e institucione të administratës shtetërore me mundësi punësimi në to.

Përndryshe, të flasësh për sistemet e shkollimit sot në përmasat botërore, kërkohet një hapësirë më e gjerë dhe përmbledhje e gjërave të ndieshme që kanë një përmbajtje fare të koklavitur. Terli Mings, shprehet për ndryshimet tejet të mëdha dhe mosukseset e arsimimit, përkatësisht të edukacionit që lënë prapa brezat për shkollimin adekuat. Ai thotë: “Arsimimi është malli kolektiv më i rëndësishëm që sigurohet nga qeveritë e shteteve dhe nga pushtetet lokale. Ai thith më se 1/3 e të gjitha shpenzimeve shtetërore dhe lokale. Ekziston një shqetësim i konsiderueshëm për kushtet e arsimit në vendin tonë aktualisht, (është fjala për SHBA-të (vr. Z.B.). Mëse 1/4 e nxënësve e lënë shkollën në mes. Rreth 13% e 17-vjeçarve janë praktikisht analfabetë. Testet formuese të cilava u janë nënshtruar nxënësit e 13 vendeve të industrializuara, tregojnë se nxënësit amerikanë renditen të 11-ët në kimi, të 9-ët në fizikë (për ata që kanë bërë 2 vjet fizikë), dhe të fundit në biologji. Maturanti mesatar japonez është më i mirë në matematikë sesa 5% nga më të mirët ndër kolegët e tij amerikanë.” Terli Mings: “Mësimi i ekonomisë...” Por, amerikanët, përqendrohen në mësimet praktike duke mos insistuar në shkollimin e lartë për ato punë që ai (shkollim) nuk u është i nevojshëm.

Rajmond Haull për edukacionin konstaton: "Shkollimi, shpesh i lavdëruar si mjekësi për të gjitha dhëmbjet, qartë, nuk është ilaç për paaftësi. Paaftësia hovshëm lulëzon mu në shkolla. Një maturant nga tre të tillë, nuk di të lexoj me shpejtësinë të cilën duhet ta ketë pasësh shko-llari nga tetëvjeçarja. Tash është bërë e zakonshme që fakultetet të kanë ushtrime leximi për brucosh. Në disa fakultete, njëzetepesë për qind të brucoshëve nuk dinë të lexojnë dhe nuk mund të mësojnë nga tekstet e tyre..." (Vështirimi i dedikohet SHBA-ve. marrë nga libri i shkruar nga Peter Laurence "Përse na shkon gjithçka mbrapsht..."

Ecuritë e ngjashme koekzistojnë në të gjitha vendet. Ndërkaq në Kosovë, secilën ditë po bëhen më masive, përballë mosrepektimit të njohjes së shkrimit dhe të shprehjes koncize; të moskujdesit të organizimit të mësimi plotësues si mangësi e atij paraprak. Normat dihen janë të shkruara në tekste të ndryshme në versione pak a shumë të dalluara. Wiliam G. Nickels, në tekstin "Understanding Business," përcakton pesë kushte të njohjes: të dishë të flasësh, të dishë të shkruash, të njohësh veprimet me kompjuter dhe teknikat e ndryshme të fushëveprimeve studiuse, të njohësh gjuhën përkatëse të komunikimit me botën. Por janë edhe të tjerat që ky autor, nuk i akcepton, sikurse: të dishë të lexosh e dëgjosh, të dishë të ilustrosh, të dishë të bësh pyetje qenësore e të tjera.

Ndër ne, këtyre "imtësirave", por qenësore nuk i kushtohet kujdesi i duhur, gati në asnjë instancë të mësidhënies e mësimmarrjes..

Parashkollimi, në kuptimin më të gjerë, konkretisht i shkollës së mesme për

fakultet, me të cilin bëhet aftësimi i caktuar për vijimin e shkollimit të mëtejshëm, ndër

ne, shpeshherë shprehet në përmasën e kundërt me aftësimin paraprak, mandej të ndërrojë formën me përmbajtje dhe anasjelltas, përmbajtjen me formë. Kësisoj, nxënësit, të cilët kanë kryer gjimnazin ose shkollën tjetër të mesme me sukses të shkëlqyeshëm, në shkollimin më të lartë, dështojnë ose të paktën janë mesatarë. Dhe e kundërta, nxënësit me sukses mesatar ose shumë të mirë, nga shkolla e mesme në gradacionit e nivelit më të lartë të studimeve si mësimarrës tregohen të shkëlqyeshëm.

Ta ngritësh veten mbi talentin, do të thotë të përvetësosh profesionin dhe të bëhesh koshient për këtë për ta ushtruar me përkushtim. Ose, thënë më shkurt, të bëhesh mjeshtër i talentuar. Talenti shtë me përmasën relative, ushtrimi do ta konfirmojë, elokuenca do ta arsyetojë punën dhe talentin.

Kur pata vijuar shkollën e mesme, në kushtet që ishin të vështira, na mësonin arsimtarë të talentuar, pedagogë të horizonteve të gjera, punëtorë të palodhshëm, por shumica prej tyre nuk kishin të kryera shkollat adekuate. Megjithëkëtë, ishin në nivel të ngritur profesionist, përkatësisht zanatçinj të spikatur. Përveç mënyrës tejte efikase të shtruarjes së mësimave të vlerëshme, kishin aftësinë të vëjnë kontaktin me nxënës dhe të sigurojnë besimin në këta.

Pas tridhjetë vjetëve, vizitova një gjimnaz disi të ngjashëm me atë që kisha vijuar. Mësimdhënësit ishin në nivel të lartë të aftësive formale. Ishin disa edhe të kurorëzuar me thirrje magjistri të shkencave. Mirëpo, efekti i këtyre ishte i mangët. Nuk kishin arritur nivelin e komunikimit dhe transponimit të diturive të nxënësit. Ndër të tjera u mungonte kooperativiteti që ngrit besimin e ndërsjellë dhe rritë motivin duke shtuar vullnetin për të shkuar mëtej në mënyrë frymëzuese me kultivimin e diturive.

Tradicionalja dhe spontanja

Përcaktimi gjithnjë e më i dendur në aftësimin funksional është duke bërë depërtime të thella në psikologjinë e kushtëzuar me kërkesën për mirëqenie. Njerëzit e kanë shtuar përkatësinë fetare, por duke ngritur besimin në të vërtetën, duan që në këtë jetë që e kanë para vetës, ta shfrytëzojnë përmbajtjen sa më cilësore. Pikërisht, thyerjet me sistemet konvencionale të aftësimin, janë duke hapur rrugën e depërtimeve të përbërjes funksionale, praktike me kërkesa transparente. Pa dyshim se mësimet fundamentale e kanë ruajtur qëllimin e tyre, por është duke u zvogëluar interesimi masiv për to, të paktën në proporcion me numrin e popullsisë gjithnjë në shtuarje dhe përmasën studiuse. Është e qartë se shkollimi jo praktik, njeriun do ta largojë nga zotimi parësor. Vetë pragmatizmi biznesor krijon kushte të reja të aftësimin, të mbështetura në shpejtësi dhe përciptësi.

Punët inventive si emërues të përbashkët kanë talentin. Ta gjejmë veten në degëzimet e veprimtarisë sipas talentit është vështirë. Për disa persona pengesa

më e madhe - ta zbulojnë veten, në rastet e shumta, bëhet e patejkalueshme. Kultivimi i aftësive në mënyrë të pavarur, po ashtu është me vlerë të kufizuar. Edukacioni i mbështetur në metodën unike dhe të veçantë të kultivimit të aftësive krijuese, përbëhet nga mjeshtritë e përgjithshme dhe të specializuara. Mirëpo, universalizmi i tepruar ka veçori të kufizuara. Ballafaqimi me talente për veprime të llojeve të ndryshme, është pikënisja e metodës së edukacionit, nga përfitohen bindjet për drejtime të caktuara të aftësimit. Këto janë me përbërje të modeleve të ndryshme, të adaptuara niveleve të perceptimit, shkollimit dhe profilit përkatës. Të gjitha modelet e këtij lloji, janë dinamike, të segmentuara në periudha të zgjatjes kohore të afateve prej disa ditësh, a muaj deri në disa vjet. Ndër to dominojnë modulet e adaptuar kërkesës së mësimmarrësit sipas interesit konkret, duke zbërthyer të këndshmën me leverdinë.

Renditja e profileve, niveleve, dhe kohëzgjatjes së edukacionit, mbarështohet mbi baza të një ose më shumë modeleve të mësimëve. Këto kryesisht ndahen në drejtimin për njohuri fundamentale - për punët kërkimore – shkencore, për mjeshtri të veçanta të lëmenjve të ndryshëm dhe për mjeshtritë teknike e të biznesit.

Sipas ecurive më të reja, në disa vende prej shkollës fillore po ushtrohet modeli liberal i shkollimit, duke kombinuar mënyrën lakonike dhe mendimin lateral si mësim të obligueshëm prej 2 - 6 orë në javë. Sot në 53 shtete në të gjitha meridianet, që nga shkolla fillore, fëmijët mësojnë me qëllim të ngritjes së individualitetit. Përgatiten t'i ndajnë gjërat e t'i bashkojnë, sipas mendimit personal: tradicionalen dhe spontanen; secili sipas prirjes personale përmes edukimit e jo të diktimit. Si shembull: Venecuela 2 orë në ditë, Bullgaria 3 orë, disa shtete të SHBA-ve një orë. Me siguri së shpejti do të përhapen edhe modele deri më tash të panjohura të konstruktit të edukacionit. Pritet që projekti eksperimental, i quajtur “Misteri i ndryshimeve” i udhëhëqur nga Isak Adizhes, që para tri vitesh u përfundua në Santa Barbara, në Kaliforni, do të përcaktojë zbatime krejtësisht të panjohura deri me tani, si risi atraktive për mësim të thjeshtësuar, përmbajtje të kondensuar dhe shtresim të qendruar.

Abetarja jonë institucionale, ende jeton e shkruar para më shumë se njëzet vjet. Pak dallon nga ajo që mësoja unë: e përmbushur me gjuhë rurale, thuase ndërmjet s'ishte zbuluar gjë: as kompjuteri, çipi, interneti, e -maili, televizori, sateliti, raketa kozmike, telefoni celular, telefoni satelitor... Ende jetojmë me lisa e barinj, lumenj e dete... duke u hedhur në detin e harresës për të arriturat që nga mesi i shekullit njëzet. A jemi ndalur aty!? Do të shkojmë si “mend-jesakatë” deri edhe në përfundimin e studimeve univeristare. Në anën tjetër, po shumëzohet numri i fëmijëve të ushtruar në tekniken e përdorimit të kompjuterit, shfrytëzimin e internetit sipas mësimëve shtëpiake.

Sipas Roland G. Lauterbach-ut ("Hyrje në krizën e nesërme të edukacionit elementar"), konteksti i edukacionit është shumë i gjerë. Duke e prezentuar sistemin e parimeve pedagogjike të Gjermanisë, si sintezë ca të suksesshme të vlerave tradicionale dhe përshtatshmërive zhvillimore, Lauterbach bën renditjen e kuptimeve të përcaktuara, të transmetuara dhe të liruara.

Kuptimi i përcaktuar shprehet me qëllimin e mësimimit si qasje se *çka ngadhënjehet, si arrihet kjo dhe çfarë është qëllimi i saj*. Trajtimi i transmetimit

më të mirë, ka pikësynim zgjidhjen e konfliktit *ndërmjet tradicionales dhe spontanës*. Ndërsa kuptimi i liruar, ka mbështetjen në *tradicionalizëm dhe spontanitet*, duke nxitur fëmijët që në praktikë vetë ta zgjidhin konfliktin që gjendet në mes këtyre dy koncepteve.

Nivelet e ndryshme të shkollimit përkojnë me modelet dhe thellësitë e trajtimit të çështjeve sipas interesit dhe instancës së thithjes së njohurive. Për shkolla të ulëta e të mesme, aplikohen modelet e kombinuara të shkollimit konvencional dhe liberal. Për fakultete aplikohet degëzimi për njohuri të ndryshme, ndër të cilat modelet e mësimi praktik, sidomos ato kushtuar biznesit, janë më pak ose më shumë të përhapura. Pastaj, ripërtirja dhe freskimi i diturive aplikohet për menaxhment e menaxherë, si shkollim përmes seminarit, kursit e tryezës debatusese.

Ann M. Martin (në "Implikimet në resurset njerëzore"), shtjellon dhe rendit një varg institucionesh, të cilat plotësojnë kërkesat për forcë punonjëse, arsimimin, aftësimin dhe stërvitjen e përsëritur, të cilat mund t'i realizojnë nevojat e duhura: universitetet, kolegjet katërvjeçare, kolegjet dyvjeçare, shkollat teknike, shkollat e mesme profesionale, qendrat private për aftësim, organizatat profesionale (sikurse është RISME - Robotic International of the Society of Manufacturing Engineers), kurset afatshkurtëra, vetëarsimimi.

Sipas modelit të edukacionit, shtjellohen konceptet e aftësimi. Njëri prej këtyre anon nga dituria, si përqendrim në çështjet globale dhe më të thelluara në relacionet teoriko - praktike. Tjetri ka për qëllim nxitjen e aftësive dhe projektimin e tyre për ndërtim pragmatike, që kryesisht mbështetet në përvojat, konceptet, skemat dhe efektet e tjerëve, të cilat këta i kanë ndërtuar dhe sprovuar. Për dallim nga një pjesë e mësimëve të konceptit konvencional – mësimëve me metoden jotransparente - të cilat mund të bëhen edhe në mënyrë të pavarur - autodidakte, duke u mbështetur në literaturën relevante, në edukacionin për krijimtari të mirëfilltë në biznes, veprimi i tillë bëhet mjaft i mangët. Për këtë edhe nuk parapëlqehet. Aq më pak parapëlqehet qasja autodidakte, të paktën për aftësimin e dendur dhe të mbaruar.

Dukuritë që përkrijnë me anakronizmin e Kosovës që qasjen e ndërthurjes së novacioneve edukative, pikërisht nismën e kanë nga përtacia mendore dhe injorimi i iniciativave për të balancuar në mënyrë më racionale ndërmjet tradicionales dhe spontanës. Është lehtë të thuhet e vështirë të zbatohet ngase mungojnë shumë komponentë të resurseve të freskëta njerëzore, të infrastrukturës institucionale e materiale. Të gjitha përshkrimet që rendis këtu e kanë këtë kuptim, si udhëzim për daljen nga amullia e tejzgatur. Por nisma duhet të përqendrohet nga fillimi i shkollimit, që të sublimohet me shkallëzimin e arsimimit më të lartë.

Ecuritë më të reja në projeksionin e kërkesave për organizimin e sistemit të edukacionit dhe qasjes praktike, përshkohen me një shpërputhje nga komunikimi konvencional. Tradicionalizmi gjithnjë e më tepër po zëvendësohet me eksponime asimetrike të cilat në disa mjedise herë pas herë krijojnë huti. Programet e institucionalizuara dhe të painstitucionalizuara, po ndërrojnë vendet në favor të atipikës arsimore të painstitucionalizuar. Qëllimet e tilla arrihen me iniciativat individuale e ekipore për komunikim sa më të afërt ndërmjet arsimtarëve dhe vijuesve. Bëhen edhe stërvitje eksperimentale të zëvendësimit të vendeve sipas

logjikës: "ku, si do të veprosh". Frytet e mënyrave të tilla të veprimit janë të pakontestueshme. Mirëpo, pengesat që imponohen ndërmjet veprimeve elastike dhe statike, të murosura për një kohë të gjatë në tradicionalizmin skolastik, janë mjaft të shprehura. Këto më së tepërmi ngadalësojnë procedimin institucional të shkollimit të frymëzimeve të gjithanshme për iniciativa të suksesshme.

Motivimi

Për të gjitha qasjet me vlerë, patjetër duhet të ekzistojë motivacioni. Të motivohesh dhe të motivosh të tjerët për punët përkatëse, qenësore është kënaqësia që buron nga vlerësimi i drejtë i kërkesës personale dhe të asaj ekipore, gjasisht kolektive. Nuk mund të arrish efektin e duhur duke vepruar pa motiv, që do të thotë pa gëzimin që do ta gjesh në veprimtarinë përkatëse.

Motivacioni shpreh lirinë personale të zgjedhjes së punës sipas aftësive, por edhe leverdinë që korrespondon me shpërblimin përkatës. Gjithëherë, gjithëkund motivit i kushtohen përplot trajtime teorike dhe empirike. Njeriu ka nevoja shpirtërore dhe trupore, pra psikike dhe fiziologjike. Duke mos i përmbushur këto, efekti i punës do të mbetet i mangët.

Veprimi pa motiv të caktuar, barazohet me dhunën nga tjetri ose detyrimi ndaj vetes. Që janë të ngjashme. Në këto rrethana, puna shkakton lodhje dhe zvogëlon kujdesin që si pasojë ka kufizimin e reflekseve dhe mund të sjellë lëndimin. Ndërkaq, e ndjek amullia dhe krijimi i raportit indiferent ndaj veprimeve.

Ushtari në afatin e obliguar të shërbimit, do të kujdeset që të kalojë koha me sa më pak mund e vështirësi. Motiv i tij është afati që duhet të skandojë. Për atë kohë do të kujdeset të përmbushë nevojat fiziologjike elementare të jetesës në kushtet e lirisë së kufizuar dhe nën mbikëqyrjen e detyrimeve që duhet t'i përballojë. Vullneti këtu është baras me motivin e kufizuar në suazën e detyrës.

Artisti do t'i qaset punës me qëllim që duke krijuar veprën t'i shtojë vetes kënaqësitë që bëhen afatgjata, pra duke kaluar në gëzim. Ai nuk do të ndjejë lodhje se është i motivuar. Pëderisa ushtari do të veprojë si një mekanizëm pa dashuri, artisti do ta arrijë ekstazën e përqendrimit në punën në të cilën është i dashuruar.

Motivi i njerëzve dallon. Mund të jetë i *njëanshëm* ose *kompleks*. Dikush do të adhurojë vetëm paranë, tjetri prestigjin, mandej shprehjen e të gjithave përmes punës së kujdesshme e kështu me rradhë. Por shumica e njerëzve do të kërkojnë plotësimin e motivit kompleks, pra të përmbushur me të gjitha kërkesat njerëzore. Ndërkaq dallohet edhe motivi i *justifikushëm* dhe i *paarsyeshëm*.

Nuk mund të peretendosh atë që t'është e paarritshme. Kështu do të frustrrohesh duke e humbur efektin paraprak të motivit. Me siguri se mbi baza të punës dhe efektit konkret, do të gjesh edhe motivin e matur sipas vlerës së drejtpeshuar.

Motivi rritë edhe përgjegjësinë, ndonëse lidhet me të. Në shumicën e kompanive të mëdha, që të bëhen avokatë ose këshillëtarë të jashtëm të tyre, përparësia është në anën e atyre që kanë aksione në to. Pra të jenë edhe aksionarë. Kështu duke i shërbyer ndërmarrjes, njëkohësisht do t'i shërbejnë edhe interesave të veta.

Por, si t'ia bësh ku vendi i punës është i panjohur? Pikërisht në këtë instancë mbërthehet ngatërrimi i motivit si vlerë e suksesit dhe satisfaksionit me të paarritshmen e mbarësimit të punës së deponuar si efekt produktiv i aftësimit

konkret. Do të thotë se ndërlidhet sukcesi përkatës me shprehjen e deponimit të punës së sprovuar.

Te një numër i konsideruar i autorëve, çështja e suksesit sillet rreth dilemës ndërmjet "kismetit fatlum dhe gjykimit të mbarë". Megjithëse arsyetimi i njëjës anë më tepër ka të bëjë me aftësinë dhe rezonin logjik dhe i anës tjetër me pasigurinë krijuese, që përcjell çdo sjellje normale. Prapëseprapë në një masë të konsideruar hasen premisat e përziera me fatin. Nga kjo përsiatje, prokopia si rezultat i suksesit, ndërlidhet me arsyen e paarsyetuar me fatalizëm. Në këtë relacion, sipas Eduard De Bonos, Xheki Stjuart shpjegon qëndrimin e vet: "Besoj se njeriu duhet pasur fat për t'u gjetur në vendin e duhur në kohën e duhur".

Shpjegimi realistik nuk mbështet fatin as si parim e as si gjykim. Me shkathësi dhe guxim, duke shtyer iniciativën, arrihet të provokohet fati. Kur këto veti, si komponentë ndahen njëri nga tjetri, me siguri se arrihet deri të paaftësia. Andaj nuk ka fat as sukses, përpos atij që do ta krijosh vetë. Ndërsa, asgjë nuk do të shitet më mirë se sukcesi.

Në përcaktimin e strategjisë për suksesin përkatës, çdo gjë duhet të vëhet në vendin e vet dhe të arrijë në cakun e përcaktuar në kohën e vet. "Ndodhitë" e mira ose të këqija, mund t'i përshkruhen rastit. Këto bëhen frymëzim fatlum ose shkaktar të dëshpërimit. Nuk ka të korra të mira pa të mbjella të mira, në kohën e caktuar, në tokë të mirë, me farë të mire, ashtu si njeriu i duhur të gjendet në vendin e duhur, në kohën e duhur.

Koha dhe vendi, ku mungon konkurrenca dhe motivi i përcaktuar sipas rregullave të tregut të vlerave, përbëjnë bazën e kufizimeve të ngrirjes së raporteve të përparimit. Ky status me siguri se në Kosovë ka marrë përmasën brengosëse. Ose nuk i bëhet shtytje ose edhe pengohet ndërhyrja profesioniste në të gjitha segmentet e veprimtarive produktive. Autarkija me autoritetet dominante të shoqërisë, për hirë të pozicionimeve të privilegjuara, përserisin suazën e kohës së depresionit e të përndjekjeve. Atëherë motivi për edukacion mbahëj në shtyllat e qëndrësës si shprehje e revoltes dhe mbarësimit të kontinuetit mekanik dhe funksional. Tashti si tërësi shdërrohet në faktorin formal. Studenti, tashti motiv ka diplomën si "kështjellë" ose vetëm si autoritet me satisfaksion. Por jo për secilin. Kjo i përket atyre që do të mësojnë "gjithçka" duke mos pasur para vetes arritjen e suksesit në vendin e punës, në kohën e kryerjes së shkollimit.

Në vendet perëditmore mundësia e shkollimit të lartë është e kufizur me përplot barriera, por për të sukseshmit shtegu i arritjes së qëllimit është i hapur. Kompanitë e njohura, por edhe nga biznesi i vogël dhe i mesëm do të përpiqen t'u ofrojnë ndihmesë amateriale studentve të dalluar, duke i lidhur me kërkesën për punësimin në dërmarrjet e veta. P ashtu edhe adminstrata shtetërore përkujdeset në të njëjtin drejtim me favorizimet për punësim. Përkrahja është vërtetë kuptimplote, e përmbushur me shtytje të shumanshme sikurse ushtrimi gjatë studimeve dhe lehtësim punësimi në ndërmarrjet që i krijojnë këto favorizime.

Ilustrim fare qenësor ndaj motivimit, mund të merret kompleksi i kundëvënies ideologjive me zbërthimin e vlerave të mirëqenies në mbështetje të ngritjes personale. Nuk e ka bashkuar Gjermaninë rrënimi i murit të Berlinit, por ndërtimi i tij. Duke krijuar ecuri të zhvillimit të hovshëm në njëjës anë të këtij muri, përherë zgjohej kërshtëria në anën tjetër. Kështu ballafaqoheshin dy përmbajtje të

dy realiteteve. Edukacioni për efektivin ekonomik nga ana perëndimore duke u freskuar me rritjen e punësimit dhe kapitalit, shtoi kërkesat e reja në anë lindore. Partitë komuniste zhurmose të perëndimit, me parullat e proletariatit dhe barazisë mashtruese, sikurse në: Itali, Spanjë, Portugali, Francë e gjetiu, në kohën kur në lindje haptas vërehej stagnimi ekonomik, me përmbajtjet e reja edukative të materializura filluan të shuhen. Italia, që gjendej në pozitën më të vështirë me kundërshtitë e rrepta, krahas edukacionit për efektivin e ri të freskuar ekonomik, filloi privatizimin. I ftoi punëtorët të udhëheqnin bizneset e veta. Këta më s’kishin kohë të merreshin me konferenca. Motivi ishte shndërruar nga utopia idealiste në suksesin binzesor. Kësisoj u renditen gati të gjitha vendet e botës, që ende vuanin nga autokracia shtetërore dhe “lufta për drejtësi ideale.”

S’do mend se raportet e tilla në Kosovë ende as që janë planifikuar si pjesë përbërëse e prioriteve të ndryshme rrënjësore strukturale. Ndërmjet ndërfiten dhe përplot dukuri joetike deri edhe spekulative e klanore nga bartësit e pozitive të ndryshme në hijerarkinë shtetërore. Ndikimi i ndërsjellë në këto ecure disi mbahet me participimin dyanësh: të vendasve dhe të ardhurve në emër të ndihmesës prosperitetit protektoral të këtij mjedisi.

Profesionalizmi dhe autoriteti profesionist

Civilizimet që kanë pasur kodeksin, kanë ditë të gjejnë veten në shtigjet e përparimit, të mirëkuptimit dhe të drejtëmeve në kohën e kërkuar në rrethanat e caktuara. Religjionet monoteiste, kanë përcaktuar kodekset për t’iu ofruar njerëzve mundësinë e ngritjes së vetëbesimit dhe personalitetit. Shkenca e edukacionit të mirëfillt, e liruar nga idealizmi jofrytëdhënës gjithnjë ka shkuar para religjionit.

Sa është prezent kodeksi elementar etik dhe profesionist në mjediset e ndryshme? Në Perëndim ekziston kodeksi i shkruar dhe i pashkruar etik dhe rregullativo-ligjor. Edhe disa nga vendet e prapambetura u përmbahen disa rregullave të shpallura dhe të trashëguara etike. Ndërkaq gjenden edhe mjedise ku shkollimi si motiv i vetëm për diplomë, profesionizmin e ka të mbështetur në formën dhe krejt pak në përmbajtësoren.

Liria e sjelljes së njeriut, përkon me veçoritë e karakterit por edhe të qenësisë së deklaruar shtetërore. Qëndrueshmëria kushtëzon përmbajtjen ndaj rregullave elementare. Kodeksi është mbështetja për krijimin e vlerës afatgjatë. Pa kodeks nuk mund të bëhesh personalitet profesionist. Mund të bredhësh dhe rast pas rasti të arrish ndonjë leverdi, por profesionizmi i mirëfilltë si i qëndrueshëm, nuk zbatohet sipas rastit. E ka vijën e vet të fillimit dhe të vijimit në kahun e përcaktuar dhe të mbikëqyrur me ligjet dhe kodeksin përkatës.

Duhet të ekzistojë kodeksi unik dhe ai personal. Njeriu i cili nuk e ka kodeksin si pjesë përbërëse të qenësisë së parimeve të tij, çfarëdo tjetër nuk mund t’ia ngris personalitetin, mangësia e të cilit edhe ai profesionist, do t’i mbetet e kufizuar. Ndonjëri do të kryejë shkollë, do të marrë titullin ose thirrjen akademike, deri edhe që mund të zgjedhet akademik, por nuk ka autoritet profesionist, se i mungon përmbajtja e kodeksit të profesionit dhe personalitetit të mbështetur në përmbajtjen e diturive. Personaliteti profesionist mbështet kulturën si pjesë shpirtërore dhe stilin

original të qasjes veprimit, duke përfutur qëndrueshmërinë mbi ndërtimin e bazës së normave unike të karakterit institucional dhe moral. Të mos kesh këtë, profesioni do të mbetet i mangët. E kundërta i përket veprimeve joligjore ose vetëm joetike.

Do të shtrohet edhe çështja se të gjitha qasjet nuk do të thotë se janë të kushtëzuara me ndonjë kodeks, ashtu sikurse që është e kundërta, se çdo sjellje e ka kodeksin ose rregullën, nëpër të cilën lëviz dhe zhvillohet. Për profesionizmin mund të nxirren konstatime të njëjta - pro et contra. Pra, sikur të ishte profesionizmi qëllim i vetvetës, me siguri se nuk do të kishte rregull të caktuar të shfaqjes së tij. Kompleksi i rendit shoqëror këtë e projekton, mbikëqyrë dhe e kushtëzon. Nëse duhet bërë diçka serioze, rregullat duhet të respektohen.

Metoda e mësimin në tërësinë arsimore kosovare, ende qalon duke u mbajtur në një këmbë, që është më tepër formale me shmangien e këmbës zbatuese, përkatësisht përmbajtësore frytdhënëse. Mësohet shumë e më së paku për profesionin e mirëfilltë të kahjes e rritjes së efektivitetit ekonomik..

Çka do të thotë universitet? Nacioni *Universitet*, ka prejardhjen nga thënia latine: *universitas scholarium et magistrorum* - bashkësia e mësimarrësve dhe mësimdhënësve. Paraprakisht bashkësia duhet të kultivojë marrëdhëniet e ngrohta gati si familjare, duke mbështetur besimin e ndërsjellë. Si udhëheqës i lëndës dhe mësimave, mësimarrësit duhet të ushtrojnë shprehinë e komunikimit të lirë me raportin e përgjegjësisë së ndërsjellë, sikurse drejtimin e vërejtjeve për moskujdesin dhe mungesën e vullnetit për shtruarjen e çështjeve në interes të afrimit të përbashkët sipas kuptimit të plotë. Mandej në përsëritjen e mësimave. Por njëkohësisht duhet ndarë vijuesit në grupe përkatëse sipas afinitetit të mësimarrjes dhe përkushtimit.

Në mjediset e motivimit të lartë dy anësh të edukacionit, dita me ditë është duke u gritur cilësia me vlerësimin objektiv të diturive të arritura. Po ndërhyhet me metoda të sofistikuar teknike dhe njerëzore. Kryesisht tërësia e tillë drejtohet nga kooperative të ndërmjet mësimarrësit dhe mësimdhënësit, duke i shtuar kreativitetin. Mësimi statik gjithnjë e më shumë është duke e humbur rëndësinë klasike, përkatësisht konvencionale. Mësimdhënësit krijojnë situata të spontanitetit duke i gërshetuar me të priturat. Frymëzimi kreativ bëhet më tërheqës ndaj mësimin.

Domosdoshmëria e bashkëpunimit të mësimarrësve, shprehet me shumanshmërinë ekipore duke i avancuar qasjet që praktikisht do të duken më frytdhënëse. Në anën e mësimarrësve, shtohet kujdesi, se këta më shumë do të jenë të hapur mes vete se do t'i afrojnë motivi, besimi dhe nivelizimi i interesit të përbashkët. Në shumë mjedise është konstatuar se mësimarrësit për zgjidhjen e detyrave, më lehtë do të gjenden duke bashkëpunuar dhe u përballuar njëri me tjetrin se me mësimdhënësit. Thjesht se ngurrojnë para mësimarrësit. Por, mënyra e tillë sjell edhe diç më të vlerëshme: ushtron për qasjen ekipore të veprimeve të mëtejme. Tërësia e bashkëpunimit, nënkupton mësimin sipas kërkesave të zbërthyera në shumë kahe. Gjërat duhet të sporovohen dhe të vlerësohen sipas efekteve frytdhënëse. Sa ushtrohet kjo metodë në Kosovë!? Ndoshta pak ose dhe aspak, pasi që marrëdhëniet janë të ndërlikuara për shkak të mosbarazsë profesionale dhe smirës ndaj atyre që do të prinin para klanit të instaluar për të ndaluar garat për hatër të paaftësisë së atyre që ose kurrë nuk kanë qenë profesionistë egalë, ose që kanë arritur në “instancën e aftësisë së paaftësisë” së komunikimit profesional..

Kuptimi i kreativitetit, ndërlidhet me krijimin e qasjeve të modifikuara mbi bazë të modelit që secili mësimdhënës e harton, sipas natyrës së materies që e shtrun si mësim të

shikuar në drejtimin e metodës përkatëse. Duhet të ndahen edhe njësitë metodike specifike që kërkojnë trajtim të veçantë. Ndërsa natyra e tillë e veprimit, ndihmon që shumë gjëra në vijueshmëri, të ngritën mbi nivelin paraprak. Për këtë kreativiteti nuk është i menjëhershëm, por gradual sipas raporteve të ecurive evolutive.

Për të arritur efektet e vlerëshme, kërkohet shumë më tepër se që sot mësohet në mjedisin kosovar. Kushtet njerëzore dhe materiale janë në nivelin më të ultin në Evropë, si për nga pe-soneli mësimor ashtu edhe nga infrastruktura materiale, përkatësisht paisja teknike. Mësimarrësit duan të njohtohen me përmasat e ndryshme të qëndrimeve të autorve të ndryshëm, por edhe me qëndrueshmërinë autoriale të stileve të avancuara të mësimdhënies. Freskimi i personelit dhe metodave të mësimdhënies, pos në disa raste, këtu gati se nuk funksionojnë. Shumanshmëria e mangësisë shprehet në efektivin e kufizuar.

Aftësimi i efektivit ekonomik është kompleks me përmasa shumanëshe. Ndër ne çmohet si më i lehti! Segmentohet duke ekspozuar shkencës shterpe me teori të tejkaluara. Programe për trajnimin praktik që mësimarrësi do të mësojë atë që do t'i ofrojë punësimin në ndërmarrjet e institucionet e ndryshme, por më shumë për nismën e biznesit të vet nuk ekzistojnë. Koklavitja shkaktohet me përzierjen e njerëzve dhe zotimeve për të clat nuk janë krijuar kapacitetet mësimdhënëse dhe infrastrukturale.

Epilogu si efektiv

Efektivi shpreh rendimentin e vullnetshëm dhe motivin kreativ me lidhjen praktike si fryt dhënie konkrete. Me të nënkuptohet gjenerimi i ideve dhe nismave të reja në përshtetimin e rikutimit qenësor në të gjitha pjesët vitale të shoqërisë, në rend të parë të ekonomisë. Lidhmëria frymon në punëmarrjen dhe zotimet përgjegjëse për veprime të ndërgjegjshme sipas objektivizimit të vlerave në treg, pra konkurrenë dhe garues.

Ndërrhyrja aq kumbuese në reformimin dhe njësimin e sistemit të edukacionit në Kosovë, mbeti vetëm si një zë refreni i kohës për të cilat mendohej se kishin shkuar. U bë një ndërrhyrje mekanike –formale, sa për glazurë mediale e afirmim pa kundërshtarë të paftuar në reciprocitetin kreativ. U bë imponim i pranuar, sipas një drejtimi pa kod shkencor e kreativ, në saj të poltronizmit të profesionistve të vetëshpallur në emër të shkencës dhe egalitetit publik, me mbështetje klanore..

Të reformosh qenësisht, duhet të kesh infrastrukturë dhe njerëz me ndërrhyrje sipas botëkuptimeve të reja prej fillimit të shkollimit deri në instancën më të lartë. Për ata me ambicie të ngriten në nivelet e avancuara shkencore, ekzistojnë kriteret edhe më qenësorë. Ndër ne, ende dominon botëkuptimi për shkollimin e “pastruar” në të cilin nuk përfshihet kompleksi i edukacionit kuptimplotë. Pra mangësia e aftësimi do të shfaqet në kontraverzen me shkollimin dhe edukacionin si tërësi. Ndryshe duhet mëtuar se edukacioni është kompleks nga arrihen dituritë e dendura, çka nuk mudëson arsimimi i njëanshëm. Me të nënkuptohet tërësia e sistemuar ose e pasistemuar e aftësimi në shtëpi, shkollë, shoqëri. E tëra mbërthehet në mësimin me vullnetin personal dhe të imponuar. Pra, edukacioni përfshinë gjerësi e thellësi shumë më të madhe se arsimimi për të prodhuar “analfabet të diplomuar.”

Një fakultet, me hapësirë të kufizuar, pa mjete moderne të punës për të demonstruar mësimin, s'mund të bëjë diç të re. Aty kërkohet ekipi mësimdhënës që do të

bashkëpunonte për të ekspozuar qasjet individuale në ekip me videoxhirime, projektorë e të ngjashme në përbërje të rinjve inovatorë dhe të moshuarve koordinatorë. Pa infuzion të gjakut të ri me seriozitet profesionist, s'ka vitalitet.

Si raritet i emoduar dhe kontraproduktiv, në anën e fillimit, pra mësuesi në klasën e parë e ngarkon nxënësin me përplot detyra, si të mësojë shkronjat, të vizatojë katrorin e të ngjashme. Duke mos i bërë shtytje për mendimin personal, duke shikuar rrethin dhe ndodhitë e natyrshme spontane dhe menjëherë sa më shumë tradicionale, nxënësi si fëmijë do të bëhet oponent i shkollës. Do t'i pështirohet mësimi. Anash motivimi i mësimdhënësve tanë për të ofruar mësim vetëm me entuziazmin patriotik, duke u ngopur me ajr e erë shkumësi për më shumë se 11 vjet.

Eksperimenti reformues veçsa krijoi shembje të përgjegjësive personale dhe kolektive. Institucionet arritën në shkallën e mospërgjegjësive ngase kjo u shpërnda gjithkrah që mbeti vetëm ndërgjegjja profesioniste dhe dinjiteti individual si mbështetje që nuk është edhe aq masive.

Mirëpritja joefikase dhe motivi joadekuat e të shkolluarve me metoda të avancuara në vendet e perëndimit, për t'u përfshirë në rrjedhat e efektivitetit të gjithëmbarsuem në Kosovë, shfaqet si suazë e veçantë. Në realitet as që trajtohet në institucionet kompetente në mënyrë meritore.

Rezime

Ndër strategjitë e përparuara në decenien e fundit, pa dyshim janë teknikat si risi të mësimave zbatuese, sidomos në të gjitha fushëveprimet frytdhënëse, nga krijohet mirëqenia dhe paqja, të matura me leverdinë profitabile. Hapësira e depërtimit në drejtimit vendore dhe ndërkombëtare, gjithnjë erdhi duke u bërë e përshtatshme dhe shfrytëzuese për secilin. Ndër zbulimet e fundit, pa mëdyshje është zhvillimi bioinxhinieringut dhe i teknologjisë së frekuentimit inofmativ, pikërisht me përhapjen e shpejtë të zbulimeve pragmatike të përqendruara në internet. Me zbulimin e teknikës dhe teknologjisë së re, u ndërtuan stabilimente, institucione dhe organizma të cilët hapin shtigje të avancuara për veprime efektive. Në këtë drejtim, edukacioni u shpërnda në shumë metoda e modalitete të përshtatshme sipas masës së secilit.

Motivi i pandryshueshëm i njeriut, është pavarësimi individual me krijimin e të ardhurave të arritura sipas mundësive të kyçjes në veprimtarinë përkatëse. Punësimi, dikton rrjedhën e edukacionit efikas në mënyrë të ndërsjellë ashtu si edukacioni përshpejtëson hapjen e vendeve të reja të punës. Kësisoj, janë duke u ndërtuar raporte të reja të sjelljes, gjegjësisht komunikimit më të lehtësuar ndërnjerëzor. Aksioma se sa më shumë do të mësosh, aq më pak do të harrosh kërkesat dhe ndarjen e tyre sipas përparësive, gjithnjë me intesitet më të madh është duke u përqendruar në edukacionin frytdhënës.

Është e njohur se të gjitha vendet nuk e patën këtë qasje fatlume. Aty ku tregu vepronte "pa mëshirë", u krijua kultura e re e marrëdhënieve ndërnjerëzore, si mëshirë e vetes për pavarësi individuale e kolektive. Vitet që po pasojnë, me siguri se në sferën e edukacionit do të sjellin risi edhe më të suksesshme, me të cilat njerëzimit do t'i ofrojnë begatim suplementar të kulturës, vullnetit dhe humanizmit mbi baza të reja.

Edukacioni është filluar sipas normave të kulturës klasike. Duke evoluar, ka përjetuar metamorfozë marramendëse në zbulimin e vlerave njerëzore si resursi parësor në të gjitha fushëveprimet. Në prodhimtari kur oferta e ka tejkaluar kërkesën, kanë dalë në shesh dituri të reja. Pra, kërkesa u përqendrua në synimin: si ta bëjmë kërkesën tërheqëse. Ashtu është duke u adaptuar edhe sistemi me mekanizmat, metodat, modelet, organizmat e edukacionit; kushtimisht thënë profitabil. Konkurrenca intensive e vlerave frytdhënëse, ka kushtëzuar qasje të reja jo vetëm në pjesët ekonomike, por edhe në fushëveprimet tjera duke ndërhyrë edhe dituritë më të gjëra nga kultura dhe psikologjia. Shkencë e veçantë u nda përcaktimi i edukacionit tekniko-teknologjik dhe të relacionit ndërnjerëzor. Ngathtësia u zëvendësua me dinamizimin e shprehjes më ekzakte në pyetjet, përkatësisht ndaj kërkesave të tregut të zhvilluar të diturive, të lirë, por të mbikëqyrur nga shumë instanca shtetërore e joshtetërore. Andaj, domosdo edukacioni i inovuar, ka filluar të bëjë depërtime të përparura, duke reduktuar ose edhe shuar metodat e vjetra dhe ndërtuar të reja.

Ndikimi i ndërsjellë i biznesit në edukacionin dhe i edukacionit në biznes, bën nxitje permanente, duke futur energji të freskëta. Shtytjet e tilla, kanë sjellë ndërtimin e një kompleksi të edukacionit të sistemuar dhe të pasistemuar, duke shkuar në drejtim të një institucionalizimi dinamik. Andaj, edhe ajo që është përpiluar si përmbajtje e edukacionit të para njëzet vjetëve, tash më nuk është e vetme dhe prijëse në trajtimin e këtij. Teoritë dhe filozofitë për biznesin u drejtuan nga transparenca.

Aq më shumë, edukacioni i avancuar me ndikimin në rritjen ekonomike, krijoi suazën e re të zgjidhjeve të konflikteve duke i shuar një nga një. Menjanoi edhe luftën e ftohtë. Dhe triumfi u arrit me presionin e biznesit në qarqet politike duke e rikthyer këtë prej dominimeve të hapësirave, në ngadhënjimin ekonomik. As burrat e shteteve demokratike, më nuk janë të pavarur si dikur. Suksemi i tyre vlerësohet me efektet frytdhënëse në zhvillimet shumanshe, veçmas në përhapjen e kulturës edukative dhe relacioneve të drejtpeshuara në raportet ekonomike. Të gjitha mbi përparimin e edukacionit frytdhënës dhe mirëqenies njerëzore.

Ai, që do të hapë më shumë tregje dhe vende të reja të punës, është i parapëlqyeri. Andaj me plot mend, mund të konstatojmë se edukacioni duke hapur tregun, çeli shtigje të reja të thurjes së sistemeve të avancuara shoqërore demokratike. Bëhet e qartë se sa më i zhvilluar të bëhet efektiviteti ekonomik, përfiton demokracia që sjell harmoninë ndërnjerëzore. Dhe anasjelltas sa më e zhvilluar demokracia, do t'i jep krah zhvillimit të biznesit dhe përparimit të shoqërisë.

Normat klasike të ekonomisë dhe ekonomizimit, kanë ndihmuar që të krijohen baza të reja të këmbimit material dhe mendor. Dituritë e zgjeruara, kanë sjellë strategjinë e inovuar të tregut ndaj njeriut si blerës dhe shitës, me përplot ndërhyrje të reja tërheqëse, duke eksponuar një kompleks të artit, shkencës, mjeshtrisë dhe kulturës së biznesit.

Përparimet e gjera ekonomik kanë nxitur zhvillimin e edukacionit. Sikurse që elektronika, përkatësisht mikroprocesorët, kanë zvogëluar madhësinë e aparateve e stabilimenteve, ashtu edhe edukacioni, nën presionin e këtyre "zbulimeve", patjetër është gjetur në shkurtimin e rrugës dhe mënyrës së komunikimit me këto dhe për këto produkte. Mjetet e komunikimit, si resurse dhe infrastrukturë e re,

kanë shkurtuar dhe thjeshtuar tërë mekanizmin e zhvillimit. Andaj, është e qartë se edhe edukacioni është bërë më inventiv, më praktik dhe më i thjeshtësuar. Metodatat e zhvillimit ekonomik, patjetër është dashur të ritransformohen që të ndikojnë në ristruktuimin e përgjithshëm duke optimalizuar ndërvarësitë e ndërsjella mes ekonomisë dhe edukacionit.

Ristruktuimi dhe optimalizimi ekonomik, duke përfshirë tërësinë e veprimeve njerëzore dhe rirënditjet materiale, në biznes ka sjellë raporte fare të intensifikuara. Krahas kësaj, edukacioni në mënyrë revolucionare ka përfutur referenca të reja. Të arriturat, patjetër kanë krijuar tërësi për të cilat janë parashtruar kërkesa të përparuara; siç shprehet Ann M. Martin: "Orvatjet themelore hulumtuese (të *stampit - stump*), në lëmin e shkathësisë së diturisë, aftësisë dhe qëndrimeve, që shtrihen në bazën e çfarëdollojshmërisë së mjeshtrive njerëzore, tash ishte dashur për t'i rishqyrtuar dhe zgjeruar, sidomos në vështirimin e ndërrimeve kualifikuese... '*Stampi*' bën pyetje: *cilat janë aftësitë transmetuese, cilat veçori të punëve mund të çmohen të përgjithshme* etj." Kështu, rritja po bëhet "mallkim" i kërkuar për t'u liruar nga tradicionalizmi jokohorent me kohën, gjasisht duke u liruar nga fazat e mëparshme të jetës për të arritur nivelin që shpjen nga dituritë më frytdhënëse.

Dituria e shtresuar për edukacion të metodave, koncepteve dhe modeleve të ndryshme, përbën njërën përmasë, por më e vlershme çmohet përmasa e aftësisë së transmetimit. Në realitet, në të dy anët po bëhen përpjekje për shkallë të lartë të aftësive të kondensimit të përbërë dhe transmetimit të thjeshtësuar të diturive për biznes.

Sistemi i informacioneve, duke u shtrirë në të gjitha fushëveprimet njerëzore, edukacionin e ka ngritur në nivel më të lartë, në rend të parë duke eksponuar kritere më të ashpra të vlerave praktike. Heterogjeniteti dhe tipizimi, si dy kahe të zhvillimit të shoqërisë, kanë sjellë deri te shkëputjet nga mbështetjet konvencionale, duke u drejtuar nga ato më liberale – jokonvencionale. Me këto lëvizje, edukacioni për biznes ka përfutur përbërje dhe vlerësime të reja, në të cilat lakonizmi ka filluar të ndërhyjë në komunikim e që kërkon përgatitje më të dendura. Nuk është shpallur gjithçka klasike edhe konservative, por që sipas kohës shumë shikime që ishin të shpallura konvencionale, por të liruara nga "dogmat" pengoheshin në përhapjen e tyre nga konservativët e "moralshëm". Të jesh puritan dogmat, nuk do të thotë se je edhe i moralshëm. Duke u ndarë etika nga morali biznesor, janë krijuar qasje të reja ndaj konsumatorit, por edhe duke profilizuar moralin e ri sipas kohës së edukacionit të përparuar.

Në Kosovë, fatkeqësisht dogmat edukative gati se e kanë zëvendësuar njëra-tjetrën, pikërisht për shkak të konservatizmit ndaj qasjes liberale të edukacionit. Patjetërsisht edhe në arritjen e efektivave të tij të matura me të ardhurat. Praktikisht profitabiliteti edukativ është ngushtuar edhe më shumë se që dikur mund të krijonte rendimentin përkatës.

ROLI I FAKULTETIT EKONOMIK NË NXITJEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS

HYRJE

Fakulteti Ekonomik është themeluar në vitin 1961 dhe ka kontribuar në përgatitjen e kuadrove profesionale për punë në ekonomi. Është një nga fakultetet që është në fokus të interesimit të studentëve dhe për këtë arsye, për shkak të numrit të kufizuar të studentëve që pranohen për të vijuar studimet e ekonomisë, vite me radhë është evidente konkurrenca e madhe për regjistrim.

Në fazën e parë të zhvillimit, Fakulteti Ekonomik ka punuar bashkë me Fakultetin Juridik dhe vetëm pas vitit 1971 pavarësohet në tërësi. Në këtë periudhë, Fakulteti Ekonomik shënon rezultate të konsiderueshme, duke përgatitur ekspertë të ekonomisë nga të gjitha fushat.

Në vitin 1991, me aplikimin e masave të dhunshme nga pushtuesi serb, Fakulteti Ekonomik, bashkë me të gjitha fakultetet e Universitetit të Prishtinës, hyn në një fazë tejet të rëndë të zhvillimit.

Përkundër rrethanave jashtëzakonisht të vështira dhe kërcënimit të vazhdueshëm nga ana e pushtesit serb, Fakulteti Ekonomik, si edhe tërë Universiteti i Prishtinës, arrin të mbijetojë. Pikërisht në këtë periudhë në Fakultetin Ekonomik fillon procesi i reformimit.

Reformat në Fakultetin Ekonomik

Në periudhën 1992/93 në Fakultetin Ekonomik bëhet reformimi i tërësishëm i Planit dhe Programit mësimor dhe themelohen tri drejtime:

- Zhvillimi ekonomik,
- Financa, banka dhe kontabilitet dhe
- Menaxhment dhe informatikë.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe kthimit të studentëve e profesorëve në lokalet e tyre, krijohen kushte më të mira për punë mësimore-shkencore.

Pikërisht në këtë periudhë vërehet nevoja për riorganizimin, rikonstruktimin dhe reformimin e Fakultetit Ekonomik, në mënyrë që kuadrot e dala nga gjiri i këtij Fakulteti të jenë të përgatitura për ekonominë e tregut.

Pas një pune serioze të stafit akademik të Fakultetit Ekonomik, përpilohet plan-programi i ri në përputhje me Deklaratën e Bolonjës, sipas sistemit 3+2+3.

Implementimi i këtij planprogrami fillon që nga viti 2001/2002. Studimet e rregullta zgjasin 3 vjet dhe vetëm viti i parë është i përgjithshëm, kurse që nga viti i dytë studentët orientohen në 4 departamente:

1. Ekonomiks,
2. Financa, banka dhe kontabilitet,
3. Menaxhment dhe informatikë dhe
4. Marketing.

Që nga viti shkollor 1986/86, në Fakultetin Ekonomik janë organizuar edhe studimet postdiplomike në dy drejtime:

1. Ekonomia e ndërmarrjes dhe
2. Politika e zhvillimit ekonomik.

Në vitin 1998, pas një ndërprerjeje për shkak të rrethanave të disfavorshme, organizohen studimet postdiplomike me plan-programe të reja në dy drejtime:

1. Financa dhe
2. Menaxhment.

Pasqyra e studentëve të diplomuar në Fakultetin Ekonomik prej vitit 1961-2001 është si vijon:

Periudha	Studentët e diplomuar
1961-1971	144
1971-1981	1117
1981-1991	2467
1991-2001	1204

Periudha e fundit e viteve 90-të karakterizohet me një bashkëpunim të frytshëm me Universitetet Europiane. Kështu, më 1997 nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Vaxjo në Suedi, gjë që mundësoi që një numër studentësh të studiojë në Suedi, disa prej të cilëve kthehen me tituj Master nga Suedia.

Që nga nëntori i vitit 1999, realizohen programe të doktoratës me Universitetin Staffordshire të Britanisë së Madhe.

Në vitin 2000, Fakulteti Ekonomik fillon një bashkëpunim të frytshëm me Universitetin e Amsterdemit, Fakultetin Ekonomik dhe Ekonometrik, kurse që nga viti 2001 me Universitetin Shtetëror të Arizonës (Arizona State University) dhe Universitetin e Lirë në Bruksel (Free University).

Nxitja e zhvillimit ekonomik të Kosovës

Roli i Fakultetit Ekonomik qëndron edhe në dhënien e ekspertizës dhe ofrimit të resurseve për zhvillimin më të shpejtuar ekonomik të Kosovës. Në këtë drejtim, kuadrot profesionale të Fakultetit kanë detyra të rëndësishme:

1. duhet t'u ofrojnë asistencë bizneseve,
2. duhet të forcojnë lidhjet në mes të Fakultetit Ekonomik dhe komunitetit të biznesit dhe
3. duhet të promovojnë zhvillimin e teknologjisë dhe transferin e saj në treg.

Në këtë drejtim, në kuadër të Fakultetit Ekonomik duhet të themelohet Qendra për Zhvillimin Ekonomik, ku do të angazhohen ekspertët e fushave të ndryshme të ekonomisë, për të ofruar trajnimin kualitativ, që do të ndihmonte bizneset të punojnë me efikasitet më të lartë, të themelohen bizneset e reja apo të avansohen bizneset ekzistuese.

Programet profesionale do të përfshijnë këto opsione:

- **Seminare biznesi**, ku do të ofroheshin informata të nevojshme për themelimin e bizneseve të reja dhe forcimin e bizneseve ekzistuese,
- **Ëorkshope të kompjuterëve** – duke bërë të mundur që sotëare-at e sotëm të biznesit të aplikohen në ndërmarrjet kosovare.
- **Trajnime për zhvillimin e ëebsite-ve**, duke ofruar njohuri për disenjimin, lansimin dhe promovimin e ëebfaqeve të mira.
- **Trajnime për teknologji të avansuar**, duke ofruar ëorkshope për IT profesionistët nga bizneset e suksesshme kosovare.

Po ashtu, në kuadër të kësaj Qendre do të ofroheshin Këshilla falas për sektorin privat nga këto fusha:

1. Vlerësimi
2. Analiza cash-floë
3. Planet e biznesit
4. Planet financiare
5. Planet e marketingut
6. Zgjidhja e problemeve
7. Buxhetimi
8. Tregtia e jashtme
9. Planet operative
10. Zhvillimi i produkteve
11. Planet strategjike
12. Pakot e huave
13. Hulumtimet e fizibilitetit.

Meqenëse shumica e bizneseve në Kosovë janë të vogla, mbështetja e tyre me shfrytëzimin e resurseve humane të Fakultetit Ekonomik ka një peshë të veçantë, duke mundësuar kështu përmirësimin e kualitetit të menaxhmentit të tyre dhe me këtë edhe në suksesin e tyre.

Gjeneratat e reja duhet të aftësohen për t'u ballafaquar me problemet praktike. Atyre duhet t'u mundësohet që të punojnë në ndërmarrje dhe të pajisen me njohuri praktike. Aktualisht, studentët që marrin diplomën, nuk janë të gatshëm t'i përmbushin kërkesat e tregut nga aspekti i përvojës së caktuar të punës në lëminë e studjuar. Në disa shtete të Europës Qendrore e Jugore, universitetet janë iniciatore që studentëve t'u mundësojnë kryerjen e punës praktike gjatë studimeve (6 muaj deri 2 vjet). Këta studentë pastaj janë të gatshëm të punësohen menjëherë, pa pasur nevojë që pas diplomimit të vazhdojnë si praktikantë për një periudhë njëvjeçare.

PËRFUNDIMI

Roli i Fakultetit Ekonomik në zhvillimin ekonomik të Kosovës është i shumëfishtë. Në radhë të parë, ky institucion përgatit kuadro profesionale për ekonominë dhe organizatat e tjera. Pajisja e të rinjve edhe me njohuri praktike do të mundësonte që

ata më lehtë të kyçen në jetën ekonomike të Kosovës dhe në këtë drejtim do të ndikonte edhe në rritjen e potencialeve njerëzore për nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Nevojë imanente është edhe lidhja më e ngushtë e Fakultetit Ekonomik me ekonominë e Kosovës. Kuadrot profesionale të Fakultetit mund të japin një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e ndërmarrjeve kosovare, duke punuar së bashku në Projekte të caktuara, duke ofruar shërbime të konsaltingut, etj. Ofrimi i trajnimeve për kuadrot që punojnë në ekonomi në fusha të ndryshme, si financa, kontabilitet, marketing, etj., gjë që do të ishte një kontribut i çmueshëm për kuadrot që punojnë në ekonomi dhe të cilat, me një aftësim të tillë, do të ishin në gjendje të ballafaqohen me probleme të ndryshme dhe me konkurrencën, që është gjithnjë e më e ashpër.

Funksionimi i një Qendre për Zhvillimin Ekonomik në kuadër të Fakultetit do të ndikonte dukshëm në aftësimin e kuadrove që punojnë në ekonomi dhe në afrimin më të madh të Fakultetit Ekonomik me ekonominë, me çka do të krijohet një gjeneretor i fuqishëm për zhvillimin më të shpejtë ekonomik të Kosovës.

ASPEKTE TË REFORMËS SË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI

REFORMIMA UNIVERSITARE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

H y r j e

Themelimi i Universiteti të Prishtinës me 18 nëntor të vitit 1969 ishte një ngjarrje historike për popullin e Kosovës, sidomos për kombin shqiptar. Kjo ditë i dha kahje të deshirueshme qëllimeve tona dhe ndihmoi afirmimin tonë të përgjithshëm, duke hapur një dritare të re prej nga depërtoi dija aq e çmuar në jetën letrare, artistike dhe shkencore.

Duke qenë një tempull i dijes dhe afirmimit tonë të përgjithshëm kombëtar, Universiteti ishte atak i sulmeve të regjimeve serbe, të cilat te ky institucion shihnin gjithnjë rrezikun më të madh për realizimin e aspiratave të tyre pushtuese. Por këto përpjekje dështuan, ngase universiteti ynë krahas mbijetesës së tij, ishte edhe një vatër e fortë e kultivimit të rrezistencës dhe kundërvënies së fuqishme armikut dhe aspiratave të tij pushtuese.

Pikërisht në kuadër të këtij universiteti filloi procesi i pavarësimit të Kosovës, fillimisht në vitin 1981 dhe së fundi me luftën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në radhë të cilës ranë për të mos vdekur kurrë studentët dhe profesorët më të devotshëm të Universitetit tonë.

Mirëpo, ne sot nuk mund të ndalemi më gjatë në të kaluarën dhe mbijetesën e lavdishme të Universitetit tonë. Tani duhet të kthehemi nga e ardhmja dhe detyrat që na presin. Pa dyshim, se një nga prioritetet tona sot është dhe do të jetë procesi i reformave, i cili sapo ka filluar të zbatohet.

Reformimi i Universitetit-një interes kombëtar i Kosovës

Reforma e arsimit të lartë është një proces më rëndësi sistemore për çdo shtet. Një rëndësi të veçantë, ky proces e ka sidomos për Kosovën, e cila tani ka filluar shtet krijimin e saj, në të cilin edukim dhe arsimit, e sidomos universiteti duhet të luajë një rol të veçantë.

Reforma në Universitet është një sfida e veçantë për tërë shoqërinë tonë, e sidomos për subjektet e universiteti. Sot ne duhet të hymë guximshëm dhe

vendosshmërisht në reformimin e Universitetit, duke e shndërruar atë në një universitet bashkëkohor dhe modern dhe të rrespektuar, që do të jetë kompatibil me universitetet evropiane. Reformimi i universitetit është një domosdoshmëri e kohës dhe nevojë imediate e gjeneratave të reja, të cilat duhet të ngriten, edukohen dhe specializohen sipas standardeve evropiane.

Ky proces është imediat edhe për faktin se shoqëria kosovare tani po hyn në një

proces të gjithanshëm të tranzicionit, në të cilin arsimi dhe edukimi duhet të jenë në

funksion të ndertimit të një koncepti qytetërues dhe civil e demokratik të shoqërisë

kosovare. Bartës i këtyre reformave duhet të jetë vetë universiteti, i cili posedon

kuadër dhe potencial të mjaftueshëm si dhe studentët të cilet duhet të luajnë rol aktiv

në këtë proces.

Reforma-jo me metoda patriotike e revolucionare, por me qasje serioze e profesionale

Mirëpo për aq sa është i domosdoshëm, reformimi i universitetit është edhe një proces shumë i përgjegjshëm, i cili kërkon një përkushtim shumë të kujdesshëm dhe serioz. Në të vërtetë çdo proces i reformimit të universitetit tonë duhet të marrë parasysh dy kriterë kryesorë: **kriterin integrativ**, që synon integrimin e universitetit në familjen e universiteteve evropiane, duke akseptuar standardet universitare evropiane, të cilat gjithnjë e më shumë po integrohen; dhe kriteri i dytë, **veçoritë e Kosovës** dhe periudhës së tranzicionit në të cilën ne tani po kalojmë. Vetëm kombinimi i drejtë i këtyre dy kriterëve mund të jetë qasje e drejtë dhe e akseptueshme për realitetin tonë.

Me rastin e reformimit të universitetit është shumë e dëmshme tendenca e qasjes regjionale, duke lidhur reformimin e universitetit tonë me universitetet e Ballkanit dhe të Evropës Juglindore. Në të vërtetë shpesh dëgjohen zëra se nuk duhet të shpejtojmë me reforma dhe duhet pritur reformimin e universiteteve në rajon, përkatësisht në Ballkan, e më pastaj edhe në të ecim rrugës së njejtë. Një qasje e tillë është e dëmshme dhe do të na vonojë në proceset e integrimit, sepse ne përisht tani kemi rastin që të zëmë hapin dhe të fillojmë integrimin e universitetit tonë në standardet evropiane. Pra **qasjen regjionaliste**, duhet zëvendësuar me atë **globaliste** që gjithnjë e më shumë ka tendencë unifikimi.

Reformimi i Universitetit mund të ketë sukses, nëse bazohet në logjikën e kontinuitetit dhe marrjen parasysh të përvojave dhe praktikave pozitive që ai ka krijuar gjatë tri dekadave të kaluara. Ruajtja e traditave dhe praktikave pozitive, kërkon edhe shumë qasje kritike ndaj dukurive negative dhe improvizimeve që universiteti ka bërë, duke u sfiduar me mbijetesën e tij në kushtet e okupimit serb të Kosovës. Reforma gjithashtu duhet shikuar si një proces dhe sfidë afatgjate e cila do të kërkojë një punë permanente në përsosjen e tyre.

Pra s'ka reforma me metoda revolucionare dhe patriotike, siç mundohet t'i interprojë dikush që është informuar gabimisht për qasjen shumë serioze që

aktualishtë po bën një grup ekspertësh vendorë. Reforma do të jetë e suksesshme poqëse bëhet me kriterë, qasje dhe metodologji të verifikuar profesionale dhe shkencore

Transparenca e procesit të reformave

Transparenca e prezantimit të modelit aktual të reformimit të universitetit, në tubimet me studentë me media dhe diskutimet shumë serioze në të gjitha fakultetet dhe në shkollat e larta dëshmojnë qasjen serioze ndaj reformave. Tubimet e hapura me studentë dhe transparenca e plotë me ta, duke zhvilluar një seri debatesh që do të vazhdojnë, pjesëmarrja aktive e studentëve, më së miri verteton qasjen e drejtë dhe të përgjegjshme ndaj reformave dhe inkorporimi i studentëve si subjekt aktiv në këtë proces.

Dëshmi për qasjen serioze ndaj reformave është edhe demonstrimi i fundit praktik i modelit të reformave nga sajuesit e tij, në seminarin e organizuar në Universitetin e Prishtinës. Ky prezantim ka befasuar edhe ekspertët ndërkombëtarë, të cilët kanë qenë të befasuar me qasjen profesionale, e cila është demonstruar. Demonstrime të këtilla do të vazhdojnë dhe për këtë qëllim se shpejti do të organizohen seminare të tjera, ku do të ftohen edhe ekspertët ndërkombëtarë me përvojë në reformimin e arsimit të lartë.

Pra kjo qasje e re, qysh tani ka arritur suksesin e saj, me vetë faktin se ka provokuar një debat shumë serioz, kritik dhe transparent për reformat universitare, i cili do të ndihmojë hartuesit e projektit, me rastin e finalizimit të tij, duke marrë për bazë vërejtjet dhe sugjerimet konstruktive të cilat do të mirëpritohen. Së fundi, ky edhe ishte qëllim që Universiteti, kohë më parë hapi diskutimin publik për modelin e ofruar, i cili nuk është i kufizuar në pikëpamje kohore dhe do të jetë i hapur gjer në fillimin e implementimit të plotë të tij, apo të elementeve të caktuar të tij.

Bartës i reformave – vetë Universiteti i Prishtinës

Ishte iluzore dhe e papranueshme qasja inerte dhe pasive e reformave, duke pritur imponime nga faktori ndërkombëtar. Ndihma e faktorit ndërkombëtar në procesin e reformimit të universitetit është e nevojshme dhe e dobishme, por ne vetë duhet të reformojmë veten, duke marrë parasyshë veçoritë e Kosovës dhe faktin se Universiteti ynë do të jetë Universitet shtetëror dhe anëtar i Bashkësisë së Universiteteve Evropiane. Kjo aq më parë kur tani më është e qartë se Administratori Ndërkombëtar përpos deklarimeve verbale dhe restriksioneve administrative nuk ka ofruar ndonjë model të mirëfilltë të reformimit të universitetit. Universiteti i Prishtinës posedon kuadra të përgatitura me përvojë ndërkombëtare, që janë të gatshëm të marrin mbi supe reformimin e tij.

Në sajë të një pune serioze tremujore, Universiteti i Prishtinës, nëpërmjet të Komitetit për Politikë Akademike, arriti që për herë të parë në dhjetëvjetshin e fundit, të koncipojë një model vendor të reformimit të Universitetit, i cili përmban elementet e përgjithshme të reformimit të fakulteteve dhe të shkollave të larta sipas modelit të bazuar në Deklaratën e Balonjës, i cili pritet që gjatë muajit të Evropës, të promovohet si model

evropian, në të cilin do të integrohen mbi 600 universitete nga të gjitha shtetet e Evropës. Pra do të jetë ky një model evropian i standardizimit të kriterëve universitare, i cili synon njohjen e diplomave dhe titujve akademikë si dhe levizshmërinë dhe qarkullimin e lirë të studentëve në universitetet evropiane.

Hartimi i këtij projekti dhe miratimi i tij nga Senati i Universitetit, si dhe debati konstruktiv, që aktualisht po zhvillohet në të gjitha subjektet universitare, rikthejnë besimin në aftësitë e brendëshme të universitetit dhe seriozisht sfidojnë autoritetet ndërkombëtare të cila gjerë me tani verbalisht kanë premtuar reforma në universitet. Kjo qasje e re është në përputhje me realitetin aktual në Kosovë, kur tani pas miratimit të dokumentit kushtetues, arsimit dhe edukimi në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe atë universitar, do të jenë në përgjegjësi të plotë të kosovarëve. Pra së shpejti do të pushojë administrimi ndërkombëtar mbi Universitetin (i cili ka qenë edhe ashtu kontestues, sepse nuk parashihej me Rezoluten 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së) dhe ne do të jemi vetë ata që të reformojmë veten. Me këtë do t'i jepet fund absurdit që një individ të ushtrojë dy funksione inkompatibile: atë të ministrit të arsimit dhe të administratorit ndërkombëtar për universitetin, absurd ky që ka vënë në pyetje autonominë e universitetit.

Kush e pengon procesin e reformave në Universitetin e Prishtinës?

Është e pakontestueshme se universiteti tanimë ka hyrë seriozisht në procesin e reformimit të gjithanshëm. Debati rreth modelit të ofruar kohë më parë për reformimin e fakulteteve dhe shkollave të larta, në mënyrë të qartë ka vërtetuar gadtshmërinë dhe dëshirën e fuqishme të shumicës së mësimeve për të krijuar një identitet të ri dhe modern të universitetit. Edhe studentët tanimë fuqishëm kanë shprehur dëshirën për reforma esenciale, të cilat atyre do t'u mundësojnë një studim modern, i cili do të jetë i njohur dhe ekuivalent në planin ndërkombëtar.

Debati shumë serioz dhe pranimit që i bëhet këtij modeli në shumicën e fakulteteve, rikthen besimin në mundësitë e Universitetit që me forcat e tij, me propozimet vetanake, di dhe mundet vetë të bëjë reformimin e tij, në mënyrën e cila më së miri i përgjigjet interesave dhe kushteve tona.

Mirëpo procesi i reformimit ndeshet edhe me një mori pengesash, që nga obstrukcionet e hapura, friga dhe pasiguria personale ose parciale nga ndryshimet rrënjësore, e gjer te përpjekja për denigrimin e kuadrit vendor, i cili tanimë ka marrë iniciativën nga faktori ndërkombëtar në reformimin e Universitetit dhe është i përkushtuar me devotshmëri në suksesin e tyre.

Pa dyshim, se procesin e reformave fillimisht e pengojnë tendencat që vijnë nga administratori ndërkombëtar, i cili që nga fillimi kishte qasje nihiliste dhe denigruese ndaj traditës së Universitetit. Ai me disa deklarata të pamatuara dhe paushalle tentoi të kontestojë traditat pozitive të Universitetit, duke marrë për bazë rastet individuale të dukurive negative dhe duke i trajtuar gabimisht ato si dukuri të universitetit. Ai do duhej që për rastet konkrete të devijimeve, nese i ka të njohura të jetë transparent, e jo të njollosojë tërë Universitetin. Qasja e tij për validitetin e diplomave të Universitetit, gjoja se korrupcioni si dukuri në Universitet, sidomos siç e quan ai gabimisht gjatë kohës së veprimit paralel është tendencë e drejtpërdrejtë për mohimin e punës dhe të traditës së tij.

Ngjashëm me këtë, reformat administrative që ai ka zbatuar, duke zvogëluar numrin e studentëve, shkurtimet në stafin mësimeve, zbatimin e kontratave të punës

dhe kufizimet financiare, nuk janë asgjë më tepër se sa reforma administrative, të cilat me të drejtë kanë shkaktuar pakënaqësi në Universitet.

Në këtë kontekst duhet theksuar edhe mosrespektimin e Statutit të Universitetit (i cili është hartuar nga ekspertët e Këshillit të Evropës) nga vetë Administratori Ndërkombëtar, i cili jashtë autoritetit të Senatit, që është organ më i lartë akademik, nëpërmjet të grupeve që ai formoi, promovon inisiativat për hapjen e departamenteve të ndryshme si atë për shkenca politike etj, çështje këto që janë në kompetencë të Senatit, që për këto çështje asnjëherë as që është informuar.

Pengesë tjetër procesit të Universitetit, (e që është marginale) është qasja konservative e disa individëve, të cilël nuk mund të lirohent shpejt nga koncepti vetëqeverisës i Universitetit dhe nga logjika e vjetër socialiste, e cila çdo iniciativë perëndimore dhe evropiane e trajton si të dyshimtë dhe të rrezikshme.

Një qasje e tillë kërkon një proces të ngadalshëm të reformave me hapa të vegjël, thuaje se ne nuk kemi nevojë të ngutem dhe të kërkojmë njohje dhe respekt ndërkombëtar të universitetit tonë, sepse këtë më parë duhet ta bëjnë fqinjët tanë të dikurshëm socialistë. Ne jemi të sigurtë se një vetëdije e këtillë, së shpejti do të kuptohet si e dëmshme dhe e gabur, ndërkaq transparenca e procesit të reformave dhe përfshirja e të gjithëve në këtë proces do të ndihmojë braktisjen e mendësisë së tillë.

Tendencat e cekura ndonëse tentojnë të dëmtojnë procesin e reformave, nuk mund ta ndalin atë. Ne shpresojmë se me një qasje serioze dhe një përkushtim të përbashkët, qysh në fillim të vitit të ri akademik ne do të kemi një projekt të reformave unike në tërë Universitetin, projekt ky i cili do të jetë rezultat i studimeve dhe analizave të gjithanshme profesionale, që së shpejti do të fillojnë në të gjitha strukturat e Universitetit. Nuk duhet patur iluzion se ky proces do të shkojë shpejt dhe lehtë. Ai do të kërkojë kohë dhe do të kërkojë edhe disa veprime të dhëmbshme, por që janë të domosdoshme.

Reforma nuk mund të imponohet-ajo do të akseptohet nga vetë Universiteti

Reformimi i Universitetit është detyrë dhe përgjegjësi e të gjitha subjekteve të Universitetit. Asnjë qasje imponuese nuk bën të lejohet në procesin e reformës. Një tendencë e këtillë as që është e pranishme në Universitet. Përkundrazi, vetë subjektet e Universitetit do të koncipojnë identitetin modern të tij, duke transformuar fakultetet dhe shkollat e larta e instucionet tjera universitare. Së fundi, debati aktual ka për qëllim vetëm përcaktimin e kahjeve të përgjithshme dhe unike të reformës, në të cilat do të inkorporohen subjektet e Universitetit. Pra, janë krejtësisht të pabaza dezinformatat për vendimarrjen e centralizuar universitare (e cila është dominante në shumicën e universiteteve evropiane). Përgjegjësia që ka procesi i reformimit të universitetit, kërkon që ai të reflektojë opinionet burimore të përbërësve konstitutivë të tij, sidomos në këtë fazë tranzicioni. Asnjë fakultet nuk do të detyrohet të reformohet, poqëse vetë nuk shoh interesin e tij. Por, ai vetë duhet të sfidohet me validitetin dhe njohjen e titujve që jep dhe do të marrë përgjegjësinë për këtë.

Reformat në shërbim të studentëve dhe të studimit cilësor

Suksesin e reformave e garantojnë, studentët tanë të cilët tani në mënyrë të qartë janë deklaruar për reforma të shpejta dhe substanciale. Ata kanë të drejtë legjitime të kërkojnë, që njohuritë dhe përgatitja e tyre profesionale dhe shkencore të jetë ekuivalente me kolegët e tyre në universitetet evropiane. Ata kanë të drejtë që sikur edhe kolegët e tyre evropianë në moshë të re (23-26 vjeçare) të fitojnë titujt e magjistratit dhe të doktorit të shkencës dhe të ndalin procesin e plakjes së universitetit dhe praktikën aktuale që këta tituj të fitohen në moshën 50 e madje edhe 60 vjeçare. Pikërisht telentët e rinj dhe studentët e shkëlqyeshëm, që duhet të përfshihen në Universitet, janë e ardhmja e universitetit. Kjo gjeneratë do të futë konkurrencën në mesin e mësimdhënësve, të cilët to të nxiten në ngritjen e tyre të vazhdueshme pedagogjike e shkencore dhe në përcjelljen e të arriturave më të reja shkencore. Pra tani mësimdhënësit nuk do të mund të fshihen pas titujve të fituar akademikë, por do të sfidohen me konkurrencën e vazhdueshme.

Përmisimi pozitës materiale-parakusht për çdo reformë

Reformimi i universitetit, si një projekt shumë serioz, nuk mund të ketë sukses pa përmirësimin e dukshëm të pozitës materiale të mësimdhënësve dhe studentëve. Pagat e tanishme të arsimtarëve, jo vetëm që janë destimuluese, por edhe dekurajojnë përpjekjen për reforma, sepse mësimdhënësitë motivimin për reforma e zëvendësojnë me brengën e mbijetesës fizike. Kjo ndikon edhe në fluksin e një numri të mësimdhënësve, të cilët për shkak të pozitës së vështirë materiale aktualisht punojnë në strukturat ndërkombëtare në OJQ-të dhe në projekte të ndryshme. Për të rikthyer motivimin për reforma, është më se e domosdoshme që krahas implementimit të reformave, që nga fillimi i vitit të ri akademik të ngriten pagat e mësimdhënësve. Kjo vlen edhe për standardin e ultë të studentëve, i cili gjithashtu duhet të përmirësohet dukshëm.

Cilat janë synimet e reformës universitare

Reforma e Universitetit synon integrimin e tij në proceset integrative, duke marrë gjithnjë për bazë kushtet dhe rrethanat objektive në Kosovë. Objektivat kryesore të procesit të reformave janë;

- integrimi i universitetit dhe standarizimi i kritereve të studimeve universitare;
- njohja ndërkombëtare e titujve akademikë;
- levizshmëria, qarkullimi dhe transferi i lirë i studentëve tanë në universitetet evropiane dhe më gjerë;
- reformimi e planprogrameve dhe harmonizimi i tyre me ato të bashkësisë evropiane;
- zbatimi i Sistemit Evropian të Kreditimit për Transfer (sistemit ECTS);
- fleksibiliteti i studimeve dhe ndikimi i studentëve në zgjedhjen dhe përshtatjen e tyre;
- këmbimi i mësimdhënësve dhe përfshirja e tyre në roceset e trajnimit dhe të specializimit ndërkombëtar.

Cilat janë elementet thelbësore të procesit të reformës në Universitet

Duke qenë të kufizuar me hapësirën e këtij shkrimi do të japim elementet e përgjithshme të modelit të reformimit të fakulteteve dhe të shkollave të larta të Universitetit të Prishtinës, të cilin e ka miratuar Senati i Universitetit të Prishtinës. Ky model sigurisht se nuk është i përsosur dhe i përkryer, por jep bazat e përgjithshme mbi të cilat do të mund të ndërtohet një reformë e suksesshme. Ky model aktualisht është dhënë në diskutim publik në të gjitha strukturat e universitetit, të cilat muajin e ardhshëm do të marrin vendim për mundësitë e implementimit të tij, duke filluar që nga viti i ardhshëm akademik;

1. Një koncept i ri modern i qeverisjes së Universitetit. Ky objektiv tanimë është implementuar me Statutin e Përkohshëm të Universitetit, i cili ka braktisur konceptin e vjetër vetëqeverisës të organizimit të Universitetit, duke zbatuar një koncept të ri, sipas të cilit Universiteti është një tërësi unike legale, ku fakultetet janë pjesë organike e tij. Si organe të qeverisjes së universitetit janë: Senati (që është organi më i lartë akademik), Bordi Ekzekutiv dhe Rektori. Zgjedhjet për këto organe tanimë janë kryer dhe ato ishin më demokratike që nga ekzistimi i Universitetit, sepse u bënë me vota të fshehta dhe në lista me më shumë kandidatë, sipas propozimeve që paraprakisht erdhën nga fakultetet. Zgjedhjet u kryen edhe në të gjitha fakultete, ku u zgjodhën dekanët dhe këshillat shkencorë të fakulteteve. Koncepti modern i organizimit të Universitetit së shpejti do të përmbillet me Statutin e ri të Universitetit, i cili do të miratohet gjer me 1 shtator të këtij viti, si dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë, të cilin do ta miratojë Kuvendi i Kosovës, pas zgjedhjeve parlamentare. Me aktet e cekura juridike duhet të sigurohet autonomia e universitetit, që nënkupton pavarësinë e tij të plotë nga politika aktuale e UNMIK-ut dhe nga ekzekutivi i ardhshëm i Kosovës si dhe nga ndikimet e tjera politike;

2. Hartim i planprogrameve të reja do të jetë një nga segmentet kryesore të reformës universitare. Kjo do të kërkojë rishqyrtimin serioz të planprogrameve ekzistuese dhe përshtatjen e tyre me ato të universiteteve evropiane. Një rishqyrtim më serioz është i nevojshëm në shkencat shoqërore, ku duhet të braktisen përmbajtjet ideologjike dhe ato teorike të cilat janë të panevojshme. Së shpejti në këtë drejtim do të kemi një trajnim kushtuar metodologjisë së ndërtimit të planprogrameve mësimore.

Planprogramet e reja mësimore duhet të ngrisin kualitetin e studimeve dhe të mundësojnë fleksibilitetin e tyre, i cili do t'u mundësojë studentëve një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e studimeve të tyre. Planprogramet e reja duhet të përmbajnë lëndët themelore, zgjedhore dhe opcionale. Lëndët themelore, të cilat përmbajnë gjysmën e lëndëve duhet të përfshijnë disiplinat bazike për fushat e studimit. Lëndët zgjedhore janë ato që i zgjedhë studenti nga fusha e ngushtë e specializimit të tyre. Oferta e këtyre lëndëve duhet të jetë shumë e gjerë nga fakultetet, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të gjëra të zgjedhjes së tyre. Kategoria e tretë e lëndëve, janë ato opcionale, e që janë të përbashkëta për të gjitha fakultetet dhe të cilat studenti mund t'i japë në cilindo fakultet të universitetit.

Të gjitha lëndët, të cilat përbëjnë planprogramin mësimor do të ekuivalentohen me numrin e caktuar të kredive, varësisht nga vëllimi i tyre, fondi i orëve dhe semestrat në të cilët mësohen. Një ekuivalentim të tillë të lëndëve me kredi do ta bëjnë komisionet

profesionale në çdo fakultet. Brenda një semestri studenti duhet të tubojë 30 kredi, brenda vitit 60, për të përfunduar studimet bazike 180, ato të magistraturës 300 kredi, kurse për fitimin e titullit të doktorit të shkencës edhe 180 kredi shtesë.

3, Regjimi i ri i studimeve sipas skemave të Deklaratës së Bolonjës bazohet në modelin tanimë të njohur 3 plus 2 plus 3. Ky model njihet tri lloje të studimeve: studimet themelore (bachelor) në kohëzgjatje prej 3 viteve, studimet profesionale (master) në kohëzgjatje prej 2 viteve dhe studimet shkencore profesionale për titullin e doktorit të shkencave në kohëzgjatje prej tri viteve. Ky model i ri, që tani po promovohet si model evropian do të jetë në funksion të njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave dhe titujve akademikë në Evropë. Natyrisht me rastin e zbatimit të këtyre skemave akademike, do të jetë e nevojshme një qasje fleksibile dhe përshtatje specifike të universitetit tonë. Mirëpo është më se e sigurtë se sistemi i tillë do të krijojë mundësi të gjera studentëve për studime universitare dhe arritjen e titujve shkencorë dhe akademikë në një moshë shumë të re. Kjo sidomos do të jetë stimulative për talentët të cilët qysh në moshën 26 vjeçare mund të jenë doktor shkence, në mënyrë që më pastaj të kenë kohë të mjaftueshme për t'u marrë me punë shkencore dhe hulumtime të pavarura;

4. Sistemi i ri i ligjërimit paraqet një segment të ri dhe të domosdoshëm në reformën e një ligjërimit modern, debatues dhe kritik, që ka munguar gjër më tani. Studentët duhet gjatë studimeve, që krahas njohurive teorike të aftësohen në mënyrë praktike për ushtrimin e profesionit menjëherë pas kryerjes së studimeve. Për këtë qëllim planprogrami mësimor për vitet e fundit të studimit duhet të përfshijë kryesisht lëndë praktike, punime seminarike dhe aftësimin praktik për profesione të ngushta brenda fushave të studimit. Një metodë e re e ligjërimit do të mundësojë studime kreative të cilat nënkuptojnë raporte shumë më të afërta midis mësimdhënësve dhe studentëve.

5. Sistemi i ri i të pyeturit të studentëve dhe vlerësimit permanent të njohurive të tyre. Ky segment i reformave nënkupton se që nga 1 tetori të këtij viti në universitetin tonë do të fillojë implementimi i ECTS (Sistemit Evropian të Transferit të Kredive), sistem ky që tani është në zbatim në gati të gjitha universitetet evropiane dhe ato të shteteve në tranzicion. Sipas këtij sistemi studentët do të mbledhin kreditë e nevojshme për të kryer studimet e tyre. Implementimi i këtij sistemi mundëson qarkullimin dhe levizshmërinë e studentëve dhe njohjen e studimeve të tyre në universitetet evropiane. Kjo praktikisht do të dukej kështu: psh. një student i vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, do të mund të vazhdojë vitin e katërt në Londër, Paris, Vjenë ose gjetiu, të mbledhë atje numrin e caktuar të kredive dhe sërish të kthehet në Prishtinë, të vazhdojë vitin e pestë dhe të përfundojë studimet. S'ka dyshim se parakusht për këtë është pranimi formal i Universitetit tonë në ECTS (kërkesa formale dhe dokumentacioni përkatës së shpejti do të dërgohen) dhe përshtatja e planprogrameve dhe regjimit të studimeve sipas standardeve evropiane.

Sistemi i ri i të pyeturit do të kërkojë një vlerësim permanent të njohurive të studentëve gjatë tërë vitit akademik. Kjo do të thotë se do të braktiset sistemi aktual i të pyeturit me tri pyetje dhe do të zëvendësohet me testime së paku tri herë gjatë vitit. Kjo do të stimulojë punën kontinuele të studentëve, të cilët do të mundën që provimin në një lëndë ta japin suksesivisht përmes testeve verifikuese në dy semestra. Një metodë e kështillë do t'i japë fund metodës së dhënies së provimeve në formë të kampanjës dhe do të lehtësojë dukshëm dhënien e provimeve nga studentët. Me të filluar të vitit të ardhshëm akademik, do të fillojë zbatimi i Rregullores së Universitetit, e cila në mënyrë unike do të

rregullojë mënyrën e dhënies së provimeve, numrin e nevojshëm të provimeve (kredive) për fitimin e kushtit për regjistrimin e vitit, rastet kur studenti humb vitin si dhe çështjet e tjera me rëndësi për studentët.

6. Trajnimi i mësimdhënësve dhe specializimi i tyre në botën e jashtme do të ndihmojë reformimin e universitetit, duke përgatitur mësimdhënësit për hartimin e planprogrameve të reja dhe avansimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve. Për këtë qëllim, që tani ka filluar trajnimi i Senatit dhe Bordit të Universitetit për rolin e tyre akademik dhe menagjimin e universitetit. Senati, gati në përbërje të plotë në organizim të Konferencës së Rektorëve Evropianë ka vizituar disa universitete ndërkombëtare dhe ka bërë trajnime akademike. Takimet e tilla do të vazhdojnë dhe do të përfshijnë edhe udhëheqjet e fakulteteve. Po ashtu universiteti, ka arritur marrëveshjet me disa universitete për këmbimin e kuadrave dhe për specializimin e tyre në botën e jashtme. Në këtë drejtim tani do të finalizohen marrëveshjet me Universitetin e Arizonës në SHBA, ku për 3 vitet e ardhshme do të dërgohen 24 mësimdhënës të universitetit tonë për qëndrim njësemestral. Përparësi në këto projekte do të kenë asistentët e rinj dhe kuadrat e reja që së shpejti do të pranohen në Universitet. Edhe fakultetet tanimë kanë vënë kontakte dhe kanë gjetur partnerë bashkëpunimi në projektet e ndryshme shkencore. Aktivitetet e tilla duhet të jenë në funksion të akseptimit të përvojave ndërkombëtare të cilat pastaj do të implementohen gjatë reformimit të universitetit.

7. Sigurimi i literaturës bashkëkohore është parakusht tjetër për suksesin e reformave në universitet. Për këtë qëllim duhet të stimulohen mësimdhënësit për hartimin e teksteve universitare në gjuhën shqipe. Në disiplinat shoqërore duhet të braktiset litaratura e vjetër e cila ka përmbajtje ideologjike. Po ashtu, do të ndërpritet praktika e disa profesorëve të cilët studentëve u kanë imponuar si literaturë vetëm tekstin e tyre. Studentët duhet të udhëzohen për përdorimin e litaraturës së huaj, sidomos asaj në gjuhën angleze, kurse universiteti do të bëjë përpjekje që tekstet të cilat mësohen në shumicën e universiteteve ndërkombëtare të përkthehen në gjuhën shqipe dhe t'u preferohen studentëve.

Një ndihmesë të veçantë në sigurimin e literaturës bashkëkohore paraqet këmbimi elektronik përmes internetit, që tanimë po instalohet në shumicën e fakulteteve tona.

Në lëmin e veprimtarisë shkencore do të stimulohet pjesëmarrja e universitetit dhe mësimdhënësve tanë në tubime ndërkombëtare shkencore; projektet shkencore; nxerrja e revistave dhe e botimeve të tjera si dhe format tjera të veprimtarisë shkencore.

8. Plani strategjik i zhvillimit të Universitetit-paraqet një objektiv tjetër të zhvillimit të universitetit, që synon një vizion afatgjatë zhvillimor dhe objektivat që synohen në dhjetëvjeçarin e ardhshëm. Ky proces është filluar dhe në bashkëpunim me Shoqatën e Universiteteve Evropiane pritet finalizimi i këtij projekti.

P ë r f u n d i m

Refomat në Universitetin e Prishtinës paraqesin një proces afatgjatë dhe kompleks, që do të ndihmojnë integrimin e tij në universitetet evropiane. Qëllimi kryesor i reformave do të jetë krijimi i një identiteti të ri dhe të pranuar ndërkombëtar. Një proces i këtillë pashmangshëm duhet të merr parasysh specifikat e Kosovës dhe t'i përshtatet atyre. Kjo kërkon, që në fazën e parë të integritimit në standardet evropiane, reforma të

ketë fleksibilitet të mjaftushëm, i cili do të ndihmojë kalimin e fazës së tranzicionit me sa më pak pasoja.

Duke pasur për bazë se Kosova aktualisht ka vetëm një Universitet, në procesin e reformimit të tij duhet shmangur të gjitha veprimet eksperimentale dhe të paverifikuara të cilat nuk do të marrin parasysh kontinuitetin dhe praktikatat pozitive, të cilat Universiteti i Prishtinës i ka krijuar gjatë veprimit të tij tridhjetëvjeçar.

Mirëpo, nevoja për hapa të kujdesshëm në reformimin e universitetit nuk do të thotë ngadalësimin e tyre. Koha për reforma në universitet është që tani dhe ne kemi rastin që duke shfrytëzuar fondet ndërkombëtare të shpejtojmë integrimin tonë në standardet evropiane universitare. Së fundi për këtë kemi një vullnet të fuqishëm të mësimdhënësve, studentëve dhe subjekteve tjera të universitetit. Tanimë të gjithë duhet ta kemi të qartë, se megjithë ndihmën që mund ta japin autoritet ndërkombëtare, reformimi i Universitetit të Prishtinës është detyrë e jona.

REFORMA NË SHKENCAT E NATYRËS

Si çështje të parë unë dua të elaboroj pyetjen:
Ishin apo jo të nevojshme reformat në Universitetin e Prishtinës?

Dhjetë vjet të periudhës së tranzicionit, për arsye se ndodheshim në kushte të një shtettrrethimi të egër, UP mbijetoi, por nuk kishte kushte për reforma studimore. Kur merret parasysh se edhe në dekadën e para tranzicionit nuk kemi bërë ndonjë reformë të mirëfilltë, atëherë rrjedh se pas kthimit në objektet universitare u ndodhëm në situatë në të cilën reformat jo që ishin të nevojshme por të domosdoshme.

Konstatimi:

Reforma po, por çfarë reformash? Dhe kur?.

Në një pjesë të kuadrit universitar ishte i pranishëm mendimi se ndoshta është mirë që në kohën e kontakteve me Konferencën e Rektorëve të Universitetit të Evropës të fillohet me reformat në UP. Ky asociacion jo vetëm që rekomandonte reforma, or edhe premtonte ndihmë për aplikimin e tyre, mendoj që sugjeroi modelin e Bolonjës. Shumica e institucioneve të arsimit të lartë të Universitetit të Prishtinës e pranoi me bindje se: 1.

1 Marrëveshja parimore e Bolonjës është duke u zbatuar ose do të zbatohet edhe në universitetet evropiane, dhe

2. Mbështetja materiale do të jetë e mjaftueshme.

Asnjëra prej tyre nuk na dolën me parashikime të sakëta.

Përcaktimi për reforma sipas modelit të Bolonjës në FSHMN nuk është pranuar lehtë dhe pa vërejtje, mirëpo është pranuar nga shumica. Hartimit të plan-programeve iu çasëm me përgjegjësi maksimale. Në përpjekjet që të konsultohen sa më shumë programe studimore të universiteteve evropiane dhe të SHBA-së u përballëm me faktin se modeli i Bolonjës nuk aplikohet në Universitetet më të njohura, por vetëm në një numër shumë të kufizuar universitetesh, kryesisht të vendeve skandinave. Në universitetet tjera është në nivelin e idesë, përkatësisht të mundësisë eventuale për aplikim deri më 2010.

Kështu, krejt pa prituri na ndodhi që ne të jemi në radhën e universiteteve të pakëta që filluan aplikimin e modelit të Bolonjës. Mundësitë për zgjedhjen e ndonjë programi që kishte kaluar fazën e verifikimit ishin minimale. Me gjithë atë vazhduam me hartimin e programeve studimore duke iu përmbajtur parimeve themelore. U parashtuan qëllimet dhe objektivat që duhet arritur dhe iu përveshëm punës:

1. Ngritja e cilësisë së studimeve
2. Rritja e efikasitetit
3. Programet kompatible me ato të universiteteve evropiane
4. Aplikimi i punës praktike
5. Zvogëlimi i lëndëve përkatësisht orëve mësimore gjatë javës
6. Ligjërata në formë debati
7. Vlerësimi dhe notimi i njohurive nëpërmjet testeve
8. Organizimi i seminareve.

Natyrishit në këtë proces kishte edhe mangësi. Pengesë më e theksuar gjatë hartimit të planeve ishte dukuria e insistimit të mësimdhënësve se lënda e çdonjërit ishte përmbajtje qenësore për studimet e degës përkatëse ose së paku shumë me rëndësi. Kuptohet kjo çastje ka pasë edhe efektin e vet, në një farë mase është reflektuar në numër jo optimal të lëndëve mësimore, por vetëm në disa drejtime, përkatësisht semestra të studimeve. Mirëpo, reforma është proces dhe këto dobësi mund të eliminohen me ndryshime të reja. Qenësore është se ne kemi marrë obligim për reforma dhe detyrë e jona është që procesi të vazhdohet në drejtim të përsosjes.

Në FSHMN bëhet përpjekje që objektivat e parashturara të përmbushen. Kuptohet diku më mirë e diku më dobët, por me rëndësi është që obligimet e zbatimit janë pranuar si detyra të punës. Në zbatimin efikas të programeve të reformuara ka edhe disa pengesa të natyrës objektive.

- Botimet uiniversitare nuk financohen nga askush.
- Mungon literatura themelore dhe ajo përcjellëse.
- Mungojnë pajisjet përkatëse për zbatimin e metodave bashkëkohore të ligjërimit (projektorë, grafoskopë, kompjuterë, skenerë, etj).
- Mungojnë revistat e botimeve periodike shkencore
- Për shkak të mungesës së pajisjes laboratorike nuk mund të ushtrohet pjesa praktike e programit studimor.

Pengesë e konsiderueshme për zbatimin e programeve të projektuara janë edhe kushtet e vështira të jetës studentore.

- një pjesë e konsiderueshme e tyre udhëtojnë
- të pakëta janë vendet në sallat e leximit
- mungon literatura adekuate
- mundësitë shumë të kufizuara për çasje në internet etj.

Nuk dua të keqkuptohem. Evidentimi i pengesave të numruara nuk do të thotë se programet nuk realizohen, por realizohen në përmasa më të vogla se parashikimet. Të mos harraohet se këto pengesa do të qëndronin për programet e pareformuara.

Me të drejtë është pritur që, pas procesit të reformimit të kemi mbështetje shumë më të madhe materiale, me gjithë që nuk mund të thuhet se ka munguar përkrahja në pajisje me teknikë. Nga ky vend e ndiej të nevojshme të deklaroj se FSHMN ka shfrytëzuar një pjesë të përkrahjes materiale. Për pajisjen e laboratoreve tona me mjete për ushtrime praktike të studentëve dhe hulumtimeve shkencore në dy vitet e fundit janë investuar gati një milion euro. Pjesa më e madhe e tyre janë nga një donacion i Qeverisë Gjermane por janë edhe mjete të Rektoratit. Ju siguroj se këto janë investime të mira dhe të qëlluara dhe se pajisja do të shfrytëzohet në laboratorët përkatëse të FSHMN-së për punë praktike me studentë, për punime të magjistraturës e doktoratave.

Tani jemi në fazën e implementimit të reformës dhe për mendimin tim janë të tepërta dhe pa kurrfarë dobie debatimet se a është dashur apo jo të hyjmë në reforma. Asnjë njeri nuk kam dëgjuar të deklarojë se kemi bërë reforma të përkryera dhe është vënë pikë në këtë drejtim. Reforma është process, andaj ka vend që programet gjithnjë të përmirësohen. Nuk është mirë që të barikadohemi në pozita të kritizërëve, pa bërë asnjë përpjekje për të ndryshuar në kuptimin pozitiv.

Në studimet e shkencave të natyrës nuk ka pasë përmbajtje të natyrës ideologjike, për të cilat reforma ka qenë e domosdoshme, por ka pasë bariera teknologjike. në laboratorët tona, ka pasur shumë pajisje të vjeturuar dhe të amortizuar.

KONSTATIME:

Nga informacionet me të cilat unë disponoj në këtë fazë të zbatimit të programeve të reformuara konstatojmë:

- studentët e përkrahin vlerësimin dhe notimin me teste,
- provimet semestrale,
- zvogëlimin e orëve mësimore në javë
- lëndët zgjedhore,
- punën praktike.

Mirëpo nuk janë të përgatitur për pjesëmarrje në ligjërata debatuese.

Arsimtarët deklarojnë se angazhimi i tyre është shumëfishuar, por notimi është më i lehtë dhe kalueshmëria më e mirë.

Si rezultat i reformave janë formuar 3 – drejtime të reja studimore, për të cilat është treguar interesim i madh përsëri regjistrim. Një konstatim tjetër është edhe fakti se shumë më i madh është interesimi për drejtimet aplikative se sa për ato arsimore (5:1)

Nuk mund të thuhet me siguri se a është rezultat i pozitës së dobët të punëtorëve arsimorë, apo rezultat i programit atraktiv në drejtimet aplikative.

Dhe krejt në fund unë mendoj, defekti më i madh i kësaj reforme është se mësimdhënësit nuk shpërblehen në përpjestim me vëllimin e punës. Në kushte të këtilla mund të ketë edhe programe të shkëlqyeshme, por me paga çfarë janë tani, nuk është reale të pritët një ndryshim i theksuar në cilësi dhe efikasitet.

Prof. Dr. Musli BAJRAKTARI

FINANCIMI DHE MENAXHIMI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS (HISTORIK I SHKURTËR I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS)

Universiteti i Prishtinës u themelua më 15 shkurt 1970.

Rektori i parë u zgjodh Prof.Dr.Dervish Rozhaja.

Bazat e Universitetit të Prishtinës i kishin krijuar Fakulteti Filozofik me grupin e shkencave të filologjisë dhe me grupin e shkencave matematike- natyrore, Fakulteti Juridik-Ekonomik, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Mjekësisë, si dhe 8 shkolla të larta.

Pas një qerek shekulli pune Universiteti i Prishtinës përfshinte 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta

Nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës kanë dalë më tepër se 65.000 studentë të diplomuar, prej tyre më tepër se 42000 shqiptarë, dhe janë mbrojtur mbi 480 disertacione. .

Pas lëvizjes studentore në pranverën e vitit 1981, kundër studentëve dhe popullit, pushteti Jugosllav mori masat më barbare.

U larguan nga procesi mësimor 18 profesorë

Numri i studentëve shqiptarë u zvoglua për masë 25 %.

Më 27 qeshor të vitit 1990 u ndalua përfundimisht mësimi në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës. U përjashtuan të gjithë studentët dhe mësimdhënësit nga lokalet mësimre

Më 1 tetor 1991 Fondi Krahinor për arsimin e lartë në Kosovë ndërpreu financimin e mësimin shqip në të gjitha fakultetet e shkollat e lara.

Në këto rrethana më 26.11.1991 u mbajt një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të Universitetit të Prishtinës, dhe vendosi rifillimin e mësimin jashtë lokaleve të pushtuara nga policia serbe dhe u zgjodh rektori i ri, Prof.Dr.Ejup Statovci.

Mbledhja e parë e Kuvendit të ri të Universitetit të Prishtinës u mbajt më 10 dhjetor 1991 në Institutin Albanologjik të Prishtinës

Mësimi u ndërpre për shkak të luftës me 21 Mars 1999.

Pas luftës, mësimi rifilloi më 2 gusht 1999.

1.FINANCIMI DHE MENAXHIMI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Për kryerjen e veprimtarisë së vet Universiteti i Prishtinës siguron mjete financiare nga këto burime:

- fondet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nga buxheti i Kosovës për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm,
- tarifat e shkollimit, tarifat administrative dhe pagesa të tjera që bëjnë studentët,
- pagesat për sërtime komerciale dhe shërbime të tjera,
- donacionet, dhuratat dhe ndihmat,

-Kontrata me organizma kombëtare, ndërkombëtare, publike ose private në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të konsulencës.

Mjetet e fondit të Ministrisë nga buxheti i Kosovës dedikohen për:

- pagat dhe medijtjet e të punësuarëve në Universitet
- shërbime, punë dhe mallra,
- investime kapitale

Mjetet e tarifave të shkollimit, tarifave administrative dhe pagesat të tjera që bëjnë studentët, të cilët studiojnë në Univeritetin e Prishtinës shfrytëzohen për tri qëllime kryesore:

- përfitime për studentët të cilët meritojnë
- përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe të kushteve të punës (aspekti tekniko teknologjik) në Unversitet
- përmirësimi i përfitimeve të të punësuarëve dhe aktiviteteve të studentëve

Mjetet të cilat realizohen nga kontratat me organizata kombëtare, ndërkombëtare, publike ose private në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo konsulencës shfrytëzohen për:

- pajisje laboratorike për hulumtime shkencore dhe profesinale
- për pranimin e asistentëve shkencorë
- për punëkryesit e drejtpërdrejtë të realizimit të kontratave
- qëllimet e tjera
-

Universiteti i Prishtinës si bartës publik i arsimit të lartë ka individualitet të plotë ligjor lidhur me këto çështje:

a.për të marrë dhe administruar fonde nga çdo lloj burimi i ligjshëm

b.për të zotuar dhe administruar troje

c.për të përcaktuar dhe për të marrë pagesa për regjistrim

d.për të punësuar personelin

e.për të bër kontrata për mallra dhe shërbime

f.për të vendour marrëdhënie ligjore me studentët.

g.për të ngritur ndërmarrje financiare për qëllime mësimore dhe hulumtuese

Universiteti i Prishtinës, si bartës publik i arsimit të lartë gëzon të drejtën të lidhë kontrata për çfarëdo qëllimi që lidhet me arsimin e lartë dhe, në rastin e universiteteve, për kërkime shkencore. Universiteti mund t'i investojë fondet, me përjashtim të fondeve publike, në projekte për qëllime mësimore e kërkimore, me kusht që:

a) asnjë kontratë nuk duhet të imponojë ndonjë detyrim financiar ndaj rasteve publike pa miratimin e Ministrisë: dhe

b) fondet publike nuk duhet të rrezikohen.

Metodologjia e financimit

Ministria përcakton metodologjinë që duhet zbatuar për caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm.

Caktimi i fondeve për mësimdhënie mund të specifikojë numrin e studentëve që do të arsimohen me shpenzime publike në disiplina e fusha të veçanta studimi. Ky numër duhet të jetë në përputhje me numrin maksimal të specifikuar në licencën aktuale të bartësit.

Në caktimin e fondeve të Universitetit të Prishtinës, Ministria merr parasyshë çdo vërejtje dhe rekomandim të bërë nga AAK lidhur me cilësinë e procesit mësimor të këtyre bartësve ose të kurseve apo të programeve të veçanta.

Fondet caktohen si një shumë, që i jepet Universitetit gjatë vitit financiar në intervale kohe të përcaktuara nga Ministria. Brenda kufinjve të caktuar në licencë dhe sipas kushteve që kanë të bëjnë me fondet nga Ministria, Bordi i Universitetit të Prishtinës gëzon të drejtën t'i përdorë fondet që i janë akorduar sipas dëshirës së vet dhe duhet t'i japë llogari Ministrisë për to.

Kushtet e financimit

Kushtet e financimit, të cilat duhet të plotësohen, duhet të jenë në përputhje me kërkesat që kanë të bëjnë me:

- kontrollin financiar dhe revizionimin
- blerjen, shrytëzimin dhe disponimin me truall, godina dhe pajisje
- nivelin dhe zbatueshmërinë e tarifave shkollore dhe pagesa të tjera të studentëve:
- ndryshimin e destinacionit ose transferimin e fondeve të caktuara për mësimdhënie nga një fushë mësimore në tjetrën.

Ministria nuk imponon asnjë kusht që do të mund të ndikonte në kufizimin e mundësisë së Universitetit për të vepruar, në përputhje me statutin e tij, për të tërhequr fonde nga burime të tjera, përfshirë këtu caktimin e vendeve shtesë të studentëve brenda kufinjve të licencës, me kusht që, sipas mendimit të Ministrisë, kjo nuk ka:

- efekt negativ në cilësinë e arsimit me fonde publike,
- nuk paragjykon detyrën e bartësit për të ushtruar veprimtarinë e tij pa asnjë lloj diskriminimi për arsye që kanë lidhje me gjininë, racën, prirje seksuale, gjendjen civile, ngjyrën, fenë, opinionet politike apo tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj komunitetit kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo rrethanat e tjera.

Fondet që mbetën pa u shpenzuar në fund të vitit financiar dhe nuk janë caktuar për të kaluar në fondin rezervë për veprimtari të miratuara, i kthehen Ministrisë, nëse ajo nuk përcakton drjetimin tjetër

Konrolli financiar

Bordi cakton auditorë të pavarur që ta sigurojnë atë një herë në vit për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve dhe për shmangiet nga keqpërdorimet: auditorët i lëshojnë Bordit certifikatë për këte. Auditorët gjithashtu do të raportojnë, sa herë që kërkohet nga Bordi, mbi masat adekuate të kontrollit financiar në Universitet, mbi shfrytëzimin efektiv të mjeteve, mbi shumën e të hollave, ose do ta studiojë posaçërisht gjendjen në cilindo fakultet, shërbim ose njësi administrative

Auditorët e emëruar nuk do të kenë asnjë marrëdhënie të drejtëpërdrejtë personale ose profesionale me asnjë anëtar të Bordit ose të Senatit.


Ministria mund të caktojë një revizor të pavarur për të hetuar çështjet financiare të çdo institucioni publik të arsimit të lartë dhe Këshilli i Drejtuesve të këtij institucioni duhet të sigurojë bashkëpunimin me revizorin.

Veprimtaria fitimprurëse


Universiteti i Prishtinës gëzon të drejtën që, në përputhje me dispozitat ligjore, dhe të licencës së tij, të marrë masa për të nxitur e shfrytëzuar veprimtarinë e tij arsimore dhe në rastin e universiteteve, të veprimtarisë kërkimore për qëllime fitimprurëse në favor të bartësit.

Kur veprimtari të tilla financiare përfshijnë ose potencialisht mund të përfshijnë shfrytëzimin e ndonjë të drejte të rëndësishme, të pasurisë intelektuale lidhur me vepra letrare, artistike dhe shkencore, zbulime shkencore, projekte, shpikje amteriale, mallra ose shërbime të siguruara plotësisht apo pjesërisht duke përdorur fonde publike, bartësi duhet të kërkojë miratim paraprak nga Ministria. Për qëllimet e këtij neni Ministria përcakton se cila është e drejta e rëndësishme e një pasurie intelektuale.


SKEMA ORGANIZATIVE E SHËRBIMIT FINANCIAR TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS



SKEMA ORGANIZATIVE E SHËRBIMIT TË FINANCANE NË FAKULTETE DHE SHKOLLA TË LARTA



SKEMA E PROCEDURËS DHE DOKUMENTACIONI PËR PROKURIM



PUNA SHENCORE HULUMTUESE DHE PROFESIONALE

Në kuadër të Fakultetit apo të Institutit të Fakultetit, mësimdhënësit, bashkëpunorët , puntorët e tjerë të Fakultetit dhe ekspertët jashtë Fakultetit mund të merren me punë shkencore, hulumtuese dhe profesionale nga veprimtaria e Fakultetit apo e Institutit .

Punët me të cilat puntorët e Fakultetit mund të merren në kuadër të veprimtarisë shkencore, hulumtuese dhe profesionale janë:

- projekte shkencore hulumtuese
- projekte profesionale (ideore, kryesore dhe të realizimit)
- Analiza profesionale
- Atestime
- Kontrollime të ndryshme me qëllim të dhënies së certifikatave
- Llogaritje, matje , kontrollime , hulumtime etj
- Kryerje të revizioneve dhe recensioneve
- Hulumtime laboratorike
- Kryerje të prototipeve
- Mbikëqyrje të objekteve
- Kurse të ndryshme profesionale

Pos veprimtarisë paraprake, punëtorët e Fakultetit mund të merren edhe me veprimtari të tjera për të cilat tregohet nevoja dhe ka kuadër adekuat.

Sejçili punëtor i Fakultetit me pëlqimin paraprak të Dekanit të Fakultetit ose udhëheqësit të Institutit- prodekanit për financa, ka të drejtë të bëjë kontakte afariste me ndërmarrje dhe afaristë për kontraktimin e punëve nga lëmia e Institutit.

Pas arritjes së marrëveshjes për kontraktimin e punëve, punëtori e njofton Dekanin ose udhëheqësin e Institutit, i cili në bazë të të dhënave për marrëveshjen e arritur për kontraktimin e punëve, nënshkruan kontratën e cila duhet të përmbajë të gjitha elementet e nevojshme, posaçërisht përcaktimin preciz të punëve dhe të detyrave të punës të cilat janë lëndë e kontratës, vlera kontraktuese dhe afati brenda të cilit duhet kryer punë.

Para se të lidhet kontrata nga pika paraprake, udhëheqësi i Institutit me pëlqimin e Dekanit e cakton bartësin e punës dhe kryesit e tjerë të punëve, duke marrë si kriter themelor: mendimin e kontraktuesit afarist të punëve, kompetencat profesionale e shkencore të kryesve të punëve si dhe mendimin e porositësit të punëve.

Nëse vlerësohet se vlera e punëve të kontraktuara është e lartë, në atë punë, bëhet përfshirja e një numri më të madh të personelit adekuat, i cili në momentin e caktuar është i pa- agazhuar ose më pak i angazhuar.

Pagesa e punëve të kontraktuara bëhet në llogarinë rrjedhëse të Rektoratit me destinacion për Fakultetin apo Institutin e Fakultetit.

Nese vlera e kontraktuar është më e vogël se 300 euro (10 pikë llogaritëse të pagave mujore), pagesa bëhet në arkën e Fakultetit, gjegjësisht Institutit.

Shpërndarja e mjeteve bëhet nga fitimi për ndarje :

$$F=K-SHD$$

K -shuma e kontraktuar e punëve

SHD -shpenzimet direkte të krijuara gjatë punëve (shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet për blerjen e pajisjeve të nevojshme për realizimin e punëve, materiali harxhues etj).

Fitimi F i realizuar nga palët e treta ndahet sipas këtij çelësi:

10% mbasin ë llogarinë e Universitetit : $U=0.1 F$

90% mbasin në konton e fakultetit: $KFA=0.9 F$

Mjetet të cilat mbasin në fakultet FA ndahen sipas këtij çelësi:

-Nëse shërbimet kryhen pa laborator

10% mbasin në fakultet $FA=0.1$ $KFA=0.09F$

90% mbasin për punëkryesit direkt $PD=0.9$ $KFA=0.81 F$

-Nëse shërbimet kryhen me laborator

20% mbasin në fakultet $FA=0.2$ $KFA=0.18 F$

80% mbasin për punëkryesit direkt $PD=0.72 F$

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

ROLI DHE RENDËSIA

HISTORIK I SHKURTËR

Universiteti i Prishtinës u themelua më 15 shkurt 1970.

Rektori i parë u zgjodh Prof.dr. Dervish Rozhaja.

Bazat e Universitetit të Prishtinës i kishin Fakulteti Filozofik me grupin e shkencave të filologjisë dhe grupin e shkencave matematike- natyrore, Fakulteti Juridik-Ekonomik, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Mjekësisë, si dhe 8 Shkolla të larta.

Pas një qerek shekulli pune Universiteti i Prishtinës përfshin 15 fakultete dhe 7 shkolla të larta

Nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës kanë dalë më tepër se 65.000 të diplomuar, prej tyre më tepër se 42000 shqiptarë, dhe janë mbrojtur mbi 510 disertacione. .

Pas lëvizjes studentore në pranverën e vitit 1981, kundër studentëve dhe popullit, pushteti jugosllav mori masat më barbare.

U larguan nga procesi mësimor 18 profesorë në diferencimin e parë.

Numri i studentëve shqiptarë u zvoglua për masë 25 %.

Më 27 qeshor të vitit 1990 u ndalua përfundimisht mësimi në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës. U përjashtuan gjithë studentët dhe mësimdhënësit nga lokalet mësimore .

Më 1 tetor 1991 Fondi Krahinor për mësimin e lartë në Kosovë ndërpreu financimin e mësimin shqip në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta.

Në këto rrethana më 26.11.1991 u mbajt një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të Universitetit të Prishtinës, dhe u vendos për rifillimin e mësimave jashtë lokaleve të pushtuara nga policia serbe dhe u zgjodh rektori i ri, Prof. dr. Ejup Statovci.

Mbledhja e parë e Kuvendit të ri të Universitetit të Prishtinës u mbajt më 10 dhjetor 1991 në Institutin Albanologjik.

Mësimi në objekte private vazhdoi të mbahet deri me lirin e objektit të Fakultetit Teknik.

Mësimi u ndërpre për shkak të luftës më 21 Mars 1999.

Pas luftës, mësimi rifilloi me 2 gusht 1999.

THEMELIMI I FAKULTETEVE

DHE I SHKOLLAVE TË LARTA

Shkolla e parë e lartë: Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë në vitin 1958

Shkolla e dytë e lartë : Shkolla e Lartë Administrative në Prishtinë, në vitin 1959/60 e cila më pas shërbeu si mbështetje për hapjen e Fakultetit Juridik. **Fakulteti i parë në Kosovë:** Fakulteti Filozofik në Prishtinë në vitin 1960. Në fillim pranë këtij fakulteti kanë qenë dy degë dhe grupi i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, më pas u hapën edhe 7 degë të reja..

Shkollat e larta dhe fakultetet e tjera:

Shkolla e Lartë Ekonomike-Komerciale në Pejë, më 10 tetor të vitit 1960.

Shkolla e Lartë e Bujqësisë në Prishtinë në vitin shkollor 1960/61. Mbi bazën e kësaj shkolle më vonë u themelua Fakulteti i Bujqësisë në Prishtinë.

Shkolla e Lartë Teknike në Prishtinë në vitin shkollor 1961/62 me dy degë. Mbi bazën e kësaj shkolle më vonë u themelua Fakulteti Teknik në Prishtinë.

Fakulteti Juridiko –Ekonomik në Prishtinë me 7 tetor 1961 me dy seksione : atë Juridik dhe Ekonomik. Më vonë këto dy fakultete u ndanë.

Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë në vitin shkollor 1961/62

Shkolla e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” në Prizren, në dhjetor të vitit 1962.

Fakulteti Teknik në Prishtinë, mbi bazën e Shkollës së Lartë Teknike në Prishtinë në vitin shkollor 1964/65.

Shkolla e Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë më 1 tetor 1967.

Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë më 17 shtator 1970 . Më 1975 u hap edhe dega e stomatologjike. Hapja e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë pati një rëndësi të veçantë, sepse me këtë u plotësua kushtet për themelimin e Universitetit të Prishtinës

Fakulteti i Shkencave Matematike- Natyrore në Prishtinë u nda nga Fakulteti i Filozofisë në vitin 1971

Fakulteti Juridik në Prishtinë në vitin 1971/72 u nda nga Fakulteti Juridik-Ekonomik.

Fakulteti Ekonomik në Prishtinë në vitin shkollor 1988/89 .

Fakulteti i Arteve në Prishtinë. Akademia e Arteve më 25 dhjetor 1973. Në vitin shkollor 1975/76 u hap edhe Seksioni i Muzikës.

Fakulteti i Bujqësisë në Prishtinë në vitin shkollor 1973/74

Fakulteti i Xehëtarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë më 1974 me tre seksione.

Shkolla e Lartë Pedagogjike “Skenderbeu” në Gjilan më 25 shtator 1975.

Shkolla e Lartë Teknike (Qendra për Arsimin e Lartë) në Ferizaj filloi punën më 1 dhjetor 1976 me 309 studentë në dy gjuhët. Më 1988/89 u regjistruan 1398 studentë, 1161 për mësim në gjuhën shqipe, kurse në vitin shkollor 1994/95 u regjistruan 211 studentë dhe u diplomuan 30 studentë.

Fakulteti i Kulturës Fizike në Prishtinë filloi punën në vitin shkollor 1979/80 me 115 studentë, 88 për mësim në gjuhën shqipe. Në vitin shkollor 1988/9 kishte 415 studentë. Mësimi ka qenë i zhvilluar në dy shkallë. Gjatë viteve shkollore 1992-1995 numri studentëve u zvogëlua 4 herë kundrejt 1990/91. Janë diplomuar gjithësej 368 studentë, prej tyre 168 shqiptarë.

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë më 1 tetor 1988

Fakulteti i Elektroteknikës në Prishtinë më 1 tetor 1988

Fakulteti i Makinerisë në Prishtinë më 1 tetor 1988

Fakulteti i Filologjisë në Prishtinë u veçua nga Fakulteti Filozofik, Grupi i shkencave Filologjike në vitin 1988 duke iu shtuar edhe Grupi i Gjuhës dhe Letërsisë Turke.

FAZAT E RRITËS DHE E ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT

Faza e ndërtimit dhe e sigurimit të kaudrave

Për një kohë relativisht të shkurtër arriti që të konsolidohet, ndërtoi strukturën e plotë të tij dhe siguroi kuadra të afta dhe të mjaftueshme për mbajtjen e mësimi në gjuhën shqipe.

Faza e mbijetësës

Pas lëvizjes studentore në pranverën e vitit 1981, filloi fushata e egër kundër Universitetit të Prishtinës. Me 27 qershor të vitit 1991 u ndalua përfundimisht mësimi në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës. Në këto rrethana, më 26.10.1991 u mbajt mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Universitetit dhe vendosi rifillimin e mësimave jashtëlokaleve – në shtëpi shkolla

Faza e pasluftës

Universiteti i Prishtinës ndërpreu mësimin më 21 Mars 1999 për shkak të rrezikimit të studentëve nga forcat paramilitare serbe në prag të bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavinë. Pastaj pasoi largimi me dhunë i popullatës dhe dëportimi në shtetet jashtë Kosovës. Këtë fat e përjetuan edhe 15.814 studentë sa ishin duke ndjekur studimet dhe 1111 punëtorë universitarë, në mardhënie të rregullt pune dhe 486 punëtorë universitarë në mardhënie plotësuese pune.

Pas përfundimit të luftës, me 10 Qershor 1999 filloi të kthehet popullata e së bashku me të edhe studentët dhe arsimtarët.

Rektorati, Këshilli i Universitetit dhe Senati i Universitetit analizoi gjendjen pas luftës dhe vendosi:

- të kompenzojë mësimin e humbur në të gjitha nivelet e arsimit
- të bëjë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor

Kompenzimi i mësimi në fakultete u bë nga 2 gushti gjer më 15 tetor. Pasaj u bë regjistrimi i studentëve dhe filloi mësimi në Universitet

Në këtë periudhë të pasluftës Universiteti i Prishtinës u ballafaqua me një numër të madh problemesh:

- objektet e dëmtuara , të demoluara e të plaçkitura
- mungesa e mjeteve financiare
- sigurimi i mjeteve dhe teksteve mësimore

- ngrohja dhe mirëmbajtja e objekteve
- ndarja e objekteve mësimore në Mitrovicë
- inkorporimi në proceset e përgjithshme shoqërore dhe përgatitjet për reforma.

Faza e reformave

Tani jemi në fazën e dytë të reformave (fazën e implementimit të reformave) sipas Deklaratës së Bolonjës. Janë aprovuar planprogramet mësimore sipas sitemit 3+2+3 (Bachelor+Master+Doktor) dhe viti shkollor 2001/2002 ka startuar me këtë sistem.

PARIMI , MISIONI , FUNKSIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT

PARIMET THEMELORE

-Deklarata univerzale mbi ë drejta e njeriut (“ Çdo njeri ka të drejtë në shkollim.... arsimimi i lartë duhet t’i jetë mundësuar çdo njeriu në bazë të kapaciteteve individuale”)

-Rekomandimet e Komisioneve Ndërkombëtare dhe Konferencave lidhur me arsimimin dhe shkollimin.

-Mendimi i gjithëpranuar se arsimimi është prioriteti i parë në shoqëri në shekullin XXI, pa të cilin nuk ka zhvillim as ardhmëri

-Demosdoshmeria e kooperimit dhe koordinimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm të sistemit të arsimimit

-Vizioni i shoqërisë në të ardhmen varet nga zgjidhja e problemeve edukative arsimore në përgjithësi

–Sistemi i edukimit universitar duhet të jetë radikalisht i ndryshuar në kuptimin e rëndësisëdhe kualitetit.

MISIONI I EDUKIMIT UNIVERSITAR

- Sigurimi i horizonteve të lira për mësim
- Shpërndarja e njohurisë nëpërmjet studimeve dhe hulumtimeve
- Ruajtja dhe shpërndarja e kulturave nacionale dhe regjionale
- Përfshirja në programet e integritimeve regjionale dhe të bashkëpunimeve ndërkombëtare

FUNKSIONI I EDUKIMIT UNIVERSITAR

- Shprehja e qendrueshmërisë etike dhe shkencore
- Kultivimi i funksionit kritik
- Shfrytëzimi i kapaciteteve intelektuale për funksion të parashikimeve dhe planifikimeve

- Mbrotjtja dhe shpërndarja aktive e vlerave të pranuara univerzale
- Ruajtja e të menduarit autonom
- Mundësimi i lirisë së plotë akademike

VIZIONET E REJA TË EDUKIMIT UNIVERSITAR

- Shkollimi universitar i përshtatshëm për të gjithë pa dillim feje , race apo gjinie
- Vendosja e raporteve harmonike me botën punuese me parashikimet e nevojave të shoqërisë dhe rrethit
- Të afruarit edukativ: mendim kritik dhe kreativitet
- Lloj-llojshmëria e sistemit, institucionit dhe programeve të studimeve
- Ndryshimi i rolit të personelit mësimor dhe studentor

REFORMIMI DHE TRANSFORMIMI I UNIVERSITETIT PËRCAKTIMI

Duke u nisur nga nevoja e domosdoshme e Universitetit të Prishtinës për një proces të gjithanshëm të reformimit, sipas standardeve dhe kriterëve të universiteteve evropiane, Universiteti i Prishtinës u përcaktua për kryerjen e reformave të bazuara në rekomandimet e Deklaratës së Bolonjës, që kanë për qëllim zbatimin e sistemit unik të arsimimit të lartë në hapësirën evropiane.

OBJEKTIVAT

Reformimi i Universitetit të Prishtinës konsiderojmë se është një proces i cili ka për synim realizimin e këtyre objektivave:

- integrimin e universitetit dhe standardizimin e kriterëve të studimeve universitare
- reformimin e planeve dhe programeve mësimore si dhe harmonizimin e tyre me ato të shtetëve të Bashkësisë Evropiane si imperativ i kohës,
- përsosjen e planeve dhe programeve ekzistuese si dhe begatimi i tyre me përvojën e fakulteteve të ngjashme të BE-së,
- zbatimin e Sistemit Evropian të Kreditimit për Transfer (sistemi ECTS)
- reformimin e regjimit të studimeve, hapjen e mundësive për transfer, përkatësisht këmbimin e studentëve,
- lëvizshmërinë, qarkullimin dhe transferin e lirë të studentëve .
- fleksibilitetin e studimeve dhe ndikimin e studentëve në zgjedhjen dhe përshtatjen e tyre
- rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së studimeve me anë të zbatimit të metodave bashkëkohore të ligjërimit dhe të vlerësimit të njohurive të studentëve
- shfrytëzimin e potencialit kadrovik ekzistues dhe atij që shkollohet në botën e jashtme
- këmbimin e mësimdhënësve dhe përfshirjen e tyre në proceset e trajnimit dhe të specializimit ndërkombëtar.

-lirimi i studentëve nga gjërat e tepërta dhe të panevojshme.

REALIZIMI

Këto reforma kanë filluar në vitin 1987 me aprovimin e Dekreligjit mbi shkollimin e lartë, si domosdoshmëri e shkëputjes nga sistemi paraprak. Gjatë këtyre viteve sa është punuar, është konstatuar se duhet bërë edhe shumë ndryshime, por se kemi qenë të penguar nga gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë, dhe nuk mund të kontaktonim me botën e civilizuar për të marrë eksperiencën e tyre dhe sistemet e tyre të shkollimit për modele.

Dilema e cila na ka përcjellë një kohë të gjatë ishte: të bazohemi në një sistem të shkollimit të lartë nga ndonjë shtet me sistem të avansuar, të krijojmë një sistem autokton duke i marrë specifikat dhe rrethanat tona, apo të përcaktohem për një sistem të shkollimit që synohet nga bashkësia evropiane deri në vitin 2010. Në sajë të një pune serioze, rekomandimeve të Konferencës së Rektorëve të Evropës si dhe të administratortit ndërkombëtar për Universitetin, Michael Daxner, definitivisht vendosëm që të dalim me një projekt të reformimit të Universitetit sipas Deklaratës së Bolonjës. Përcaktimi për këtë model kishte për bazë trendet dhe synimet e shkollimit të lartë në hapësirën evropiane. Kështu me vendosmëri Universiteti i Prishtinës u bë bartës aktiv i reformave, sepse ishte iluzore dhe e papranueshme qasja pasive, duke pritur imponime nga faktori ndërkombëtar.

Realizimi i reformave në Universitet është kryer sipas modelit

$$3 + 2 + 3$$

3 vite bechellor, 2 vite master, 3 – vite doktor

STUDIMET UNIVERSITARE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

STUDIMET THEMELORE ***3 VITE***

Moduli 1: Studime themelore - semestri I dhe II
Moduli 2 : Studime themelore profesionale –semestri III dhe IV
Moduli 3 : Studime profesionale _ semestri V dhe VI

BACHELOR

STUDIMET PROFESIONALE ***2 VITE***

Moduli 4: Puna praktike - semestri VII
Moduli 3 : Studime profesionale – semestri VIII
Moduli 5 : Studime të ngushta profesionale –semestri IX
Moduli 6: Studime zgjedhore profesionale -semestri IX
Moduli 7: Studime zgjedhore jo profesionale –semestri IX
Moduli 8 : Studime të caktuara –semestri X
Moduli 9 : Punimi master –semestri X

MASTER

STUDIME SHKENCORE PROFESIONALE ***3 VITE***

Moduli 1 : Studime themelore –semestri XI
Moduli 2 : Studime themelore profesionale – semestri XII
Moduli 3 : Studime profesionale – semestri XIII dhe XIV
Moduli 5 : Studime të ngushta profesionale- semestri XV
Moduli 6 : Studime zgjedhore profesionale -semestri XV
Moduli 7: Studime zgjedhore jo profesionale –semestri XV
Moduli 8 : Studime të caktuara –semestri XVI
Moduli 9 : Punimi i doktoranturës –semestri XVI

DOKTOR

HISTORIKU I SHKURTËR I DEKLARATËS SË BOLONJËS

Me rastin e 800-vjetorit të themelimit të Universitetit të Sorbonës, ministrat e arsimit të Francës, Gjermanisë, Italisë dhe Britanisë së Madhe, nënshkruan Deklaratën e Sorbonës, më 25 maj të vitit 1998, për ekuivalentimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë në hapësirën e Evropës, me qëllim të integritimit në tregjet ekonomike, komerciale dhe financiare të Bashkësisë Evropiane gjatë 40 vjetëve të fundit. Në këtë Deklaratë është paraparë formimi i komisioneve shkencore dhe profesionale për reformimin e Arsimit dhe ekuivalentimit të tij në Evropë. Në këtë projekt ishin angazhuar: Prof.Dr. Guy Haug, Prof.Dr. Jette Kirstein dhe Prof.Dr. Inge Knudsen. Eshtë paraparë që raporti i projekteve të tyre të shqyrtohet në Konferencën e paraparë që të mbahej në Bolonjë, në qershor të vitit 1999.

Më 19 qershor të vitit 1999, në Konferencën e Bolonjës është miratuar Deklarata e Bolonjës (The Bologna Declaration), e nënshkruar nga ministrat e arsimit të 29 shteteve evropiane, të cilët “janë obliguar që të plotësojnë objektivat e Deklaratës” dhe që të “shpejtojnë punën në koordinimin e ekuivalentimit të shkollimit universitar”. Në këtë deklaratë janë aprovuar raportet e projekteve të prof.dr. Guy Haug, prof.dr. Jette Kirstein dhe prof.dr. Inge Knudsen dhe janë rekomanduar si model për transformimin e shkollimit universitar.

Dy vjet pas nënshkrimit të Deklaratës së Bolonjës dhe tre vjet pas nënshkrimit të Deklaratës së Sorbonës, ministrat evropianë për arsim të lartë, që përfaqsonin 32 vende nënshkruese, u takuan në Pragë më 19 Maj 2001 me qëllim që të shqyrtonin progresin e arritur dhe të përcaktonin drejtimit dhe prioritetet për këtë proces në vitet pasuese. Ministrat ripohuan qëndrimet e tyre drejt objektivave për themelimin e hapësirës së arsimit të lartë deri në vitin 2010. Arsyeja pse Praga vendosi të mbajë këtë mbledhje është simbol i vullnetit të mirë të tyre të inkuadrojnë tërë Evropën në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Ministrat morën shënime nga Konferenca e institucioneve të arsimit të lartë, të mbajtur në Salamanka të Spanjës më 20 dhe 30 mars 2001 dhe rekomandimet e Konventës së Studentëve Evropianë, mbajtur më 14 dhe 25 mars 2001 dhe e mirëpritën inkuadrimit aktiv të Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EAU) si dhe Bashkimit Kombëtar të Studentëve të Evropës (ESIB) në procesin e Bolonjës.

ZBATIMI I SISTEMI EVROPIAN I KREDITIMIT PER TRANSFER (ECTS)

Sipas sistemit evropian të kreditimit për transfer të studentëve (ECTS-European Credit Transfer System) një vit akademik duhet që të jetë ekuivalent me 60 kredi, normalisht 30 kredi për një semester.

Studentët duhet të plotësojnë kërkesat për minimumin e lëndëve mësimore. Gjatë 3 vjetëve të studimeve bachelor, studentët duhet të plotësojnë së paku 60 kredi me lëndët e studimeve themelore (moduli 1), 60 kredi , me lëndët e studimeve themelore profesionale (moduli 2) 60 kredi, me lëndët e studimeve profesionale dhe punimi i diplomës (moduli 3) 60 kredi.

Sipas kësaj studenti duhet të fitojë së paku 180 kredi për të fituar thirrjen bachelor (BA) si dhe duhet të jape 18-30 provime.

Nga lëndët e ofruara zgjedhore, studenti duhet t'i zgjedhë disa prej tyre, në varësi të numrit të pikëve që i ka lënda. Studenti për zgjerimin e njohurive të tija, mund të zgjedhë, edhe lëndët të tjera nga këto , të cilat nuk kanë kredi.

Numri i kredive për lëndë obligative dhe zgjedhore përcaktohet nga Këshilli i Fakultetit., duke i patur parasysh planet dhe programet mësimore evropiane.

Në pasqyrën e planit mësimor po ashtu përfshihen edhe:

numri i orëve

mënyra e zhvillimit të mësimin (ligjërata, ushtrime, punë laboratorike)

mësimdhënësi

Studimet gjatë viteve do të kenë më shumë lëndë të obligueshme dhe më pak lëndë zgjedhore. Kjo do të mundësojë profilizimin e profesionit si dhe mundësinë e zgjedhjes së lirë të lëndëve të cilat i konsideron me interes për arritjen e njohurive të domosdoshme.. Mësimdhënësit do të janë të angazhuar në të dy semestrat, por meqenëse shumica e lëndëve janë një-semestrale, ata do të kenë nga dy lëndë (një në semestrin dimëror dhe një në atë veror) ose edhe më shumë se dy lëndë.

Gjatë tërë vitit të tretë të studimeve, studenti do të zgjedhë temën për punim të diplomës.

Një model i mundshëm për prezantimin tabelar të një viti të studimeve në fakultetin xxx për rastin me 10 lëndë (6 obligative dhe 4 zgjedhore) është paraqitur në vazhdim:

Plani mësimor për departamentin

Sqarim: Fondi i orëve është dhënë në formën L+U+K, ku janë L-ligjerata, U-ushtrime, K-Konsultime kabinetike (laboratorike).

Viti i parë

Nr.	Lënda mësimore	Kredi	Lloji	Sem. I	Sem. II	Mësimdhënësi
	Lënda 1	6	0	2+1+0		
	Lënda 2	10	0	2+1+1	2+0+2	
	Lënda 3	6	0		2+2+0	
	Lënda 4	10	0	2+1+0	2+0+2	
	Lënda 5	5	0		2+0+2	
	Lënda 6	5	0	2+2+0		
	Lënda 7	4,5	Z	2+2+0		
	Lënda 8	4,5	Z	1+2+0		
	Lënda 9	4,5	Z	2+2+0		

	Lënda 10	3	Z	2+0+2
	Lënda 11	3	Z	2+0+2
	Lënda 12	3	Z	2+0+2
13	Lënda13	3	Z	2+2+0
	Gjithësej	2x30		20 20

KONTRIBUTI I UNIVERSITETIT

KUADRI MESIMOR


Me potencialin akademik që ka Universiteti i Prishtinës (133 profesorë ordinarë, 121 profesorë inordinarë, 104 docentë, 185 ligjërues e lektorë , 72 profesorë të shkollave të larta, 27 ligjërues të lartë dhe 441 asistentë dhe bashkëpunorë) mund të kryejë një punë të madhe në rindërtimin e Kosovës pas luftës.

KONTRIBUTI I UNIVERSITETIT

Kontributi i Universitetit mund të jetë në :

- Dhënien e kuadrave profesionale për lëmi të ndryshme.
- Përfshirjen në analizat studimore të zhvillimit afatshkurter dhe afatgjatë që i financojnë organet qeveritare.
- Përpilimin e projekteve ideore dhe kryesore.
- Mbikqyrjet e relizimit të investimeve të caktuara.
- Kontrollimet e paisjeve të cilat përdoren dhe siguria e tyre nga aspekti i mbrojtjes kundër zjarrit , mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së ambientit.
- Kontrollimi i kualitetit të prodhimeve të cilat importohen nga jashtë dhe ato të cilat prodhohen në Kosovë, me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga ndonjë epidemi apo sëmundje që mund të vijësi pasojë e ushqimit.
- Shërbimet shëndetësore profesionale me qëllim të ruajtjes së shëndetit të popullatës
- Hulumtimet për sigurimin e popullatës me ujë të sigurt dhe të mjaftueshëm të pijshëm, pas luftës duke pasë parasysh se pushtet janë të papastrat.

KONTRIBUTI I FAKULTETEVE DHE I SHKOLLAVE TË LARTA



BASHKËPUNIMI AKADEMIK I KOSOVËS ME VENDET E TJERA

1. Konteksti

Situata aktuale në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë paraqet shumë pengesa për zhvillim akademik të kuadrit të ri. Të ardhurat e ulëta personale detyrojnë shumë akademikë të merren me punë të tjera plotësuese ose, në rastin më të mirë, të angazhohen tej mase në mësimdhënie, duke mos pasur mundësi të merren me punë kërkimore-shkencore. Po ashtu, kuadri universitar në Kosovë ballafaqohet me vështirësi të konsiderueshme të karakterit profesional, duke mos qenë në gjendje t'i përcjellë trendet në lëminë e zhvillimit të kurrikulit dhe metodave të mësimdhënies.

Në Kosovë, si dhe në vendet tjera të ish-blokut komunist, komunikimi i institucioneve akademike me ekonominë është kanalizuar përmes strukturave shtetërore, me zhdukjen e të cilave ka pësuar edhe ky lloj komunikimi. Ndërkaq, arsimimi universitar është karakterizuar me një orientim të shprehur akademik, duke bërë dallim të qartë në mes të komponentës arsimore dhe asaj kërkimore-shkencore, që nuk është tipike për vendet e zhvilluara.

Cilësia e arsimit të lartë në Kosovë është ndikuar negativisht edhe nga sistemi i financimit të këtij sektori. Në fakt, nuk ka ekzistuar dhe ende nuk ekziston një baraspeshë në mes të ofertës dhe kërkesës së tregut të punës për kuadra të profilit të caktuar. Kjo ka bërë që shumë profile të studimeve në arsimin e lartë të hapen pa një analizë të duhur të nevojave, ose që financimi buxhetor për profile të caktuara të jetë në shpërprurje me rezultatet dhe kapacitetin e tyre. Në këtë mënyrë është krijuar një mentalitet i distancimit të institucioneve të arsimit të lartë nga trendet e tregut të punës, gjë që ka ndikuar negativisht edhe në zhvillimin profesional të kuadrit.

Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë vuan edhe nga mungesa e bashkëpunimit profesional në mes të ekspertëve dhe institucioneve të arsimit të lartë. Shumë shoqata dhe asociacione profesionale, të cilat i kanë dhënë kontribut të rëndësishëm zhvillimit të sistemit të arsimit të lartë, më nuk funksionojnë, gjë që i ven profesionistët në një lloj izolimi nga kolegët. Akademikët e rinj, e veçanërisht ata që kanë studiuar jashtë vendit, kanë vështirësi të caktuara për t'u integruar në hapësirën akademike kosovare, posaçërisht kur bëhet fjalë për avancimin profesional dhe shkencor.

Në kohën e regjimit komunist, përkundër politikave centraliste, menaxhimi i institucioneve të arsimit të lartë ka qenë relativisht i decentralizuar, ndërkohë që roli i administratës universitare ka qenë më shumë i karakterit koordinues. Edhe pse në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë ka funksionuar në kushte të represionit janë jetësuar disa zgjidhje ligjore, të cilat i kanë dhënë rol më të madh universitetit në raport me institucionet e arsimit të lartë që janë pjesë e tij. Periudha e pasluftës karakterizohet me një shkallë edhe më të lartë të centralizimit në nivel të universitetit, ku vendimet kryesore për institucionet e arsimit të lartë merren nga Bordi dhe Senati. Kjo ka bërë që edhe komunikimi i institucioneve të arsimit të lartë me institucionet simotra në Botë të jetë i varur nga administrata e universitetit.

2. Bashkëpunimi akademik

Në fushën e bashkëpunimit akademik me Botën individët dhe institucionet kosovare janë kryesisht në rolin e përfituesit. Në të shumtën e rasteve, bashkëpunimi bëhet i mundur falë iniciativave dhe financimit të partnerëve akademikë nga Bota, ose programeve dhe projekteve që menaxhohen nga institucione të huaja ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, si dhe agjensi të ndryshme donatore.

Në Kosovë, bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në Evropën Përfundimtare shihet si prioritet, pasi që këto institucione janë rëndom mirë të strukturuar dhe gëzojnë reputacionin e qendrave të dijes dhe të arriturave shkencore. Megjithatë, Unioni Evropian dhe agjensitë donatore inkurajojnë vazhdimisht thellimin e bashkëpunimit akademik në mes të institucioneve në Rajon, i cili për momentin, zhvillohet me një lloj “ndërmjetësimi” të institucioneve përfundimtare.

Në kuptimin organizativ, bashkëpunimi akademik zhvillohet në kuadër të programeve dhe projekteve të bashkëpunimit që menaxhohen kryesisht nga institucione jokosovare. Këtu me “programe” nënkuptojmë veprime më afatgjate që përbëhen nga aktivitete të ndërlidhura ose grupe të projekteve, ndërsa me “projekte” nënkuptojmë aktivitete të veçanta me një kufizim të qartë kohor.

Programet rëndom ofrojnë mundësi afatgjate bashkëpunimi akademik dhe, në përgjithësi synojnë ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe ndërtimin e kapacitetit për punë kërkimore-shkencore në vendin përfitues. Një program tipik i bashkëpunimit akademik është programi TEMPUS, i financuar nga Unioni Evropian, i cili përkrah projekte të përbashkëta të departamenteve akademike nga Evropa Lindore dhe vendet e Unionit Evropian. TEMPUS po ashtu inkurajon pjesëmarrjen e një numri sa më të madh të departamenteve akademike dhe individëve nga Evropa Lindore në një projekt të vetëm me qëllim të promovimit të kontakteve në nivel të rajoneve. Programe të tjera aktive në Kosovë janë Programi i përkrahjes arsimit të lartë (HESP), i financuar nga Fondacioni “Soros”, si dhe programe të bashkëpunimit akademik të financuara nga Shërbimi Gjerman për Bashkëpunim Akademik (DAAD), IREX, Këshilli Britanik, WUS-Austria, etj.

Në rastin e Kosovës, projektet në fushën e arsimit të lartë janë rëndom intervenime që financohen nga donatorë të huaj dhe synojnë arritjen e objektivave të qarta. Në kuadër të projekteve të tilla shpesh është e pranishme edhe komponeta e bashkëpunimit akademik në mes të departamenteve akademike në Kosovë dhe ayre në vendet tjera. Shembull tipik i një projekti të tillë është Projekti për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KEDP) i financuar nga Qeveria e Kanadasë. Ky projekt ka për qëllim ndërtimin e kapacitetit vendor për trajnimin e mësimdhënësve, por njëra ndër komponentat e tij ka të bëjë me themelimin e Fakultetit të Edukimit, ku parashihen forma të caktuara të bashkëpunimit akademik në mes të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Kalgarit.

3. Format e bashkëpunimit akademik

Këtu do të fokusohemi në tri forma kryesore të bashkëpunimit akademik: mobiliteti i mësimdhënësve dhe studentëve, zhvillimi i kurrikulit, puna shkencore.

3.1. Mobiliteti.— Për mësimdhënësit dhe studentët kosovarë janë në dispozicion skema të ndryshme të mobilitetit, që menaxhohen nga organizata ndërkombëtare, qeveritare, joqeveritare dhe agjensi donatore. Këto skema bëjnë të mundur qëndrime të shkurtëra të

mësimdhënësve dhe studentëve kosovarë në universitet e Evropës Përqendimore ose Amerikës Veriore me qëllim të ngritjes profesionale ose kompletimit të një pjese të programit studimor, por në situata të caktuara nga këto skema financohen edhe studime të plota, kryesisht të nivelit pasuniversitar. Këto skema bëjnë të mundur ngritjen profesionale të kuadrit universitar, si dhe krijimin e lidhjeve me institucionet akademike anëkend Botës. Në situata të caktuara, rastet individuale të mobilitetit kanë rezultuar me vendosjen e lidhjeve më të qëndrueshme ndërinstitucionale, por ka edhe shembuj kur individit është i vetmi përfitues i mobilitetit.

Tipi tjetër i skemave të mobilitetit është financimi i qëndrimeve të shkurtëra të akademikëve nga vende tjera të Botës në Kosovë. Në të shumtën e rasteve, këta persona angazhohen për mbajtjen e mësimi në Universitetin e Prishtinës, ose për organizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare për mësimdhënësit dhe studentët kosovarë, përfshirë ligjëratat tematike, debatet, diskutimet, etj. Në këto raste, rëndom përfitojnë departamente të tëra ose grupe më të mëdha të studentëve dhe/ose mësimdhënësve.

Skemat më stabile të mobilitetit në Kosovë janë ato që operohen nga WUS-Austria dhe Fondacioni “Soros” (për studentë dhe mësimdhënës), pastaj Fondacioni “Ron Brown” dhe Këshilli Britanik (vetëm për studime pasuniversitare), si dhe DAAD dhe IREX (vetëm për mësimdhënës). Të gjitha këto institucione punojnë sipas kriterëve vetanake dhe nuk ekziston ndonjë bashkëpunim me organet e Kosovës në kuptim të përcaktimit të prioritetëve ose përzgjedhjes së kandidatëve. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i granteve qeveritare janë në dispozicion të mësimdhënësve dhe studentëve kosovarë për pjesëmarrje në skema të ndryshme të mobilitetit.

3.2. Zhvillimi i kurrikulit.– Në mjedisin tonë, procesi i zhvillimit të kurrikulit shihet më shumë si një fazë e reformimit të studimeve në arsimin e lartë se sa si një rrugë për ndërtimin e partneriteteve të reja dhe krijimin e efekteve të qëndrueshme në shoqëri. Zhvillimi i kurrikulit nuk është vetëm ndryshim i përmbajtjes së lëndëve ekzistuese dhe përfshirje e lëndëve të reja në programin mësimor, por edhe ndërmarrje e të gjitha masave për pajisjen e studentëve me shkathtësi për punë në një mjedis të ndryshueshëm që kërkon aftësi për të nxënë gjatë gjithë jetës. Gjithashtu shtrohet nevoja që kurrikulat të jenë në pajtim me trendet bashkëkohore, duke rezultuar me kualifikime të njohura në nivel ndërkombëtar.

Zhvillimi i kurrikulit mund të konsiderohet si një proces i ndryshimit që ka për qëllim ngritjen e cilësisë së arsimit. Ndërkaq, sipas Fullanit, çdo ndryshim në arsim karakterizohet me tri faza: pranimi i ndryshimit, implementimi dhe institucionalizmi.

Zhvillimi i kurrikulit me synim arritjen e standardeve ndërkombëtare nuk mund të shikohet ndaras nga mobiliteti i studentëve dhe mësimdhënësve. Në fakt, këto janë tri elementet qendrore të procesit të ndërkombëtarizimit dhe globalizimit të arsimit të lartë. Në disa fusha të dijes, kurrikulat e tilla mund të zhvillohen në suaza kombëtare, por në të shumtën e rasteve kjo bëhet në bashkëpunim me partnerë të jashtëm, gjë që kërkon një qëndrim të hapur ndaj këtij procesi.

Krahas reformimit të sistemit të arsimit të lartë në pajtim me parimet e Deklaratës së Bolonjës, rëndësi e veçantë në Kosovë i kushtohet edhe avancimit të mësimdhënies në institucione të arsimit të lartë. Kalimi nga mënyra e punës ex-catedra në format interaktive të mësimdhënies kërkon ritrajnimin e mësimdhënësve, i cili duhet të bëhet

krahas zhvillimit të kurrikulave të reja. Metodologjia e mësimdhënies shihet si një fushë me potencial të madh për promovimin e bashkëpunimit akademik.

Programi TEMPUS përmban një komponentë të veçantë për zhvillimin e kurrikulit në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë të vendeve të Unionit Evropian. Edhe pse në vendet në transicion janë bërë ndryshime rrënjësore në kurrikula universitare, TEMPUS është angazhuar më shumë në përpilimin e kurrikulave për drejtime të reja të studimeve, të cilat më parë nuk kanë funksionuar në këto vende. Ky rregull aplikohet edhe në rastin e Kosovës ku TEMPUS financon disa projekte të zhvillimit të kurrikulit. Një aspekt tjetër i projekteve të financuara nga TEMPUS është krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë akademik në mes të institucioneve akademike në vendet përfituese, kryesisht ato që janë në fazën e transicionit.

Programi HESP i Fondacionit “Soros” i kushton rëndësi të madhe zhvillimit të kurrikulit dhe ngritjes së cilësisë së mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë. Kosova është në mesin e vendeve që mund të përfitojnë shumë nga skema të tilla. Për dallim nga programet tjera, HESP konsideron se tanimë ekziston një përvojë në Rajon, e cila duhet të shfrytëzohet nga ato vende që kanë nevojë. Në këtë drejtim, institucionet kosovare të arsimit të lartë dhe individët kanë shfrytëzuar mundësinë për pjesëmarrje në shkollat verore të organizuara nga HESP, e që mbulojnë tematika të ndryshme nga shkencat shoqërore. Po ashtu, HESP ka bërë të mundur qëndrime të shkurtëra studimore të kuadrit universitar në Universitetin e Evropës Qendrore (CEU) në Budapest, ku ofrohen mundësi që mësimdhënësit universitarë të përgatiten për mbajtjen e lëndëve të reja mësimore nga fusha e shkencave shoqërore, duke shfrytëzuar resurset e pasura njerëzore dhe materiale të këtij universiteti. HESP financon edhe disa partneritete në mes të deparatmenteve akademike në Universitetin e Prishtinës dhe universiteteve në Evropë. Ekzistojnë edhe projekte të tjera bashkëpunimi që kanë për qëllim zhvillimin e kurrikulit dhe financohen nga donatorë të tjerë. Një shembull tipik, është projekti KEDP i financuar nga Qeveria Kanadeze, i cili parasheh zhvillimin e kurrikulit për Fakultetin e Edukimit dhe, në këtë drejtim, ofron ekspertizën kanadeze.

Një veti e përbashkët e të gjitha formave të bashkëpunimit, që kanë për qëllim zhvillimin e kurrikulit, është se përvojat e vendeve të zhvilluara nuk mund të barten mekanikisht në sistemet e arsimit të vendeve në transicion. Për këtë arsye imponohet nevoja që institucionet kosovare të arsimit të lartë të përfshihen aktivisht në procesin e planifikimit të projekteve të tilla, duke i definuar qartë kërkesat specifike. Për fat të keq, institucionet tona janë ende më shumë të prirura të inkuadrohen në projekte që inicohen nga partnerë akademikë, se sa të inicojnë vetë projekte të zhvillimit të kurrikulit, duke marrë mbi vete përgjegjësinë për rezultatet e projekteve të tilla.

3.3. Puna shkencore.— Për shkak të izolimit dhjetëvjeçar nga të arriturat shkencore, në Kosovë ndihet nevoja për një bashkëpunim të shtuar në fushën e shkencës dhe ngritjes shkencore të kuadrit universitar. Për më tepër, pamundësia për t’u marrur me punë kërkimore-shkencore paraqitet si një ndër arsyet për fluktuimin e kuadrit shkencor nga institucionet e arsimit të lartë në veprimtari të tjera, ose edhe emigrimin e ekspertëve jashtë vendit. Në Kosovë pothuaj se nuk ka fonde për punë kërkimore-shkencore, pasi që ekonomia nuk është në gjendje t’i absorbojë rezultatet e punës shkencore, ndërsa buxheti i Qeverisë nuk ka mundësi të financojë aktivitete të tilla.

Për dallim nga situata vendore, Unioni Evropian i kushton rëndësi të madhe punës kërkimore-shkencore dhe siguron fonde të konsiderueshme për këtë qëllim. Megjithatë, një pjesë shumë e vogël e këtyre fondeve i dedikohen vendeve joanëtare dhe mund të shfrytëzohen vetëm në bazë të konkursit që ka për kriter cilësinë e jo edhe nevojën për përkrahje. Janë të ralla rastet e pjesëmarrjes së departamenteve akademike të Universitetit të Prishtinës në projekte të tilla. Ekzistojnë programe specifike të cilat fokusohen në zhvillimin akademik të kuadrit të ri, duke ofruar mundësi për studime të doktoratës ose post-doktoratës në universitete të tjera. Bursa individuale për studime të tilla ofrojnë Fondacioni “Soros”, IREX, DAAD, etj.

4. Përfundim

Programet dhe projektet e bashkëpunimit akademik mund të shërbejnë si stimulim shumë i mirë për kuadrin e ri dhe studentët perspektivë për t’u përcaktuar pa mëdyshje për karrierë akademike. Identifikimi i individëve të tillë dhe ndihma që ata të përfshihen në programe të ndryshme të bashkëpunimit akademik do të ishte një strategji për pengimin e fluktuimit të trurit nga profesionet akademike në profesione të tjera, ose jashtë vendit. Me gjithë bashkëpunimin me vendet e Evropës Përfundim, vërehet një stagnim në bashkëpunimin akademik në nivelin rajonal. Inkurajimi i kuadrit të ri universitar për pjesëmarrje në rrjetat rajonale profesionale është një rrugë për vendosjen e raporteve bashkëpunuese me institucionet simotra në Rajon dhe këmbimin e përvojave në fushën e dijes.

Bashkëpunimi akademik në mes të institucioneve të arsimit të lartë e aktualizon çështjen e standardeve të përbashkëta. Mosnjohja e sistemeve të ndryshme të arsimit është shpesh burim i keqkuptimeve të ndryshme. Prandaj, inkurajimi i projekteve që synojnë unifikimin e standardeve në pajtim me trendet bashkëkohore e nxit bashkëpunimin akademik. Projektet e zhvillimit të kurrikulit që kanë për qëllim krahasueshmërinë e njohurive dhe kualifikimeve janë në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit dhe krijimit të parakushteve për mobilitet të kuadrit.

Mosnjohja e gjuhëve të huaja, e posaçërisht gjuhës angleze paraqitet si një kufizim serioz për pjesëmarrje në programe të bashkëpunimit akademik. Kjo çështje duhet të adresohet me prioritet në sistemin e arsimit të lartë, duke inkurajuar dhe stimuluar përvetësimin e gjuhëve të huaja nga ana e kuadrit mësimor dhe studentëve. Organizimi i pjesërishtëm i procesit mësimor në gjuhën angleze mund të jetë një rrugë për arritjen e këtij qëllimi. Një parakusht me rëndësi për zhvillimin e suksesshëm të bashkëpunimit akademik me Botën është ngritja e cilësisë së menaxhimit në arsimin e lartë. Investimet në fushën e zhvillimit të kurrikulit nuk mund të jenë të qëndrueshme nëse nuk ndërtohet një mekanizëm për kontrollin e cilësisë dhe adresimin e çështjeve aktuale në këtë fushë. Me rëndësi të veçantë për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit akademik është ndërtimi i kapacitetit administrativ për bashkëpunim akademik, si në nivel të Universitetit, ashtu edhe në nivel të Ministrisë. Në një të ardhme të afërt kapaciteti i tillë do të duhet të ndërtohet edhe në nivel të fakulteteve dhe departamenteve akademike, të cilat gjithnjë e më tepër e marrin përgjegjësinë për të ardhmen e tyre.

Në konstelacionin aktual, kapitali njerëzor është pothuaj se pasuria e vetme të cilën Kosova mund t’ia ofrojë Botës, prandaj edhe duhet të ekzistojë një strategji kombëtare për zhvillimin e kapitalit human, një komponentë e të cilës, pa dyshim, do të jetë edhe

inkurajimi i bashkëpunimit akademik me Botën si rrugë për integrimin e Kosovës në bashkësinë e vendeve demokratike.

Prof. Dr.Kadri METAJ

FILOZOFIA DHE TRANZICIONI-ECURITË E REFORMËS NË KATEDRËN E FILOZOFISË NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Një hyrje e shkurtër

Tema mbi filozofinë dhe tranzicionin është një temë bosht që lidhet me vendet ish komuniste dhe me reformat shoqërore të viteve nëntëdhjetë në Evropën Lindore dhe Juglindore. Tashmë janë publikuar studime interesante në këtë temë që marrin në shqyrtim ngjarjet e vitit 1989 dhe dekonstruktimin e teologjisë politike si dhe epokën e re të tranzicionit, demokracisë dhe shoqërisë civile.

Pjesë e pandarë e këtyre trendeve padyshim është edhe Reforma shkollore e të gjitha niveleve dhe problemi i kulturës dhe demokracisë që paraqitet si një çështje perspektive e shek.XXI. Ky shkrim nuk pretendon të shkoqisë aspekte teorike të raportit filozofia-tranzicioni, ku do të analizoheshin probleme si Trashëgimia e disidencës, probleme të përgjegjësisë, përkatësisht papërgjegjësisë së intelektualëve, probleme të romantizmit restaurues dhe segmente tjera të dëshprimit e nostalgjisë që hasen akoma te ato relacione, por para se gjithash shkrimi është i motivuar nga nevoja e një bashkpunimi rajonal dhe më gjërë kur është fjala te reforma universitare në lidhje me Sistemin e Transferit të Kredive (ECT) sistemin dhe Marrëveshjen e Bolonjës.

Një histori e shkurtër:

Në lidhje me vendin e Filozofisë në shoqërinë kosovare do theksoja kalimthi se Katedra e Filozofisë ekziston në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1973 dhe ajo, konform me gjendjen e përgjithshme shpirtërore e kulturore në ish Jugosllavi (që ishte një vend më liberal sesa vendet tjera ish komuniste) nuk ishte Katedër me shumë ngarkesa dogmatike. Studimi ishte dylëndor, pra Filozofi-Sociologji dhe programet e Katedrës ishin të ngjashme me ato të katedrave simotra në Zagreb, Beograd, Lubjanë e Sarajevë dhe aty mësohej Historia e filozofisë (gjatë katër viteve të studimit), mandej Filozofia teorike, si logjika, teoria e njohjes, ontologjia, terminologjia filozofike etj. Pjesë e atij programi ishte edhe Filozofia praktike (Etika, Estetika, Filozofia sociale, Filozofia politike, Antropologjia filozofike)dhe në vazhdim edhe materje ndihmëse si gjuhë të huaja, lëndë të përgjithshme, metodika të ndryshme etj. Filozofia marksiste ishte pjesë përbërëse e programit dhe ajo varësisht nga mesimdhënësi ishte më shumë apo më pak dogmatike, më sovjetike apo më përendimore dhe reflektonte më shumë apo më pak lojalitetin e mesimdhënësve ndaj sistemit dhe politikës.

Natyrisht se gjendja ndryshonte nga universiteti në universitet dhe nga ardhje shkuarjet e rymimeve politike dhe krizave që nuk ishin të pakta as në atë kohë.

Siç është e njohur viti 1989 shënon hyrjen e ish Jugosllavisë në një krizë të parrugdalje sepse në vend të reformave shoqërore dhe demokratizimit këtu mbizotroi hegjemonizmi i cili qoi në lufta të njipasnishme që nga Sllovenia, nëpër Kroaci e Bosnje e deri në Kosovë.

Kosova e ndjeu në mënyrë të veçantë trysninë hegjemoniste serbe, sepse qysh në vitin 1990 me aneksimin e autonomisë ajo u pushtua edhe ushtarakisht dhe jetoi në një gjendje

të represionit të vazhdueshëm dhe të shkeljes drastike të të drejtave të njeriut, gjendje ajo tashmë e njohur për opinionin që këtu nuk pretendohet të sqarohet detajisht por vetëm sa për të nënvizuar faktin se në Kosovë tranzicioni nuk filloi sikur në vendet tjera në vitet 90 dhe se Kosova gjatë një decenje zhvilloi një jetë “paralele” prandaj edhe një sistem arsimor parallel, pa kushte elementare për të bërë avansime dhe reforma shkollore sikurse në vendet tjera. Në atë periudhë edhe mësimdhania e filozofisë pothuaj sa nuk ishte nderprerë fare, sepse disa nga mësimdhënësit e kishin lëshuar vendin, kurse të tjerët së bashku me studentët e paktë (në sijnë vit studimesh, sidomos në ato të fundit kishte vetëm 2-3 studentë), po bënin përpjekje të ruhej një bërthamë që do të ishte piknisje për një fillim të ri. Vlen të përmendet fakti se në aspektin e numrit të studentëve ato vite kishte një rënie drastike, por jo edhe në pikëpamje të cilësisë. Disa studentë të paktë në numër por shumë të përkushtuar, tani janë asistentë dhe emra të respektuar në jetën publike dhe shoqërore në Kosovë. Edhe në ato rrethana u bënë disa modifikime të programeve mësimore me ç'rast u hoqën disa lëndë mësimore dhe u shtuan disa të tjera dhe ndryshimi më cilësor u bë kur iu krijua mundësia studentëve që dy vitet e para të studimit të ishin të përbashkëta, kurse pas vitit të dytë ata përcaktoheshin për studimin e filozofisë, përkatësisht të sociologjisë. Ky ishte një hap cilësor në drejtim të ndarjes përfundimtare të Katedrës deri atëherë të përbashkët në dy të veçanta. Mendoj se ajo periudhë sa i përket filozofisë e meriton një koment më të plotë dhe gjithpërfshirës, sigurisht në një rast dhe vëllim tjetër. Nga literatura më ka rënë të shoh se diçka të ngjashme ka patur në Poloni në kohën e fashizmit.

Gjendja dhe ecuritë e tanishme

Në të vërtetë tranzicioni i gjithanshëm në Kosovë filloi me dhjetë vite vonesë, krahasuar me vendet tjera ish komuniste, pra pas intervenimit të Natos dhe pas marrjes së Kosovës në administrim ndërkombëtar. Pra pas qershorit të vitit 1999 fillon një kapitull i ri në rindërtimin e gjithanshëm të Kosovës, bazuar në Rezolutën 1244 të OKB. Reforma shkollore erdhi dhe u bë pjesë e tranzicionit të përgjithshëm që në rastin e Kosovës kishte edhe veçoritë specifike. Duhej bërë tranzicioni nga Socializmi ekstrem represiv, apo nacionalsocializmi mbizotrues në dhjetë vitet e fundit, në demokraci; Nga aparthejdi në sundimin e ligjit dhe të së drejtës dhe nga ekonomia kuazisocialiste në ekonominë e tregut.

Kjo gjendje krijoi mundësinë e braktisjes së autarkies (mbylljes) së imponuar në të cilën edhe sistemi arsimor si rezistent që ishte më parë reflektonte mbyllje dhe refuzim. Që nga shtatori i vitit 1999 Universiteti i Prishtinës po punon intenzivisht në implementimin e Reformës universitare dhe ai është qeverisur ose bashkëqeverisur nga një administrator ndërkombëtar dhe një rektor vendor. Donator të ndryshëm po e përkrahin këtë ecuri sidomos Banka Botrore dhe programi Tempus dhe rezultatet e para tashmë janë evidente. Që nga shtatori i vitit 2001 Universiteti, prandaj edhe Katedra e Filozofisë (e cila tani është e mvehtësishtme) ka aplikuar Sistemin Evropian të Trasferit të Kredive (ECTS) me të cilin synohet të realizohet kompatibiliteti i programeve dhe mobiliteti i studentëve. Studimet zhvillohen sipas modelit 3+2+3. Edhe planet dhe programet e studimeve janë hartuar në bashkëpunim me kolegë ndërkombëtarë dhe me konsultimin e gjithanshëm të programeve nga katedrat simotra, sidomos të Universitetit Lille 3, Nice dhe Strasbourg. Katedra e Filozofisë tashmë ka filluar bashkëpunimin

rajonat në rrjetin e Frankofonisë për Evropën Juglindore me pjesëmarrje në Universitetet verore përkatëse si ai në Kluj të Rumanisë më 2000, mandej në Lille 2001 dhe atë në vijim që do të mbahet në Dubrovnik në shtator 2002. Universiteti veror me një numër të madh pjesëmarrësish vendorë dhe ndërkombëtarë organizuar nga Universiteti i Prishtinës dhe ATA (Asoc.training asotiation) dhe i njëjti do të mbahet edhe verën e vitit 2002, Korrik-gusht. Në këtë Universitet veror të Prishtinës një pjesë e konsideruar e materjeve mësimore janë nga Filozofia dhe shkencat tjera sociale dhe ka një interesim të madh për të aplikuar aty sepse tashmë kreditë e fituara me atë rast barten si pjesë e studimit të rregullt.

Një ndihmë të konsideruar në Reformimin e mësimdhëniës së filozofisë kanë dhënë dhe po japin edhe universitetet e Francës, sidomos ai i Lille 3 dhe në këtë drejtim synohet edhe një bashkpunim me qendrën e frankofonisë në Kluj, në lidhje me studimin Master dmth. pas tre vjetësh të studimeve themelore.

Në lidhje me reformimin dhe bashkpunimin regjional duhet përmendur edhe kontributin e z.Christian Duhamel, nga Universiteti Paris 4 dhe Ministria Franceze e Edukimit, i cili në cilësinë e ndihmësit të Administratorit ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës ka qëndruar një semestër në Prishtinë dhe ka ndihmuar mjaft në zhvillimin e rrjetit rajonal dhe bashkëpunimit ndëruniversitar. Në këtë pikëpamje edhe Zyra e ndërlidhjeve e Francës (BLF) po e ndihmon Katedrën në synimet e saj të bashkëpunimit rajonal dhe këtë vit po finanson pjesëmarrjen e studentëve kosovarë në Universitetin veror të Dubrovnikut. Studentët e filozofisë, nga dy sish do marrin pjesë edhe në Universitetin veror të Strasburgut dhe atë të Ohrit, organizuar nga org,Transeuropeen.

Edhe një aktivitet të frankofonisë duhet veçuar në Fakultetin e Filozofisë.Aty tash tri vjet ekziston qendra Fransua Furret, një donacion me disa qindra tituj librash, e cila në bashkëpunim me Komitetin Kosova të Parisit ka organizuar edhe cikle ligjëratah nga Filozofia politike dhe të tjera ,të cilat kanë zgjuar interesim te studentët dhe publiku i gjerë.

Shtojcë: Në vazhdim të këtij prezentimi ja edhe Plani i studimeve të Filozofisë, cikli i parë trevjeçar për implementimin e të cilit është i nevojshëm një bashkëpunim ndërkatedral. Bashkëpunimi do të jetë imediat sidomos në ciklin Master, pra pas tre vitesh të studimeve themelore dhe për studime te doktoranturës. Deri atëherë shpresojmë të jetë konsoliduar rrjeti rajonal i bashkëpunimit, i mbështetur edhe në projekte afatgjata dhe me dobi të ndërsjellë.

DEPARTAMENTI I FILOZOFISË PLANI MËSIMOR

VITI I PARË Semestri i I-rë

Moduli i I-rë	Moduli i II-të	Moduli i III-të	Moduli i IV-të	Moduli i V-të	Gjithësej

Hyrje/Shkrimi Akademik/ Gjuhë Angleze		Hyrje në Filozofi		Logjikë		Filozofi Egzistencialiste		Zgjedhore		
Nr. I orëve		Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve		20 Orë
Nr. I ECTS	6	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	6	30 ECTS
(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		

Semestri i II-të

Moduli i I-rë		Moduli i II-të		Moduli i III-të		Moduli i IV-të		Moduli i V-të		Gjithsej
Gjuha angleze për Qëllime akademike		Filozofia Antike		Interpretimi i teksteve filozofike		Etikë dhe politikë		Zgjedhore		
Nr. I orëve		Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve	0+4	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve		20 Orë
Nr. I ECTS	6	Nr. i ECTS	8	Nr. i ECTS	4	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	6	30 ECTS
(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		

VITI I DYTE

Semestri i III_të

Moduli i I-rë		Moduli i II-të		Moduli i III-të		Moduli i IV-të		Moduli i V-të		Gjithsej
Filozofi moderne I		Filozofi e artit		Filozofi e shkencës		Antropologji filozofike		Zgjedhore		
Nr. I orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve 2+1		Nr. i orëve	2+1	Nr. i orëve		20 Orë

Nr. I ECTS	8	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	5	Nr. i ECTS	5	Nr. i ECTS	6	30 ECTS
(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		

Semestri i IV-të

Moduli i I-rë		Moduli i II-të		Moduli i III-të		Moduli i IV-të		Moduli i V-të		Gjithsej
Etikë		Filozofia dhe kritika e shoqërisë		Metodologji me Epistemologji		Zgjedhore		Zgjedhore		
Nr. I orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve		Nr. i orëve		20 Orë
Nr. I ECTS	6	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	8	Nr. i ECTS	5	Nr. i ECTS	5	30 ECTS
(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		

VITI I TRETË

Semestri i V-të

Moduli i I-rë		Moduli i II-të		Moduli i III-të		Moduli i IV-të		Moduli i V-të		Gjithsej
Filozofi moderne II		Filozofi Zgjedhore		Filozofi politike		Zgjedhore		Zgjedhore		
Nr. I orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve		Nr. i orëve		20 Orë
Nr. I ECTS	8	Nr. I ECTS	6	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	5	Nr. i ECTS	5	30 ECTS
(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		

Semestri i VI-të

Moduli i I-rë		Moduli i II-të		Moduli i III-të		Moduli i IV-të		Moduli i V-të		Gjithsej

Punë diplome		Filozofi bashkëkohore		Psikanalizë		Zgjedhore		Zgjedhore		
Nr. I orëve	0+4	Nr. I orëve	2+2	Nr. i orëve	2+2	Nr. i orëve		Nr. i orëve		20 Orë
Nr. I ECTS	8	Nr. I ECTS	8	Nr. i ECTS	6	Nr. i ECTS	4	Nr. i ECTS	4	30 ECTS
(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		(kredi)		

Rregullat dhe parimet

Ndërmjet moduleve zgjedhore në semestrin e parë dhe të dytë dy module studentët mund t'i zgjedhin sipas dëshirës së tyre në cilindo fakultet, kurse shtatëe modulet e tjera, në semestrin III, IV, V, VI duhet të jenë nga fushat si më poshtë: Sociologji, Shkenca politike dhe administrate, Media, Drejtësi, Psikologji dhe gjuhë e huaj. Modulet nga fushat tjera të studimit mund të merren nga fakulteti relevant. Studenti nuk është i obliguar të merr të gjitha kurset e dhëna brenda vitit shkollor, sipas planit mësimor, por mund t'i merr edhe më vonë-gjatë studimeve.

Prof. Dr. Kadri METAJ
A PHILOSOPHIE ET LA TRANSITION :

ETAT D'AVANCEMENT DE LA REFORME DE L'ENSEIGNEMENT

AU DEPARTEMENT DE PHILOSOPHIE

DE L'UNIVERSITE DE PRISHTINA.

La question de la philosophie et de la transition est un sujet clé dans les pays ex-communistes de l'Europe de l'Est et du Sud-Est. Plusieurs études intéressantes ont déjà été publiées sur cette question tant sur les événements de 1989 et la destruction de la théologie politique, que sur le sujet inconnu que représente l'époque de la transition, de la démocratie et de la société civile à construire. La Réforme scolaire, à tous les niveaux, ainsi que le problème de la culture et de la démocratie, présenté comme une perspective du XXI-ème siècles, découle de ces événements. Cet article ne prétend pas élaborer les aspects théoriques du rapport entre la philosophie et cette transition, pour laquelle nous manquons d'outils d'analyse, et où il serait question de l'héritage de la dissidence, de la responsabilité ou de l'irresponsabilité des intellectuels, du romantisme restaurateur et autres domaines du désespoir et de la nostalgie qu'on rencontre aujourd'hui encore dans nos pays. Ma motivation est de montrer le besoin d'une collaboration encore plus large que régionale sur la question de la réforme universitaire, utilisant les cadres offerts par la Déclaration de Bologne (1999) et le Système européen des crédits transférables (ECTS).

Brève introduction

Le Département de Philosophie de l'Université de Prishtina existe depuis 1973, c'est-à dire deux ans après la fondation de cette université. Conformément à la situation générale en ex-Yougoslavie, qui était un pays plus libéral que les autres pays ex-communistes, ce n'était pas un Département ayant des charges dogmatiques. L'enseignement était bidisciplinaire, incluant la Philosophie et la Sociologie dont les programmes étaient semblables aux départements du reste du pays, Zagreb, Belgrade, Ljubljana ou Sarajevo. Durant les quatre années d'études, on y enseignait l'histoire de la philosophie, la philosophie théorique (logique, théorie de la reconnaissance, ontologie, terminologie philosophique, etc.), la philosophie pratique (éthique, esthétique, philosophie sociale, anthropologie philosophique). Il y avait encore d'autres matières annexes tels que les langues étrangères, des matières générales, les méthodologies de l'enseignement, etc. La philosophie marxiste était aussi partie intégrante du programme et, comme telle, suivant les enseignants, elle était enseignée de façon plus ou moins dogmatique, avec une orientation plus soviétique ou plus occidentale. D'une certaine façon, elle reflétait la loyauté des enseignants envers le système et sa politique. Naturellement dans l'ex- Yougoslavie, la situation changeait d'une université à l'autre. Cela dépendait du règne ou de l'écroulement des courants politiques du moment, ainsi que des crises qui traversaient le pays et trouvaient leurs résonance

dans l'enseignement de cette idéologie marxiste. Puis l'année 1989 va signifier l'entrée de l'ex-Yougoslavie dans une crise sans issue, car au lieu de faire des réformes sociales et la démocratisation, c'est la volonté d'hégémonisme qui régnait. Dans une situation où l'urgence des solutions aurait dû rassembler les bonnes volontés, ce fut l'enchaînement des guerres qui prévalut, l'une après l'autre, Slovénie, Croatie, Bosnie, puis Kosovo et Macédoine.

Le Kosovo a ressenti de manière particulière la pression de l'hégémonisme du régime de Belgrade, qui, en 1990 supprima son autonomie, puis l'occupa militairement. La langue albanaise fut interdite à tous les niveaux de l'enseignement, lequel se réfugia durant neuf années dans des maisons particulières. De ce fait, le Kosovo a vécu dans un état de répression continue et d'une violation drastique des droits de l'homme. Tout cela est maintenant bien connu et ne constitue pas le but de notre article, mais nécessitait d'être rappelé à cause de son incidence sur la situation actuelle, car la transition au Kosovo a cette particularité, cette originalité par rapport aux autres pays issus du système communiste, d'inclure cette décennie de « système parallèle », avec ses côtés positifs et négatifs pour la conception de la réforme de l'enseignement. C'était un système d'enseignement parallèle dont nous parlons encore parfois avec une sorte de nostalgie car nous pensions alors savoir l'attitude à adopter, même si elle était risquée, mais qui était dépourvu des conditions élémentaires pour les conditions de travail, mais aussi pour évoluer, ce qui l'a rendu incapable de faire des progrès ou d'entreprendre des réformes scolaires comme c'était le cas dans d'autres pays après et parfois même avant 1989. Tout s'est figé dans cette attitude de résistance que nous ne pensions pas mener durant si longtemps. 10 ans, cela mène un écolier de 8 à 18 ans. Ou un lycéen puis étudiant de 14 à 24 ans. Durant cette période, l'enseignement de la philosophie fut presque interrompu à cause du départ de plusieurs enseignants (nous n'étions déjà pas beaucoup), tandis que ceux qui restèrent au pays tentèrent de maintenir en vie un noyau d'étudiants (2-3 par année d'étude), noyau qui, pensions-nous, permettrait un nouveau départ. En fait, cette baisse draconienne du nombre de nos étudiants durant cette période ne constitua pas pour autant une baisse de la qualité de ces étudiants. Il y eut un nombre modeste, mais significatif, de ces étudiants qui sont devenus aujourd'hui des assistants de professeurs, ou des personnalités respectées de la vie publique et sociale du Kosovo. Même dans ces conditions d'isolement et de clandestinité, on a réussi à opérer quelques modifications des programmes d'enseignement, enlevant certaines matières, en ajoutant d'autres. Ceci permit aux étudiants, après un tronc commun général de deux ans, de se décider ensuite pour l'étude de la philosophie ou de la sociologie. Cela constituait un pas décisif vers la division définitive en deux de notre Département jusqu'alors commun.

Je pense que cette période-là mérite un commentaire plus complet et plus général, que je me propose de traiter dans un prochain article. J'ai d'ailleurs constaté, dans mes lectures, que quelque chose de semblable s'était passé même en Pologne durant l'époque fasciste.

La situation aujourd'hui

A dire vrai, la transition générale au Kosovo a commencé avec dix années de retard par rapport aux autres pays ex-communistes, en 1999, après l'intervention de l'OTAN et après la mise du Kosovo sous l'administration des Nations Unies. Après la fin de l'intervention de l'OTAN en juin 1999, s'ouvre un nouveau chapitre de la reconstruction générale du Kosovo, s'appuyant sur la Résolution 1244. La réforme scolaire est devenue une partie de la transition générale, laquelle, dans le cas du Kosovo, avait des particularités spécifiques. On devait faire la transition d'un socialisme répressif, suivi d'un national-socialisme dominateur des dix dernières années, vers la démocratie. Il nous fallait passer d'une situation d'apartheid à la suprématie de la loi et du droit, ainsi que de l'économie quasi-socialiste dont étaient exclus les cadres kosovars albanais vers une économie de marché dont nous ignorions tout, et avec la présence sur place des armées de la coalition et des experts internationaux qui se succédaient. Cette situation a créé la possibilité de sortir d'un système de résistance imposé et certes glorifié, mais avait commencé à refléter lui-même une sorte d'enfermement.

Depuis septembre 1999, l'Université de Prishtina travaille de manière intensive à la Réforme universitaire. Elle (l'Université) est co-gouvernée par un administrateur international des Nations Unies, et par un recteur kosovar. Divers donateurs qui soutiennent cet effort, surtout la Banque Mondiale et le Programme Tempus, et on assiste déjà aux premiers résultats positifs, malgré les blocages hérités à la fois du système yougoslave et du système de la clandestinité. Depuis le mois de septembre 1999, l'université et de ce fait le département de philosophie (qui est actuellement indépendant) ont appliqué le Système Européen des Crédits Transférables (ECTS) destiné à assurer la compatibilité des programmes et à favoriser la mobilité des étudiants. Les études se déroulent d'après le modèle 3+2+3 (licence, master, doctorat). Nos curricula sont définis en collaboration avec l'aide de collègues d'autres pays, et en consultant sur les sites internet disponibles, surtout ceux des universités Charles de Gaulle de Lille III, de Nice, et de Strasbourg. Notre département de philosophie a déjà entamé une collaboration régionale avec le réseau francophone ARCHES en Europe de Sud-Est. Nous avons participé aux universités d'Été de Cluj de Roumanie en 2000, ensuite à Lille en 2001 et serons présents à celle de Dubrovnik en septembre 2002. Outre leur grand intérêt académique, ces écoles sont pour nous l'occasion de relayer des relations internationales tant avec la France qu'avec nos voisins de tous les pays de l'Europe du Sud-Est. Elles sont l'amorce d'un réseau dont nous espérons qu'il permettra de mettre en commun nos ressources pour penser la philosophie de l'après-communisme.

Depuis 2001, une université d'été pluridisciplinaire a lieu à Prishtina, avec plus de 500 participants locaux et internationaux. organisée par l'Université de Prishtina et ATA, « Academic Training Association », une ONG néerlandaise liée à l'Université d'Amsterdam. Elle sera reconduite en juillet 2002, 2003 et 2004. Une grande partie des matières de cette université d'été est liée aux sciences humaines et particulièrement à la philosophie ou d'autres sciences sociales. Il y a beaucoup de candidatures car les enseignements délivrent des crédits ECTS qui peuvent être validés dans les cursus réguliers d'études. Je propose ici que le réseau ARCHES y organise à partir de 2003 un cours de deux semaines. Le

département de philosophie s'occupera de la logistique et, si nécessaire, de la traduction de français en albanais. Le seul financement à prendre en compte devrait être celui des voyages des trois ou quatre professeurs accueillis.

Les universités française et surtout celui de Lille III nous apportent une aide considérable à la réforme de l'enseignement de la philosophie. Nous prévoyons aussi de mettre en place une collaboration avec le centre de la francophonie à Cluj, surtout pour le niveau du Master. Nous pourrions envisager d'y envoyer nos meilleurs étudiants une fois les trois premières études de licence (bachelor) terminées à Prishtina. Nous pensons en effet ne pas être rapidement en mesure avant quelques années d'enseigner jusqu'à ce niveau. De plus, cela irait dans le sens du renforcement de ce réseau francophone en Europe du Sud-Est.

Quand on parle de la réforme et de la collaboration régionale, il importe de mentionner la contribution de M. Christian Duhamel, mathématicien de l'Université de Paris-Sud et chargé de mission au Ministère français de l'éducation. Il a passé en 2001 un trimestre au Kosovo auprès du département de l'éducation de la MINUK, et a nous apporté une aide appréciable pour identifier les sites internet, pour développer un réseau régional et ouvrir des collaborations interuniversitaires. Il y a aussi le Bureau de Liaison de la France (BLF) qui aide le département de philosophie dans ses projets de la collaboration régionale et qui prendra en charge le financement de la participation des étudiants kosovars à l'Université d'été de Dubrovnik. Il y aura aussi deux de nos étudiants dans les Universités d'été organisées par l'association française « Transeuropéennes » à Strasbourg et Ohrid (Macédoine).

Il est important de mentionner une autre activité de la francophonie à la Faculté de philosophie. Le centre « François Furet » y existe depuis trois ans, et compte quelques centaines de livres. Ce centre, établi en collaboration avec le Comité Kosovo de Paris, a organisé plusieurs cycles de conférences en philosophie politique et d'autres domaines, qui ont toujours suscité un grand intérêt chez les étudiants et enseignants.

Cette construction de nos relations avec la France et plus largement la francophonie nous a d'abord poussé à reprendre nos forces pour envisager de construire un département de philosophie de bon niveau. Après 1999, nous sortions comme hébétés d'une période qui nous fut imposée dans la violence et souvent la terreur. beaucoup de nous ont subi douloureusement cette période dans leur famille et parfois dans leur chair. Le traumatisme en fut une sorte de dépression muette qui nous privait de notre propre courage, même si nous attendions depuis longtemps cette libération. Ces contacts internationaux, même encore réduits et fragiles, nous prouvent que nous ne sommes pas seuls, que nous avons désormais des références qui nous permettent de nous redéfinir.

Ainsi avons-nous entrepris de redéfinir complètement les curricula du premier cycle de philosophie en trois ans. On en trouvera le plan dans l'annexe ci-dessous. Notre but est double :

- Offrir à des étudiants qui voudraient ensuite s'orienter vers d'autres études (sciences politiques, administration, édition, journalisme, voire vers la psychanalyse ou d'autres voies) la possibilité d'acquérir les bonnes bases de raisonnement que, croyons-nous, offrent les études sérieuses des bases de la philosophie.
- Permettre à quelques étudiants de continuer vers un master en philosophie les conduisant vers l'enseignement de cette matière dans les lycées ou vers la préparation d'une thèse et une carrière universitaire.

Dans tous les cas, nous souhaitons bénéficier du développement de relations avec des centres étrangers. Tous vos conseils seront bienvenus et étudiés avec attention.

En annexe : Plan d'études de la Philosophie pour le premier cycle en trois ans

La réussite de ce projet nécessite une collaboration avec nos collègues d'autres départements de philosophie.

La collaboration sera absolument nécessaire pour le niveau de Master, (après les trois premières années), ainsi que pour les thèses doctorales. Nous espérons que, d'ici-là, le réseau régional de coopération sera consolidé et pourra s'appuyer sur des projets de long terme aux intérêts partagés par tous les partenaires.

Parmi les modules optionnels des semestres I et II, les étudiants peuvent en choisir deux, alors que les sept autres modules des semestres III, IV, V, VI doivent appartenir aux domaines ci-dessous : Sociologie, Sciences politiques et administratives, Médias, Droit, Psychologie, Langue étrangère.

Les modules des autres domaines d'étude peuvent être choisis, en accord avec notre département, dans une autre faculté.

L'étudiant n'est pas obligé de prendre tous les cursus proposés d'après le plan d'enseignement pendant une année scolaire, il peut les étaler dans le temps.

Plan d'étude du premier cycle en philosophie à Pristina (3 ans)

I^{er} Semestre

Module I		Module II		Module III		Module IV		Module V		Total
Introd./L'écriture académique/ Langue Anglaise		Introduction à la philosophie		Logique		Philosophie existentialiste		Optionnel		20 cours
h. / sem.	2+2	heures	2+2	heures	2+2	heures	2+2		2+2	
Crédits	6	Crédits	6	Crédits	6	Crédits	6		6	30

II^{ème} Semestre

Module I		Module II		Module III		Module IV		Module V		Total
Langue Anglaise		Philosophie Antique		Interprétation des textes philosophiques		Ethique et politique		Optionnel		20 cours
ECTS	6	ECTS	8	ECTS	4	ECTS	6	ECTS	6	30 ECTS

III^{ème} Semestre

Module I		Module II		Module III		Module IV		Module V		Total
Philosophie Moderne I		Philosophie de l'Art		Philosophie de la science		Anthropologie philosophique		Optionnel		20 cours
ECTS	8	ECTS	6	ECTS	5	ECTS	5	ECTS	6	30 ECTS

IV^{ème} Semestre

Module I		Module II		Module III		Module IV		Module V		Total
Ethique		La philosophie et la Critique de la Société		La Méthodologie avec l'Epistémologie		Optionnel		Optionnel		20 cours
ECTS	6		6		8		5		5	30

V^{ème} Semestre

Module I		Module II		Module III		Module IV		Module V		Total
Philosophie Moderne II		Philosophie Optionnelle		Philosophie Politique		Optionnel		Optionnel		20 cours
ECTS	8		6		6		5		5	30 ECTS

VI^{ème} Semestre

Module I		Module II		Module III		Module IV		Module V		Total
----------	--	-----------	--	------------	--	-----------	--	----------	--	-------

Le mémoire de diplôme		Philosophie contemporaine		Psychanalyse		Optionnel		Optionnel		20 cours
ECTS	8		8		6		4		4	30 ECTS

Mr Demë HOTI

DEKLARATA E BOLONJËS KUNDRUAR NGA PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT

TË MENDIMIT KRITIK

Deklarata e Bolonjës është nënshkruar nga Ministrat e Arsimit të 29 shteteve Evropiane dhe është miratuar më 19 Qershor të vitit 1999. Ajo ka për qëllim ekuivalentimin e shkollimit universitar në universitetet e shteteve nënshkruese të Marrëveshtjes të Deklaratës së Bolonjës. Kjo ishte si rrjedhojë paraprakisht e Deklaratës së Sorbonës, të nënshkruar me 25 maj 1998 nga Ministrat e Arsimit të Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë. Si e tillë, Deklarata e Bolonjës është obligative për të gjitha universitetet anëtare të Bashkësisë të Universiteteve Evropiane. Gjithashtu, e njëjta është mbështetur fuqimisht edhe në Konferencën e Pragës-2001, dhe në Konferencën e Berlinit, 2002.

Kjo Deklaratë, inspirimin e merr nga eksperiencia e përparuar shumëvjeçare e Universitetit të Harvardit, i cili qysh në vitin 1886 e kishte zbatuar me sukses Sistemin e akumulimit të krediteve dhe kornizën e transferimit të tyre.

Me Deklaratën Sistemit Evropian të Transferit të Krediteve (ECTS) insistohej të sigurohet:

- ***Transparenca;***
- ***Fleksibiliteti;***
- ***Bashkëkohësimi i vazhdueshëm, dhe***
- ***Mobiliteti;***

Zbatimi i Deklaratës së Bolonjes për Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, aktualisht është kuptuar si mundësi për:

- ***Ndryshime të vazhdueshme***
- ***Kreditime të suksesshme***
- ***Futje të kurseve të reja***
- ***Zhvillimin e mendimit kritik***

Të gjitha këto nënkuptojnë respektimin e parimeve bazë si:

- 1. Transparenca; Marrëveshja;***
- 2. Kreditë***

PERSPEKTIVA E MENDIMIT KRITIK NË KUADËR TË DEKLARATËS SË BOLONJËS

- *Futja e lëndëve që mundësojnë të menduarit kritik në planet e studimit*
- *Strategji të reja të mësimdhënies që për pikënisje kanë Filozofinë e mendimit kritik,*
- *Përvojat e Departamentit të Edukimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, dëshmojnë mundësitë e ndryshimeve të vazhdueshme e të bashkëkohësimit të studimeve.*
- *Koncipimi i Planit të studimeve të Fakultetit të Edukimit mbështetet fuqishëm në parimet e Deklarates së Bolonjës.*
- *Në mundësitë e implementimit të strategjive të reja që promovojnë të menduarit kritik.*

*Për të nxitur mendimin kritik duhet krijuar **disa parakushte thelbësore:***

Sigurimi i **KOHËS** së mjaftueshme për të shpalosur përvojat;

Krijimi i **MUNDËSISË** që studentët të mendojnë;

Marrja parasysh e ideve të **NDRYSHME**;

Marrja parasysh e **RREZIKUT** (dmth. studentët duhet të jenë të lirë dhe të kuptojnë se askush nuk mund t'i vëjë në lojë);

Të formohet **BINDJA** për aftësinë e çdo studenti.

Studentëve t'u bëhet e qartë **VLERA** e mendimit kritik

Për t'u përfshirë në procesin e të

menduarit të frytshëm kritik studentët duhet të aftësohen:

Të fitojnë **besimin** në vetvete dhe arsyetimin për dobinë e mendimeve dhe ideve të tyre;

Të **përfshihen në mënyrë aktive** në procesin e të nxënës

Të *dëgjojnë* dhe *respektojnë* mendimin e të tjerëve

T'i eliminojnë *paragjykimet* eventuale për të tjerët

MUNDËSITË E FITIMIT TË KREDITEVE NË KUADËR TË FORMAVE
ORGANIZATIVE TË PUNËS JOFORMALE

- *Përvojat e Universitetit veror në Universitetin e Prishtinës*
- *Jetësimi i Mendimit Kritik në arsimin formal*

STUDENTËT E MBËSHTESIN REFORMËN UNIVERSITARE

Të nderuar pjesëmarrës të kësaj Konference shkencore, profesorë të respektuar dhe studentë të Universitetit të Prishtinës,

Kjo Konferencë mendoj se është një nga veprimet më të qëlluara në këto vitet e pasluftës, pasi që në vete ngërthen faktorë që e kushtëzojnë njëri tjetrin në ciklin e gjatë shkak-pasojë .

Studentët e Universitetit të Prishtinës, e them me kënaqësi, se e kanë përqafuar reformën gjithnjë duke konsideruar jo si një akt, por si një proces i cili në një moment të krijon përshtypjen “ Të lumtë ne “, e në një moment tjetër, për një skepticizëm të pa shpjegueshëm .

I gjithë ky paradoks,në përmbajtje me këto ndjenja të përziëra është i pranishëm thuaja tek gjithsecili.Optimizmi i ndjenjës së parë vjen jo vetëm nga dëshira për të flakur të vjetrën e mërzitshme, por edhe nga dëshira për të lindur e reja.

Ndjenja e dytë pason me konstatimin se optimizmi i së parës nuk është racional, sepse premtimi se e vjetra do të ikë, është i perzier me kërcënimin se ajo shkon me dhëmbje, e do çmimin e vet, por i ka edhe kushtet e veta si p.sh..e reja mund të lindë, por vetëm si e klonuar.Kjo nuk mund të shpjegohet vetëm si kontradiktë gjeneratash, por nuk mund të thuhet se është diçka jashtë saj, por edhe për këtë ka një ngushëllim, e vjetra gjithmonë dobësohet edhe pse duhet një “Forcë”për ta flake”. E nëse kjo është një kontradiktë interesash apo dominojnë ato, atëherë vaj halli për ne .

Studentët e Universitetit të Prishtinës në këtë periudhë si duket po i përjetojnë të dy këto kontradikta dhe jo vetëm dy. Mjeti këtu është akuza, e cila i pëson metamorfozat e veta varësisht nga situata dhe normalisht se njëri tabor është me i avancuar dhe më me përvojë, p.sh.si rrugë e avancimit ishte në një kohë të shkuar identifikimi dhe përndjekja e irredentës, krijoheshin të graduarit që mbanin dhe ushqenin njëri tjetrin. Ndërsa sot akuza është shumëdimensionale por edhe më e kamufluar .

Reforma në Universitetin e Prishtinës ishte dhe është e vendosur në binarët e progresit, falë vullnetit të studentëve, por edhe të shumë profesorëve të nderuar të këtij Universiteti, porse ky proces nuk po ecën me ritmin e duhur, është një fakt, por edhe shumë faktorë e fajtorë që e shkaktojnë e në këtë kontest studentët janë më se paku fajtorë apo nuk janë fare.

Ajo që mund të llogaritet si faktor neglizhence në procesin e reformimit të Universitetit të Prishtinës konsiderojmë : gjendjen dhe kushtet materiale –teknike neglizhencën e disa mesimdhënësve dhe frigën nga ana e tyre për t’iu nënshtruar kërkesave që shtrën reformimi si proces .

Studentët e UP-së nuk janë fajtorë për gjendjen e krijuar në Universitet, prandaj edhe çelësi i zgjidhjes nuk është dhe nuk duhet të kërkohet tek ata .

Universiteti i Prishtinës nuk po krijohet tani. Nëse diçka duhet të ndryshohet, ajo kurrësi nuk duhet të modelohet me ndonjë ndërmarrje private, ku kontrata bëhet: “më paguaj të shërbej”, kështu së paku do të duhej të ishte derisa Universiteti është institucion publik .

Studentët kanë paguar edhe në të kaluarën dhe atë sa është kërkuar ; nuk e di kush duhet ta ndjejë veten fajtor pse ne sot nuk paskemi asistencë, nuk kemi e nuk patëm literaturë standarde e të përkthyer në shqip , studentët nuk janë fajtorë nëse janë viktimë e një

forme jo adekuate të të ligjëuarit dhe të testuarit, e rrjedhimisht ne nuk qenkemi fajtorë pse studenti e kalon një dekenie për të marrë një diplomë në fakultet.

Studentët nuk mundën dhe nuk duhet të paguajnë premtimin për shërbime më të mira, fundja kjo është një kërkesë jashtë çdo norme. Unë paguaj mallin ose shërbimin që më ofrohet dhe jo premtimin për to .

Kjo rrjedhimisht shtron nevojën për të gjetur zgjidhje dhe rrugë të tjera nga ato qeveritare e deri te varianti i fundit, zgjidhje më të mirë, për një seriozitet e sinqeritet në punë, për një trajtim e trajnim më të mirë të atyre, për të cilët edhe është fjala.

Kjo është njëkohësisht oferta që Universiteti t'ua ofrojë studentëve për t'i tërhequr ata, ndërsa tek ne po ndodhë diçka e çuditshme. Më jep para që të krijoj kushte ty ose një gjeneratë tjetër, për të cilën po ashtu duhet menduar madje e gjithë shoqëria. Gjithë kjo të kujton tregimin popullor “Pleshti në grusht të qorrit”.

Sa është e kapshme, reale dhe e besueshme se me paratë e studentit të ardhura nga participimi, do të përmirësohen pagat e mësimeve, do të ndërtohen laboratore, biblioteka e madje edhe konvikte.

Reforma në UP as që mund të mendohet pa një përfshirje më të madhe të studentëve në vendim-marrje, sepse aty edhe ashtu i jipet dimensionin i të resë, që gjithsesi do të duhet të jetë në hap me kohën.

Reformat në Universitet nuk bëhen duke kultivuar e përtërirë kontradiktat, por duke përpiluar dhe harmonizuar kontratat, ku gjithsecili do të kuptonte rolin dhe detyrën e vet, dhe do ta kryente atë me ndershmëri. Pra reforma në Universitet po kërkon disiplinë por edhe njëfarë patriotizmi nëse i duan të mirën vendit, e në këtë të fundit qëndron edhe “argumenti” për akuzë ndaj ne studentëve, sidomos ndaj UPS-UP-së, gjoja për njëfarë elitizimi e stërpolitizimi .

Kjo akuzë e ka një qëllim-defaktorizimin e studentëve karshi proceseve në Universitet, kjo akuzë mëmë e ka akuzën ndaj irrientës, në qëllimin e saj vazhdon për të pasur duar të lira gjithkund e gjithmonë, duke u fshehur zyrave, kabineteve, e herë-herë edhe pas lapidarëve, për të qenë gjithnjë e kamufluar, për të mbetur gjithmonë e paemër .

Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës brenda mundësive i ka bërë të gjitha përpjekjet për t'u shpjeguar studentëve reformat dhe rolin e tyre, për çka ka organizuar tribuna bashkërisht me profesorët tanë përgjegjës për implementimin e reformës në Universitet, dhe do të organizojë edhe në të ardhmen tribuna e debate me studentë e profesorë, gjithnjë duke synuar mbarëvajtjen e këtij procesi shumë të rëndësishëm për Kosovën dhe të ardhmen e saj, edhe rrugëtimin e shoqërisë sonë drejt civilizimit dhe standardeve evropërisht.

Ky proces është kuptuar drejt tek studentët, mbetet detyrë e jona dhe obligim i përbashkët që bashkërisht dhe pa e dëmtuar askë ta zbatojmë në mënyrë të përpiktë, duke ia adaptuar kushteve dhe rrethanave të përgjithshme, dhe jo synimeve dhe interesave personale.

PËRFUNDIME

Konferenca shkencore *Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore*, e organizuar nga Universiteti i Prishtinës dhe Fondacioni “Friedrich Eber Stiftung”, zhvilloi punimet në Prishtinë më 16 dhe 17 nëntor 2002.

Këtë tubim të rëndësishëm shkencor, në të cilin qenë të pranishëm shumë pjesëmarrës të ftuar, mësime dhënë, studentë dhe punonjës të tjerë të Universitetit, e hapi Prof.Dr.Zejnel Kelmendi, Rektor i Universitetit të Prishtinës.

Në Programin e Konferencës shkencore “Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore”, në tri seance e veçanta janë përfshirë njëzet kumtesa dhe janë lexuar 14 kumtesa të këtyre autorëve, siç janë: *Prof.Dr.Isak Shema: Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore*, *Dr.Enver Hoxhaj Misioni i universiteteve në shoqëritë evropërendimore*, *Dr.Laurence Walker: What does Kosova need from its University – Ç` kërkon Kosova nga Universiteti i vet*, *Prof.Dr.Riza Smaka: Vendi, roli dhe funksioni i Universitetit në shoqërinë bashkëkohore- relacioni i shoqërisë dhe i Universitetit dhe Prof.Dr.Illir Limani: Aspekte të planifikimit strategjik të Universitetit të Prishtinës*, *Prof.Dr Musa Limani: Kuadrot në funksion të zhvillimit*, *Prof.Dr. Zeki Bejtullahu: Edukacioni dhe efektiviteti ekonomik*, *Prof.Dr.Gazmend Luboteni: Roli i Fakultetit Ekonomik në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës*, *Prof.Dr.Arsim Bajrami: Reforma universitare në Universitetin e Prishtinës*, *Prof.Dr.Jahja Hoxha: Reforma universitare në studimet e Shkencave të Natyrës*, *Dr.Bernard Zeneli: Reforma në Universitetin e Prishtinës- rasti i Shkencave Politike*, *Mr.Demë Hoti: Zhvillimi i mendimit kritik kundruar në frymën e Deklaratës së Bolonjës*, *Prof.Dr.Hivzi Muharremi: Aspekte të reformës në Fakultetin e Arteve*, *Prof. Dr.Musli Bajraktari: Financimi dhe menaxhimi i Universitetit*, *Gani Morina- Vlora Gashi (studentë): Studentët e Universitetit të Prishtinës dhe reforma universitare*.

Në këto kumtesa dhe në diskutime janë trajtuar tema të rëndësishme, në të cilat janë ndiqur aspekte të veprimtarisë arsimore, shkencore dhe kulturore të Universitetit të Prishtinës dhe të universiteteve evropiane. Objektivat e këtij institucioni publik të arsimit të lartë: *realizimi i veprimtarisë arsimore dhe shkencore në tërësi, përparimi në fushën e njohurive, ideve dhe shkollimit, zhvillimi arsimor, shkencor dhe kulturor, zhvillimi social, ekonomik dhe i teknologjisë, nxitja e qytetarisë demokratike, arritja e nivelit më të lartë në fushën e mësimeve, të mësimit dhe të kërkimeve shkencore*, etj. janë kundruar dhe janë analizuar si çështje të zhvillimit të Universitetit në tërësi, por edhe në raport me shoqërinë dhe me zhvillimet aktuale dhe ato vijuese të Kosovës. Roli i Universitetit është i madh dhe i pazëvendësueshëm, prandaj në shqyrtimet shkencore janë paraqitur vlerësime të ndryshme për gjendjen aktuale të Universitetit, për angazhimin e personelit mësues, të studentëve dhe të gjitha subjekteve të shoqërisë, që problemet e shumta të zgjidhen dhe të përballohen me kohë dhe në mënyrë efikase.

Çështjet e angazhimit dhe e rolit të institucioneve universitare, të organeve qeveritare dhe të subjekteve të tjera për zhvillimi e gjithanshëm të universitetit dhe të shoqërisë në tërësi, janë mbarështruar si preokupime dhe përgjegjësi të veçanta, por edhe të përbashkëta, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të rëndësishme dhe të bashkëpunimit të gjithanshëm.

Roli i Fakultetit Ekonomik në zhvillimin ekonomik të Kosovës është i shumëfishtë. Në radhë të parë, ky institucion përgatit kuadro profesionale për ekonominë

dhe organizatat e tjera. Pajisja e të rinjve edhe me njohuri praktike do të mundësonte që ata më lehtë të përfshihen në jetën ekonomike të Kosovës dhe në këtë drejtim do të ndikonte edhe në rritjen e potencialeve njerëzore për nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Nevojë imanente është edhe lidhja më e ngushtë e Fakultetit Ekonomik me ekonominë e Kosovës. Kuadrot profesionale të Fakultetit mund të japin një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e ndërmarrjeve kosovare, duke punuar së bashku në Projekte të caktuara, duke ofruar shërbime të konsaltingut, etj. Ofrimi i trajnimeve për kuadrot që punojnë në ekonomi në fusha të ndryshme, si financa, kontabilitet, marketing, etj., gjë që do të ishte një kontribut i çmueshëm për kuadrot që punojnë në ekonomi dhe të cilat, me një aftësim të tillë, do të ishin në gjendje të ballafaqohen me probleme të ndryshme dhe me konkurrencën, që është gjithnjë e më e ashpër.

Funksionimi i një Qendre për Zhvillimin Ekonomik në kuadër të Fakultetit do të ndikonte dukshëm në aftësimin e kuadrove që punojnë në ekonomi dhe në afrimin më të madh të Fakultetit Ekonomik me ekonominë, me çka do të krijohet një gjeneretor i fuqishëm për zhvillimin më të shpejtë ekonomik të Kosovës.

Duke u bazuar në përvojën pozitive të deritashme, por edhe në rrjedhat aktuale të transformimeve dhe të reformës universitare, janë paraqitur aspekte të planifikimit strategjik të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës, të realizimit të planeve dhe programeve mësimore, çështje të përshtatjes së veprimtarisë së institucioneve të larta dhe të kërkesave të shoqërisë, aspekte të misionit të universiteteve në shoqëritë evropere, të bashkëpunimit ndërkombëtar, të studimit të problematikës komplekse që lidhet me çështje të rëndësishme të zgjerimit të veprimtarisë së institucioneve universitare dhe hapjes së degëve të reja.

Gritja e cilësisë së veprimtarisë arsimore dhe shkencore, pra e cilësisë së studimeve themelore, e cilësisë së studimeve pasuniversitare, përmirësimi i mësimdhënies, përsosja e mënyrave të vlerësimit, të përgatitjes profesionale dhe shkencore, zhvillimi i veprimtarisë botuese etj., janë synime kryesore të Universitetit.

Përmirësimi i suksesit të studentëve, specializimi profesional dhe shkencor i kuadrit mësimor, përgatitja dhe pranimi i kuadrit të ri universitar, zhvillimi i gjithanshëm dhe afirmimi i procesit të reformimit, ndikojnë në zhvillime të sotme dhe ato perspektive të Universitetit dhe të mbarë shoqërisë.

Baza materiale e Universitetit është shumë e vështirë. Për të realizuar programet e veprimtarisë së të gjitha institucioneve universitare dhe për të siguruar trendet e zhvillimit më dinamik, për të realizuar reformën universitare, kërkohet financimi adekuat nga buxheti, nga burime të tjera, por edhe nga veprimtaria fitimprurëse e institucioneve universitare. Përmirësimi i qeverisjes, modernizimi i administratës, sigurimi i teknologjisë bashkëkohore dhe i pajisjeve laboratorike, organizimi i informimit modern, botimi i revistave dhe i publikimeve shkencore, pasurimi i bibliotekave me literaturën shkencore dhe funksionimi i rregullt i tyre, ka rëndësi të madhe. Po ashtu kërkohet përmirësimi i standardit jetësor dhe përmirësimi i kushteve të studimit për studentët, organizimi i jetës kulturore dhe sportive etj. Studentët duhet të japin kontributin e tyre për përmirësimin e jetës kulturore, për formimin e grupeve letrare dhe të shoqërive kulturore.

Në seancat shkencore të konferencës “Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore”, me kumtesat e paraqitura dhe me diskutimin e gjithanshëm, programi u realizua në sajë të angazhimit dhe të kontributit konstruktiv dhe me vlerë të pjesëmarrësve të këtij tubimi shkencor.

